

Gusht 2014
Numri: 77
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA


Të gdhendësh **FENË** sipas qejfit



ISSN 2227-3611 0 8
9 772227 361004

Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



Gusht 2014

VITI: VIII
NUMRI: 77

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Elona Sytari
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Kaha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

"Ata, që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka".

Një fe sipas qejfit të personave, një fe sipas qejfit të grupeve, një fe sipas qejfit të popujve...

Si rezultat i kësaj, përveç tjetërsimit të botëkuptimit dhe mendimit tonë në lidhje me fenë dhe përplasia midis tyre, del në pah edhe përplasia e egoje individuale e shoqërore nën identitetin e fesë.

Për shembull, një baba mund të njohë të drejtat që i garanton feja babait, por nuk i njeh fare ose i neglizhon detyrat që ka babai ndaj fëmijës së tij.

Një bashkëshort i njeh të drejtat që i ka garantuar feja burrit në gjirin familjar, por nuk i njeh të drejtat e bashkëshortes ose nuk u jep rëndësi atyre.

Një bashkëshorte i njeh të drejtat që i ka garantuar feja gruas në gjirin familjar, por tregohet e shkujdesur ndaj të drejtave të burrit ose ndaj përgjegjësive familjare.

Një fëmijë i njeh të drejtat që ia garanton feja mbi prindërit e tij, por ai nuk i njeh përgjegjësitë e fëmijës ndaj prindërve.

Ndërkohë që një punëdhënës i njeh mirë të drejtat e veta, ai tregohet indiferent ndaj të drejtave të punëtorëve të tij ose ndaj të drejtave të njerëzve që konsumojnë produktet që ai prodhon.

Ndërkohë që një kryetar shteti apo një drejtues tregon kujdes shumë të madh në lidhje me të drejtat që ka për të menaxhuar apo për të urdhëruar, i mbyll sytë ndaj shërbimit që duhet të bëjë, ndaj llogarisë që duhet të japë apo nga drejtësia që duhet të mbajë.

Një punëtor kërkon gjithçka prej drejtorit të tij, por përgjegjësitë që ka mbi vete, nuk i shpie kurrë nëpër mend.

Ka popuj që mendojnë se Krijuesi ua ka dhënë atyre të gjithë nderin, fisnikërinë dhe superioritetin ose besojnë se të gjitha krijesat e tjera janë nën nivelin e tyre dhe se ato janë krijuar vetëm për t'u shërbyer atyre.

Një kriminel e kërkon të drejtën për t'u falur, por nuk bën kujdes ndaj përgjegjësive që ka në kaosin shoqëror, që vjen si pasojë e krimit të tij.

Ka dijetarë, që me mendimin se dinë gjithçka, kujtojnë se kanë edhe autoritetin të veprojnë si të duan me fenë. Mirëpo, harrojnë se edhe mendjen, edhe memorien, edhe diturinë e kanë nga Zoti dhe se "dijetarët" janë ata që duhet të jenë më të kujdesshëm ndaj ligjeve të Allahu të Madhëruar...

Ndërkohë që një rob kërkon pafundësisht prej Allahut, ai harron se është rob i Tij, se është i krijuar dhe se të gjithë ekzistencën e vet ia ka për borxh Krijuesit, duke mos e çuar nëpër mend asnjë prej përgjegjësive që i ka ngarkuar Allahu.

Çfarë fshihet poshtë këtyre?


Fshihet dëshira e pavetëdijshme e leximit të Kuranit për të prodhuar fakte në lidhje me interesat tona.

Fshihet dëshira për të jetuar duke harruar "ndjesinë e dorëzimit" ndaj Islamit. Po, në thelb, Islami është dorëzim. Është një dorëzim pa kushte dhe me zemër të pastër ndaj ligjeve të caktuara nga Allahu për birin e njeriut. Ky është sinqeriteti me të cilin përkufizojmë "përkushtimin ndaj Allahut". Jo t'i dorëzohemi egos sonë, "jo ta kthejmë egon në idhull e t'u bindemi shkronjë për shkronjë komandave të saj, duke u bërë robër të saj", por t'i dorëzohemi Allahut dhe fesë së tij. Nëse prej Islamit marrim atë që i vjen për shtat interesit tonë, do të thotë se ne adhurojmë interesin tonë, çfarëdo qoftë ai.


Përmbajtja



- 5 Të gdhendësh fenë sipas qejfit
Ahmet Tashgetiren
- 10 Paralajmërimi për Ramazanin
dhe për kohën pas tij
Prof. dr. Sulejman Derin
- 12 Përse ngecën myslimanët
Nexhat Ibrahim
- 15 Mesazhi "Allahu Ekber"
Ali Riza Temel
- 18 Ndikimi i Kuranit
M. Sami Ramazanogllu
- 19 Të fitosh zemra
Sadik Dana
- 24 Të martosh të varfërit
Ahmet Basher
- 26 Ku shkoi intuita jonë?
Xhemal Nar



- A ka Islami stil jete? 28
Sami Byjkkajnak
- 6 konvertimet më të famshme në Islam 30
Indira Krymi
- Një Ajet - Një Hadith 32
- Rregullat e kurtësisë Islame 40
Prof. dr. Ibrahim Emiroglu
- Respekti ndaj Pejgamberit (a.s.) 48
Dr. Kerim Bulladë
- Feja dhe komunizmi 50
Nuredin Nazarko
- Pendimi 52
Fahredin Jëlldëz
- Ku gjendet lumturia? 58
Naim Drijaj





TË GDHENDËSH

fenë SIPAS qejit

Ahmet Tashgetiren

Një nga problemet më të rëndësishme në marrëdhëniet me fenë ndodh atëherë kur marrim prej saj atë që na vjen për mbarë, në vend që t'i dorëzohemi plotësisht asaj. Këtë mund ta quajmë edhe njëfarë gdhendje e fesë sipas qejfit.

Qoftë në marrëdhëniet individuale, qoftë në marrëdhëniet me popujt, bashkësitë apo vendet islame, përpjekja për ta kthyer fenë në mbështetje të interesave tona është aq e sforcuar, saqë prej gjithë kësaj del një Islam të cilin të gjithë e interpretojnë sipas vetes së tyre.

Këto janë llojet e Islamit që marrin formë nga interpretime me referencë qendrat e egos. Mbase, për këtë fenomen flet edhe ajeti 32, në suren er-Rum, ku thuhet: **"Ata, që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka"**.

Një fe sipas qejfit të personave, një fe sipas qejfit të grupeve, një fe sipas qejfit të popujve...

Si rezultat i kësaj, përveç tjetërsimit të botëkuptimit dhe mendimit tonë në lidhje me fenë dhe për-

plasja midis tyre, del në pah edhe përplasja e egove individuale e shoqërore nën identitetin e fesë.

Termi "fikh", përkufizohet si "njohja e personit me ato që janë në favor ose në disfavor të tij". Ato që janë në favor të tij, në një farë kuptimi, janë të drejtat që feja i njej individit. Ndërsa në disfavor të tij janë sanksionet në këtë botë dhe në botën tjetër, të cilat vijnë si pasojë e neglizhimit të detyrave dhe përgjegjësiive që ai ka. Pra, në këtë rast, njeriu i njej këto deri në detajet më të imëta dhe nuk neglizhon asgjë.

Le të shohim pak tablonë e disa problemeve që po përjetojmë sot:

Për shembull, një baba mund të njohë të drejtat që i garanton feja babait, por nuk i njej fare ose i neglizhon detyrat që ka babai ndaj fëmijës së tij.

Një bashkëshort i njej të drejtat që i ka garantuar feja burrit në gjirin familjar, por nuk i njej të drejtat e bashkëshortes ose nuk u jep rëndësi atyre.

Një bashkëshorte i njej të drejtat që i ka garantuar feja gruas në gjirin familjar, por tregohet e shkujdesur ndaj të drejtave të burrit ose ndaj përgjegjësiive

familjare.

Një fëmijë i njuh të drejtat që ia garanton feja mbi prindërit e tij, por ai nuk i njuh përgjegjësitë e fëmijës ndaj prindërve.

Ndërkohë që një punëdhënës i njuh mirë të drejtave veta, ai tregohet indiferent ndaj të drejtave të punëtorëve të tij ose ndaj të drejtave të njerëzve që konsumojnë produktet që ai prodhon.

Ndërkohë që një kryetar shteti apo një drejtues tregon kujdes shumë të madh në lidhje me të drejtat që ka për të menaxhuar apo për të urdhëruar, i mbyll sytë ndaj shërbimit që duhet të bëjë, ndaj llogarisë që duhet të japë apo nga drejtësia që duhet të mbajë.

Një punëtor kërkon gjithçka prej drejtorit të tij, por përgjegjësitë që ka mbi vete, nuk i shpie kurrë nëpër mend.

Ka popuj që mendojnë se Krijuesi ua ka dhënë atyre të gjithë nderin, fisnikërinë dhe superioritetin ose besojnë se të gjitha krijesat e tjera janë nën nivelin e tyre dhe se ato janë krijuar vetëm për t'u shërbyer atyre.

Një kriminel e kërkon të drejtën për t'u falur, por nuk bën kujdes ndaj përgjegjësisë që ka në kaosin shoqëror, që vjen si pasojë e krimit të tij.

Ka dijetarë, që me mendimin se dinë gjithçka, kujtojnë se kanë edhe autoritetin të veprojnë si të duan me fenë. Mirëpo, harrojnë se edhe mendjen, edhe memorien, edhe diturinë e kanë nga Zoti dhe se "dijetarët" janë ata që duhet të jenë më të kujdesshëm ndaj ligjeve të Allahu të Madhëruar...

Ndërkohë që një rob kërkon pafundësisht prej Allahut, ai harron se është rob i Tij, se është i krijuar dhe se të gjithë ekzistencën e vet ia ka për borxh Krijuesit, duke mos e çuar nëpër mend asnjë prej përgjegjësisë që i ka ngarkuar Allahu.

Çfarë fshihet poshtë këtyre?

Fshihet dëshira e pavetëdijshme e leximit të Kuranit për të prodhuar fakte në lidhje me interesat tona.

Fshihet dëshira për të jetuar duke harruar "ndjesinë e dorëzimit" ndaj Islamit. Po, në thelb, Islami është dorëzim. Është një dorëzim pa kushte dhe me zemër të pastër ndaj ligjeve të caktuara nga Allahu për birin e njeriut. Ky është sinqeriteti me të cilin përkufizojmë "përkushtimin ndaj Allahut". Jo t'i dorëzohemi egos sonë, "jo ta kthejmë egon në idhull e t'u bindemi shkronjë për shkronjë komandave të saj, duke u bërë robër të saj", por t'i dorëzohemi Allahut dhe fesë së tij. Nëse prej Islamit marrim atë që i vjen



përshtat interesit tonë, do të thotë se ne adhurojmë interesin tonë, çfarëdo qoftë ai.

Gjithashtu, fshihet organizmi i jetës pa e përfillur Islamit. Kjo do të thotë të jetosh duke u mjaftuar në lidhjet me fjetjen më të pambukta, pa u fokusuar në përgjigjen e pyetjes, "në ç'përqindje duhet të ekzistojë Islami në jetën tonë?". Do të thotë ta shohësh fenë si relacionin më të largët. Do të thotë që në shtyllën kurrizore të jetës të vendosësh llogari dhe marrëdhënie të tjera, ndërsa fesë t'i lësh atë që ngellet prej tyre. Kjo do të thotë që edhe marrëdhënien me Allahun e Madhëruar ta lësh për në kohët më të jashtëzakonshme. Në kohët kur kapesht nga furtunat, në kohët kur të duhet një degë për t'u mbajtur gjatë rrëzimit të avionit apo në kohët kur të afërmit i zëndonjë sëmundje e pashpresë (Allahu na ruajtë).

Por më e keqja është se fshihet edhe dëshira për të ikur në mënyrë të vetëdijshme, për të jetuar larg Islamit. Kjo do të thotë që në mënyrë formale, të jesh



bre-
n d a
Islamit,
ndërsa në
të vërtetë të
vraposh nëpër
botët e tjera. Do të
thotë të të grabitet zemra
nga shejtani.

Për fat të keq, në botën islame ekziston çdo lloj ngjyre e këtyre problemeve. Dhe për këtë arsye, jemi bërë për të ardhur keq...

Sikur kjo çështje të kufizohej vetëm me egon tonë dhe sikur ta vazhdonim marrëdhënien tonë me Islamin duke edukuar egon tonë, pra sikur të shqetësoheshim për çështjen e egos, sikur të ankohehim prej saj dhe sikur të përpiqeshim të shpëtonim prej saj, kjo do të ishte një marrëdhënie e shenjtë me Islamin. Zemra jonë do të jetë e kthyer nga Zoti ynë. Prej Tij do të kërkojmë ndihmë ndaj çështjes së egos sonë dhe Atij do t'i përgjerohe mi duke thënë: "O Allah! Mos na lër në dorë të vetes sonë as sa një hapje e mbyllje sysh!".

Por, nëse e vendosim vullnetin tonë në anë të egos, kësaj here do të priremi ta përdorim të gjithë qenien tonë, veten, shoqërinë dhe popullin tonë për interes të egos. Do të dëshirojmë që çdo gjë t'i shërbejë

egos sonë. Kjo është gjendja kur edhe adhurimi bëhet për sy e faqe dhe kthehet në një shirk (idhujtari) të fshehtë.

Në një farë mënyre, shoqëritë që u janë dobësuar marrëdhëniet me Zotin, mund t'i kuptosh që kanë dobësi të këtij lloji. Por si është e mundur që kështu janë edhe pjesëtarët e një feje si Islami, e cila si parim kryesor ka lidhjen e zemrës me Allahun? Megjithëse medhhebet duhet të jenë thjesht rrugë të ndryshme për të arritur tek Allahu, përse pjesëtarët e tyre bien në batakun e zemërimit ku fyejnë njëri-tjetrin?

Sikur popujt islamë ta kishin kapur për dore Pejgamberin (a.s.) dhe sikur të mos ishin shkëputur prej botëkuptimit se ato që veprojnë do t'u dalin nesër para Allahut e do të përballen me pyetjen "për çfarë arsyeje e goditët njëri-tjetrin?", vallë a do të kishin hyrë në një grindje kaq të përgjakshme?

Si mund të qëndrojnë kaq indiferentë ndaj derdhjes së gjakut të qindra mijëra besimtarëve, duke e ditur gjykimin e Allahut, se: **"të vrasësh një njeri, është si të vrasësh gjithë njerëzimin"**? (shih. Maide, 32)

Pikërisht këtu, edukimi i zemrës merr një vlerë jetike.

Këtu dallon zemra e pastër nga zemra e sëmurë.

Këtu bëhet fjalë për kuptimin apo jo të fjalës hyjnore: **"Allahu është me ju kudo që të jeni!"** (Hadid, 4), për qenien apo jo i vetëdijshëm rreth gjendjes së marrëdhënies sonë me Allahun e Madhëruar.

Kur njeriu mposhtet nga harresa, ai harron edhe marrëdhënien e vet me Allahun dhe në strukturën e tij zënë vend si tumor cilësitë faraonike.

Dallimi midis kujdesit që tregon një mysliman, i cili e di se në botën tjetër do të përballtet edhe me të drejtën e një milingone që ka shkelur, me atë të atij që bëhet anë me ata që derdhin gjakun e dhjetëra mijëra myslimanëve, është dallimi i cili nxjerr në pah shkakun e gjendjes tragjike të botës islame në ditët e sotme.

Koha për një edukim personaliteti për ta kuptuar Islamin brenda kuadrin të "robërisë së vërtetë ndaj Allahut", ka ardhur dhe ka kaluar. Ky është kushti për të ndërtuar një botë të vërtetë islame mbi rruzullin tokësor, por edhe kushti për të dalë faqebardhë para Zotit tonë në Ditën e Kiametit...

Në këtë botë, ndonjëherë e hamë edhe Islamin për të ngopur e tejngopur egon tonë. Për rrjedhojë, nuk duhet të habitemi nëse "Islami" dëshmon kundër nesh në botën tjetër. Allahu na ruajtë!



"Biri im, do t'i mësoj disa fjalë: Ruaje Allahun, që edhe Ai të të ruajë ty! Nëse e ruan Allahun, do ta gjesh (gjithmonë) pranë. Atë që dëshiron, kërkoje prej Allahut! Edhe kur të kërkosh ndihmë, kërkoje prej Allahut!.."

Nuredin Jellëz

Ç'është Imani?

Kemi këpucë për fëmijë, enciklopedi për fëmijë... Duke marrë parasysh dallimin midis të madhes dhe të voglës, një gjë që është bërë apostafat për fëmijët e përkufizojmë me shprehjen: "për fëmijë". Kjo është normalja. Mirëpo, nuk ka Islam dhe besim të bërë për fëmijët. Besimi është një "i tërë"; dhe kësaj tërësie është e pamundur t'i japësh një formë të re sipas strukturës fizike të ndokujt. Asnjëherë nuk ka pasur ndonjë zbatim të tillë. Në mënyrë të veçantë, kjo nuk ka ekzistuar as në periudhën kur besimi është jetuar me shembujt më të bukur. Vlerat që kanë besuar besimtarët e moshës gjashtëdhjetë vjeç, janë vendosur edhe përballë gjashtëvjeçarëve; edhe ata kanë besuar si të rriturit.

Nuk kemi asnjë shembull, ku gjëra të cilat janë të vështira të kuptohen nga të vegjlit, të lihen jashtë çështjeve të besimit. Pra, nuk ekziston kurrë një listë: "besimi për fëmijë".

Ashtu siç nuk kemi një listë të besimit për fëmijë, ashtu nuk është treguar edhe asnjë lloj elasticiteti i formës, ku fëmijës i kërkohet të mësojë përmendsh një emër dhe për sa i përket praktikës, të thuhet "ai është ende i vogël, kur të rritet do ta kuptojë". Mund të flitet për një lloj elasticiteti, i cili është parë i përshtatshëm për fëmijët në lidhje me zbatimin në njëfarë përqindjeje të adhurimeve, si namazi, agjërimi etj. Por në lidhje me çështjet e besimit, nuk ekziston asnjë lloj elasticiteti.

Fëmijët, të cilëve u është kërkuar të besojnë Allahun, melekët, pejgamberët, librat, botën tjetër dhe kaderin, kanë besuar ashtu siç kanë besuar edhe të rriturit. Atë që kanë kuptuar të rriturit në lidhje me melekët, atë kanë kuptuar edhe fëmijët. Siç e kanë konceptuar të rriturit çështjen e kaderit, ashtu e kanë konceptuar edhe fëmijët e vegjël.

Këtë fakt, të vërtetën e besimit, e cila e fut njeriun në një formë, prej së cilës kënaqet Allahu, është e mundur ta shohim në fjalët dhe zbatimet e vetë Pejgamberi tonë (a.s.). Këtë të vërtetë mund ta shohim në hadithin e famshëm të transmetuar prej Tirmidhiut dhe Ahmedit, ku Pejgamberi (a.s.), këshillon Ibn Abbasin (r.a.), i cili sapo kishte mbushur dhjetë vjeç:

"Biri im, do t'i mësoj disa fjalë: Ruaje Allahun, që edhe Ai të të ruajë ty! Nëse e ruan Allahun, do ta gjesh (gjithmonë) pranë. Atë që dëshiron, kërkoje prej Allahut! Edhe kur të kërkosh ndihmë, kërkoje prej Allahut! Dije se: Nëse i gjithë populli bashkohet për të të bërë dobi, ata nuk mund të të japin asgjë përveç asaj që ka shkruar Allahu. Po ashtu, edhe nëse i gjithë populli bashkohet për të të bërë dëm, ata nuk mund të të bëjnë asgjë përveç asaj që ka shkruar Allahu. Lapsi është ngritur, shkrimi është tharë." (Tirmidhi, 2516.)

Nëse e analizojmë këtë hadith, do të shohim se këto lloj këshillash të "rënda", i janë drejtuar një fëmije që është vetëm dhjetë vjeç. Gjërat, që sipas nesh mund t'i kuptojnë vetëm të rriturit, në botëkuptimin e Pejgamberit tonë (a.s.), konsiderohen si çështje themelore me të cilat duhet

të edukohet një fëmijë. Ndërmjet edukimit të fëmijës në këtë nivel kuptimi dhe edukimit të fëmijës duke u mbajtur larg çështjeve themelore për shkak se është i vogël, më vonë do të dalin në pah dallime shumë të rëndësishme në lidhje me formimin e personalitetit të atij fëmije sipas besimit.

Fëmijët që Pejgamberi ynë (a.s.), i edukoi me këtë botëkuptim, pra fëmijët të cilëve u injektoi këto tema të rënda të besimit që në moshë të vogël, janë konsideruar të aftë në detyra të larta që në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare. Që prej fushës së politikës e deri tek dijet fetare, këta fëmijë nuk janë vlerësuar nga moshja, por nga aftësitë e tyre. Para se ata të shquheshin si fëmijët e sahabëve, ata janë shquar me identitetin që u ka falur besimi.

Usame (r.a.), që në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare është vendosur në krye të ushtrisë ku kishte edhe të moshuar dhe ka treguar aftësinë për të përfaqësuar Pejgamberin (a.s.) dhe besimin e tij. Të njëjtën gjë mund ta shohim edhe kur Zejdi (r.a.), i cili sapo kishte hyrë në moshën njëzetvjeçare, është vënë në krye të komisionit që do të mblidhte Kuranin në një libër.

Besimi është si një vaksinë. Ta zvogëlosh këtë vaksinë sipas fëmijës dhe të presësh që më vonë prej atij fëmije me vaksinë të zvogëluar të dalë një personalitet i lartë, nuk është aspak realiste. Meqenëse jemi të detyruar të marrim shembull suksesin e brezit të parë në lidhje me edukimin e një brezi të ri, edhe këtë realitet duhet ta marrim parasysh. Bijtë tanë duhet të besojnë realitetin e melekëve, kaderit dhe botës tjetër, të cilave u besojnë dhe u dorëzohen edhe baballarët e tyre.

Se sa e mundur është që fëmijët tanë të marrin vaksinën e besimit vetëm me përshkrimin e një bote tjetër ku tregohet vetëm xheneti dhe ku çdo gjë është e bukur dhe e mrekullueshme, këtë, më mirë se çdo gjë tjetër e shpalos tabloja që kemi përballë. Ne nuk mund të presim personalitete të lartë me një vaksinë të reduktuar.

Po ashtu, edhe rregullat e pedagogjisë në lidhje me edukimin e fëmijës nuk duhet t'i shohim si tabu të cilat nuk mund të kapërcehen. Ne nuk duhet t'i shohim të mëdha as barrikatat që ngrihen para nesh kur vjen puna për të vaksinuar besimin tonë tek fëmijët tanë.

Në fakt, kur vendosim para fëmijëve të vegjël një teknologji dhe një botë imagjinate, të cilën edhe të rriturit e kanë të vështirë ta konceptojnë dhe mbi të gjitha, kur këto ua japim atyre në formë edukimi, nuk mendohet fare se janë apo jo të rënda për fëmijën. Por, kur vjen puna për të vërtetat e besimit, të cilat janë bërë apostafat për natyrën njerëzore, ato shihen si të rënda!

Meqenëse ne presim fëmijë që do të bëhen bartësit e punëve të rënda, atëherë parimet e besimit tonë nuk janë të rënda për fëmijët tanë. Kjo është e domosdoshme, me qëllim që të ketë përputhje edhe ndërmjet pritshmërisë dhe zbatimit tonë. Për të edukuar breza të mëdhenj që besojnë si të mëdhenjtë, nuk duhet ta ngushtojmë besimin.

PARALAJMËRIME PËR RAMAZANIN DHE PËR KOHËN PAS TIJ



Prof. dr. Sulejman Derin

Këto momente që po përjetojmë, pra ditët e fundit të muajit të madhërueshëm të Ramazanit, janë një mundësi e mirë për të menduar hallet tona shpirtërore dhe për të gjetur zgjidhjet e tyre, sepse, sipas Imam Rabbanit (r.h.), të gjitha mirësitë shpirtërore që i jepen njeriut përgjatë tërë vitit, janë një reflektim i begatisë së arrirë në muajin e Ramazanit.

Nisur nga kjo, fitimet e arrira në muajin e Ramazanit, duhet të mbrohen përgjatë gjithë vitit. Në një letër që Imami ia kishte shkruar një nxënësi të tij, gjëja më e rëndësishme që kishte përmendur pas agjërimit të Ramazanit ishte dhënia e zekatit të pasurisë:

“Dhënia e zekatit është prej obligimeve të fesë. Atëherë, ne duhet t’ua japim zekatin me dashamirësi atyre që e kanë hak. Allahu i Madhëruar ka thënë:

“Jepuani robërve të mi të varfër një të dyzetën prej pasurisë që ju kam dhënë, në mënyrë që edhe unë t’ju jap sa më shumë shpërblim.”

Nisur nga kjo, hezitimi apo koprracia për të dhënë një masë kaq të vogël nga pasuria, është grada e fundit e mizorisë. Kjo nuk është vetëm koprraci, por në të njëjtën kohë, është edhe kundërshtim i urdhrit të Allahut Teala. Hezitimi kundrejt urdhrave të Allahut (xh.xh.), buron nga një sëmundje shpirtërore që gjendet në zemër dhe nga mosbesimi me gjithë shpirt ndaj dispozitave hyjnore.

“Thënia e shehadetit vetëm me gjuhë, nuk mjafton përderisa të mos besohet me zemër, sepse edhe hipokritët e kanë thënë këtë fjalë. Shenja treguese e besimit me gjithë zemër është kryerja e obligimeve fetare me gjithë shpirt.” (Mektubat, III, Letra e 17-të.)

Disa myslimanë pandehin se e kanë kryer obligimin e zekatit duke dhënë një pjesë të pasurisë së tyre pa bërë një llogari serioze të zekatit. Por zekati është obligimi më i rëndësishëm i infakut. Ai duhet të jepet në mënyrë serioze dhe duke e llogaritur. Imami (r.h.), thotë në lidhje me këtë çështje:

“Një dirhem i dhënë me nijetin e zekatit, është më i vlefshëm se mijëra florinj të dhënë me nijetin e sadakasë, sepse zekati është farz, ndërsa sadakaja është nafle. Ibadetet nafle nuk kanë asnjë lloj vlere në krahasim me ibadetet farz. Si shembull për këtë, mund të jap vlerën e një pike në krahasim me oqeanin, por as ky krahasim nuk është i saktë. Edhe njëra prej dredhive të shejtanit të mallkuar është pengimi i njerëzve nga farzet, duke i inkurajuar për ibadetet nafle dhe ndalimi i tyre nga zekati!” (Mektubat, III, Letra e 17-të.)

Në vazhdimin e letrës, Imami flet për zekatin dhe kërkon që myslimanët të jenë më të ndjeshëm në çështjen e haramit dhe hallallit. Ky apel i tij, veçanërisht sot, ka një rëndësi më të veçantë, sepse jeta moderne i shfaq si normale shumë haramë. Në këtë mënyrë, shumë myslimanë pothuajse i shohin si hallall shumë haramë, duke

u ndikuar nga media. Kjo, Allahu na ruajtë, e shkatërron besimin e njeriut dhe e zvarrit atë në xhehenemin e përhershëm. Imami thotë në lidhje me këtë çështje:

“Ne duhet t’i respektojmë kufijtë e hallallit e të haramit dhe duhet të qëndrojmë larg gjërave që Allahu i ka bërë haram. Nëse synojmë të arrijmë shpëtimin e përhershëm, deri kur do të flemë dhe do t’i mbyllim veshët ndaj të vërtetave? Të mos harrojmë se një ditë do na zgjojnë. Por atë ditë çdo gjë do të ketë kaluar. Vdekja është shumë afër njerëzve. Ndërsa ndëshkimet e ndryshme të ahiretit janë gati duke pritur.

Kur dikush të vdesë, do të thotë se ka shpërthyer kiameti për të. Ne duhet ta zgjojmë veten tonë para se një ditë të zgjohemi me pahir, sepse zgjimi në ahiret nuk ka asnjë dobi për njeriun.” Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Tahrim, 6)

Sipas Imamit, një gjë tjetër që kërkohen nga besimtari në këtë muaj është ushtrimi i tij me dhikër, duke mos e harruar Zotin qoftë edhe një çast. Pasi ta rregullojmë besimin dhe veprat tona sipas dispozitave të fesë, kohën duhet ta kalojmë duke e përmendur Allahun e Lartësuar. Në asnjë çast nuk duhet ta nënvlerësojmë dhikrin e Allahut Teala. Edhe nëse jemi të preokupuar me njerëzit në pamjen e jashtme, zemra jonë duhet të jetë e preokupuar me përmendjen e Allahut (xh.xh.) dhe nga kjo duhet të ndjejë kënaqësi.

Synimi themelor i dhikrit është ndërprerja e lidhjes shpirtërore me çdo gjë tjetër përveç Allahut të Madhëruar. Faktikisht, edhe në bazën e sëmundjeve shpirtërore gjenden këto lloj lidhjesh më këtë botë. Përderisa të mos ndërpriten këto lidhje, njeriu nuk e arrin besimin e vërtetë dhe nuk e ka të lehtë të zbatojë dispozitat e sheriatit.

Përmendeni shumë Allahun Teala, i cili është Zoti i gjithë njerëzve, sepse dhikri është qetësim për zemrat dhe ushqim për shpirtrat. Edhe një çështje tjetër që duhet të kemi kujdes ne që kemi arritur disiplinën e të ngrënit dhe të pirit në muajin e madhërisëm të Ramazanit, është që këtë disiplinë ta vazhdojmë edhe në muajt e tjerë. Të gjitha punët, si të ngrënit, të pirët dhe të



veshurit, duhet t’i bëjmë për hir të Allahut Teala dhe jo për nefsin.

Të gjitha ushqimet që hamë, nuk duhet t’i hamë me mendimin për të kënaqur veten, por me njetin për të pasur fuqi për ibadet. Edhe nëse në fillim nuk arrijmë dot ta bëjmë këtë njet, duhet të përiqemi shumë dhe t’i lutemi Allahut Teala të na ndihmojë në këtë çështje. Gjithashtu, edhe rrobat duhet t’i veshim me qëllimin për t’u zburuar për ibadet. Në Kuranin Fisnik, thuhet:

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (Araf, 31)

Me veshjen e rrobave të bukura nuk synohet shtirja ndaj njerëzve. Kjo sjellje është e ndaluar në fenë tonë. Kur të ulemi, kur të ngrihemi, shkurtimisht, në të gjitha sjelljet tona duhet të synojmë fitimin e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar dhe duhet të veprojmë në përputhshmëri me sheriatin. Përgjatë kësaj kohe, bota jonë e brendshme dhe e jashtme duhet të jetë me Hakun. Për shembull, kur të kemi nevojë të zhytemi në gjumë i cili është komplet gjendje shkujdesjeje, duhet të synojmë largimin e lodhjes për t’i kryer më mirë ibadetet e nesërme.

Kur të shtrihemi me këtë njet, gjumi ynë shndërrohet komplet në ibadet. Prandaj, transmetohet se gjumi i dijetarëve është ibadet. (Mektubat, III, Letra e 17-të.)

Nëse një njeri dëshiron të qëndrojë si mysliman, edhe nëse bën gabime, të paktën duhet ta pohojë para Zotit gabimin e tij dhe të mos e shohë atë si hallall. Imami e mbaron letrën me këtë paralajmërim:

“I kam shkruar këto që të paktën të na bëjnë të pohojmë gabimet tona, edhe nëse është e vështirë të zbatohen. Ky është një sukses i madh. I kërkoj mbrojtje Allahut Teala nga gjendja e atyre që nuk mërzhiten, nuk pendohen dhe nuk përiqen ta kompensojnë gabimin e tyre, duke mos e arritur këtë sukses. Këta njerëz nuk janë gjë

tjetër përveçse injorantë dhe inatçinj, që e kanë nxjerrë kokën nga hallka e adhurimit dhe këmbët nga lidhësja e nënshtrimit ndaj Allahut Teala. (Mektubat, III, Letra e 17-të.)

Allahu Teala na e mundësoftë të gjithëve që të vazhdojmë të punojmë përgjatë gjithë vitit me cilësitë e bukura që kemi arritur në muajin e Ramazanit! Amin!



PËRSE NGECËN MYSLIMANËT

Nexhat Ibrahimli

"Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë vetveten." (Rra'd, 11)

"...kurse ata që janë të thelluar mirë në dije thonë: 'Ne i besojmë Atij, e tërë kjo është nga Zoti ynë'. Dhe vetëm të zotët e mendjes e kuptojnë." (Al 'Imran, 7)

I. SHQYRTIME HYRËSE

Nëse e hulumtojmë historinë, do të shohim se myslimanët në të kaluarën kanë ideuar dhe ndërtuar kulturë dhe qytetërim të jashtëzakonshëm përgjatë tërë botës ku kanë kaluar e jetuar. Me paraqitjen e Islamit ndodhën ndryshime të mëdha; myslimanët braktisën përçarjen dhe mbëltuan unitetin, braktisën ashpërsinë dhe miratuan mëshirën e butësinë, braktisën veset e këqija dhe miratuan virtytet morale të rralla në ato kohë. Duke pranuar të mirën dhe duke refuzuar të këqijat e popujve të tyre, myslimanët për gjysmë shekulli, në fillim të shekullit 7, u bënë të fuqishëm, të lavdishëm, të pasur, të dinjitozë.

Gjendja aktuale është e kundërta e gjendjes së atëhershme. Sot myslimanët janë të dobët, të përçmuar, të varfër, të paarsimuar, të prapambetur. Përse ndodh kjo që pas atij lulëzimi myslimanët të zbehen, të bien në greminë?

II. SHKAQET THELBËSORE TË NGEÇJES

Është e vështirë të identifikohen me saktësi problemet që sollën ngeçjen e myslimanëve, prandaj edhe këto pak rreshta do ta trajtojnë vetëm pjesërisht këtë temë. Përkundër vështirësisë së cekur, megjithatë disa tema imponohen për trajtim, si: deformimi dhe devijimi në mënyrën e të menduarit dhe kulturës së umetit, deformimi në qasje, perceptim, diskurs etj.¹

II. 1. DEFORMIMI I VIZIONIT (BESIMIT) DHE QEVERISJES (VEPRIMIT)

Sociologët dhe historianët identifikojnë se deformimi i parë ndodhi në të menduarit e myslimanëve dhe në çështjen e veprimit, qeverisjes, sundimit si një prej problemeve të theksuara të ngeçjes myslimane e që fillon të shfaqet sidomos me pushimin e qeverisjes së mirë, përkatësisht fillon në kohën e përfundimit të periudhës së katër hulefai-rrashidinëve, Ebu Bekrit (r.a.), Omerit (r.a.), Osmanit (r.a.) dhe Aliut (r.a.).² Pas kësaj

1. Një analizë gjithëpërfshirëse e diagnostifikimit të shoqërisë myslimane ofrohet në veprën: Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman, *Kriza myslimanskog mišljenja*, Sarajevë, 2004, fq. 49-107.

2. Ebul-Hasan Ali Husni Nedevi, *Ma dha hasir'alemu bi inhitat'il-muslimin*, pa vend e vit botimi. Ose: Ebu'l Hasen Nedevi, *Çfarë humbi bota me dobësimin e myslimanëve*, Istanbul, 2007.

Shih edhe: <http://mladagora.tripod.com/id8.html>.

kohe, monarkia u bë sistem, kurse parimi i *konsultimit* (shura) mbeti vetëm temë juristësh dhe librash, për të mos u kthyer kurrë më vonë.³

Në këtë fazë fillon ndarja ndërmjet prijësit fetar dhe politik. Me ardhjen e emevitëve në pushtet, filloi të instalohet elementi etnocentrik dhe fisnor, që ishte një hap mbrapa kundrejt kozmopolitizmit islam. Këtë gjendje dijetari i njohur për lexuesin shqiptar, Abdulhamid Ebu Sulejman, shkruan:

*"Ndarja ndërmjet udhëheqjes intelektuale dhe fetare të umetit ka paraqitur fillimin e dobësimit të fuqisë myslimane, pëlcitjes së strukturës së shoqërisë myslimane dhe krizën në mendimin dhe institucionet islame. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar që dyert e umetit të hapen për korrupsion dhe shkatërrim. Islami gjithnjë e më pak kishte mundësi që të ruante vitalitetin e vet."*⁴

Kjo gjendje pak a shumë vazhdoi edhe në periudhën vijuese, atë abasite. Këtë gjendje Maverdi i famshëm e vlerëson të dëmshme, kurse veprën e tij *Ahkam'us-sulltanijeh* e përshkruan si përgjigje ndaj monarkisë së tyre.⁵ Edhe Ibn Halduni këtë dinasti e përshkruan si jokompetente për të qeverisur dhe shkaktare të shkatërrimit të hilafetit të tyre.⁶

Për fat të keq, as dinastitë vijuese nuk bënë diçka të rëndësishme e të dobishme që të përmenden. Edhe qeveritë e shumta arabe sot (me atribute formale islame) nuk kanë përmirësuar gjë. Madje, shumë pak dallojnë për të mirë nga qeveritë e asaj kohe, me dallimin që sot këta nuk kanë as dije, as autoritet brenda as jashtë vendit etj. Thjesht, janë vegla të shteteve evropërisht, pa prodhim vendor, pa vlerat e dikurshme, pa autoritet fetar e politik.

II. 2. DEFORMIMI NË QASJE & KONSERVATORIZMI

Njohësit kompetentë thonë se Islami është fe e gjallë, me potencial të jashtëzakonshëm fleksibiliteti, gjithëpërfshirës, fe që i përgjigjet njeriut dhe nevojave të tij natyrore, në kohë dhe hapësira të ndryshme. Islami

3. Muhammed Asad, *Parimet e shtetit dhe të qeverisjes në Islam*, Zëri Ynë, Prishtinë, 2011.

4. Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman, *Kriza myslimanskog mišljenja*, po aty, fq. 50 e tutje.

5. Syed A. Ahsani, *Maverdijev politicki model, principi islamskog politickog sistema*, në: Grup autorësh, *Myuslimanski doprinos svjetskoj civilizaciji*, Sarajevë, 2010, fq. 57-78.

6. Roger Garaudy, *Živi islam*, Kalem, Sarajevë, 2000, fq. 21-22.

barazpeshon nevojat njerëzore mes kësaj dhe asaj bote dhe krijon personalitete kreative. Mirëpo, në periudha të caktuara u paraqit edhe pjesa regresive e myslimanëve, që këtë botë e kuptoi mbrapsht, kurse botën tjetër e kuptoi si monopol të tyre. Rrymat e tilla ndikuan mbrapsht dhe dëmshëm gjatë historisë myslimane. Kjo gjendje u përshtatej rivalëve të myslimanëve, kështu që ata gjetën brendapërbrenda myslimanëve elemente tradhtarë, që ndikuan që kultura dhe qytetërimi mysliman të ngecë edhe më tepër edhe më thellë.⁷

Konfliktet sektare në shekujt 5-6 në Irak mes hanbelitëve dhe shafitëve, kaderitëve dhe xhebritëve, mes tradicionalistëve rigidë dhe sufistëve apo grupeve të tjera vazhduan me intensitet edhe më vonë, madje me tërë destruktivitetin e vet deri në ditët tona. Mendja e ndritur dhe prodhuese u mbyll, kurse filluan të dominojnë ato koka që sot mund të identifkohen, si neoharixhitë apo vehabistë.⁸ U mbyllën shkollat e Ibn

Sinait e Ibn Rushdit, kurse u hapën shkollat që prodhuan koka boshe e fanatizëm

të paparë.⁹ Kjo gjendje po vazhdon edhe dy shekujt e fundit, XX-XXI dhe këtë e kanë vërejtur mirë edhe Shekib Arslani në fillim të shekullit XX, Jusuf Karadavi gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, Husein Gjozo gjatë pjesës më të madhe të shekullit XX, Alija Izetbegović gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, Muhamed Gazali egjiptian gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX dhe intelektualë të tjerë, duke e quajtur konservatorizmin si një prej shkaqeve të ngecjes së myslimanëve.¹⁰

Sociologët dhe historianët identifikojnë se deformimi i parë ndodhi në të menduarit e myslimanëve dhe në çështjen e veprimit, qeverisjes, sundimit si një prej problemeve të theksuara të ngecjes myslimane e që fillon të shfaqet sidomos me pushimin e qeverisjes së mirë...

II. 3. INDIFERENCA E MYSLIMANËVE

Myslimanët krenohen me të kaluarën e baballarëve, me mësimin e tyre, me luftërat e tyre, me devotshmërinë e tyre, me prodhimin kulturor e qytetërimor të tyre, etj. Por jeta e tyre aktuale, përkundër theksimit

7. Alija Izetbegović, *Vepra*, 2, Logos-A, Shkup, 2013, fq. 421 e tutje. Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman, *Kriza myslimanskog mišljenja*, po aty, fq. 61 e tutje.

8. Fikret Karčić, *Historija šerijatskog prava*, Sarajevë, 2005, fq. 138.

9. Roger Garaudy, po aty, fq. 28.

10. Muhammed Gazali, *Brige i nada*, Konjic, 2005, fq. 119.

Paaftësia e një hatibi që t'i shpjegojë arsyet e lëshimit të mjekrës e detyroi atë të ndër marrë masat e frikësimit dhe në këtë mënyrë, një çështje dytësore e shndërroi në çështje besimi, mosbesimi dhe mosbindjeje. Hatibi ka arritur në përfundimin se ata që e rruajnë mjekrën e mohojnë sunetin, kurse ata që e mohojnë atë që e ka urdhëruar Muhamedi (a.s.), e mohojnë besimin e, nëse e mohojnë besimin, janë jobesimtarë. (Shih më gjerësisht: Abdulhamid Ahmed Ebu Sulejman, *Kriza myslimanskog mišljenja*, po aty, fq. 70-71 etj.).

të nostalgjisë për të kaluarën, nuk tregojnë se ata ndjekin të parët e tyre. Nga të parët e tyre kanë trashëguar vetëm shpresën se ata do ta dominojnë botën, por jo me besimin e tyre dhe punën e tyre, por me ndihmën e Isait (a.s.), me ndihmën e Mehdiut të pritur, gjithnjë duke mbajtur kokën drejt qiellit, etj. Ata nuk duan ta ndryshojnë gjendjen e tyre katastrofike në arsim, në shkencë e teknologji, në art e kulturë, por thirren në tekste të caktuara kuranore dhe hadithore (abuzojnë duke i keqkuptuar) dhe duarhapur presin sendërtimin e synimeve të tyre.¹¹

Myslimanët sot janë edhe pa ide dhe edhe pa aksion. Kurse këtë gjë qysh moti e ka vërejtur princi Shekib Arslani, kur kishte thënë:

"Shkenca moderne varet nga ideja dhe ndërmarrja. Posa të gjenden këto të dyja, do të gjendet edhe shkenca moderne edhe zejet moderne. Është e njohur se japonezët deri në vitin 1968, sikur edhe popujt e tjerë lindorë, kishin gjendje patriarkale dhe kur dëshiruan t'i arrijnë popujt e fuqishëm, i mësuuan shkencat evropiane dhe i studiuuan zejet e tyre."¹²

Pasivitete mysliiman, pafuqinë e tyre, qoftë intelektuale, qoftë ekonomike, politike apo ushtarake, do ta përshkruaj me hadithin e njohur të Muhamedit (a.s.), i cili me një rast tha:

"Do të vijë koha, kur fenë tuaj do të jetë vështirë ta mban si gacën në dorën tuaj; nuk do të mund ta mban." Një besimtar pyeti: "A do të thotë kjo se do të ketë shumë pak mysliimanë?" "Jo", u përgjigj Muhamedi (a.s.), "do të jenë numerikisht shumë, më shumë se kurdoherë më parë, por do të jenë të pafuqishëm sikurse shkuma në valët e detit."

II. 4. MOSPAJTIMET E NDËRSJELLA

Edhe pse mospajtimit janë të natyrshme në masën e caktuar, kur ato janë në funksion të studimit, avancimit e hulumtimit, te mysliimanët këto mospajtimit janë shndërruar në përçarje, në pengesa, në ngecje. Në vend të integritetit kemi dezintegritet, në vend të studimit kemi mosmësim. Në vend të temave të nevojshme, në gojën e mysliimanëve gjenden kryesisht fjalët sunit, shiit, hanefist, vehabist, xhihad, tekfir etj.¹³ Mysliimanët merren me gjëra të vogla, i avancojnë ato, bëhen top-tema nga ana e kuazi-intelektualëve, kurse temat e mirëfillta nuk gjejnë hapësirë të diskutohen, madje, quhen tema të armiqve, të bidatçinjve, të cilët ose "Zoti i udhëzoftë" ose do "të dënohen me xhehenem

11. Alija Izetbegović, *Vepra*, 2, po aty, fq. 428 e tuje. Abdulhamid A - med Ebu Sulejman, *Kriza mysliimanskog mišljenja*, po aty, fq. 68 e tutje.

12. Emir Šekib Arslan, *Zašto su mysliimani nazadovali*, a drugi naredovali, Sarajevo, 2001, fq. 29.

13. Sipas: <http://mladagora.tripod.com/id8.html>. Kohët e fundit ka mendime se *tekfirizmi* është mjet i forcave kryesore botërore me qëllim përfitimi material, politik etj.

përgjithmonë", fraza këto të njohura nga qarqet që kanë marrë në juridiksionin e vet "dërgimin në xhenet apo xhehenem".

Të tillët harrojnë porosinë e hadithit:

"Ebu-Ma'bed Mikdad b. Esvedi, (r.a.), tregon se e ka pyetur të Dërguarin e Allahut, alejhisselam: "Nëse bie në konflikt me jobesimtarin dhe ai me shtëpatë ma pretë dorën dhe pastaj ngjitet në dru dhe thotë: 'E pranoj Islam'in, a guxoj ta vras pasi e thotë këtë, o i Dërguari i Allahut?' "Nuk ke të drejtë!" "Por, o i Dërguari i Allahut, ai ma ka prerë dorën, e pastaj atë e ka thënë pasi e ka prerë?" "Nuk ke të drejtë ta vrasësh, sepse, nëse ti e vret atë në këtë kohë, ai do të jetë në pozitën tënde në të cilën ti ke qenë para se ta kesh vrarë, ndërsa ti do jesh në pozitën në të cilën ai ka qenë para se atë ta ketë shqiptuar." (Muttefekun alejhi).

Një numër dijetarësh në vazhdimësi janë përpjekur ta rishqyrtojnë këtë qasje të ngurtë ndaj jetës dhe sfidave të reja, mirëpo sukcesi është relativ, sepse ana e kundërt, në kohën e rënies besimore e morale është më joshëse dhe me mjete financiare dukshëm më të mëdha.

Prandaj, kulturën dhe qytetërimin tonë duhet ta pastrojmë nga shtresimet kohore dhe sjelljet devijante, duke filluar nga individi, familja, populli dhe umeti në përgjithësi, nëpërmjet lidhshmërisë së përbashkët, dhembshurisë, solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë, në frymën e hadithit të Muhamedit (a.s.):

"Pejgamberi i Allahut ka thënë: 'Ndihmoje vëllain tënd edhe kur i bëhet padrejtësi, por edhe atëherë kur ai bën padrejtësi'. Sahabët e pyetën: 'O Pejgamberi i Allahut, që ta ndihmojmë kur i bëhet padrejtësi këtë e kuptojmë, por si ta ndihmojmë nëse ai bën padrejtësi?' "Pengojeni atë, u përgjigj ai."¹⁴

IV. SHQYRTIME PËRMBYLLËSE

Është e vështirë të përmbliidhen shkaqet kryesore të mysliimanëve në një shkrim të vogël dhe me synime të vogla. Megjithatë, nga e shtruarja mësojmë se në shkallën botërore të ngecjes së mysliimanëve disa faktorë megjithatë dallohen: 1. Qeverisja jokompetente; 2. Qasja e gabuar dhe idetë konservatoriste; 3. Indiferenca e mysliimanëve dhe pritja e suksesit nëpërmjet çudive; dhe 4. Mospajtimit brendamysliimane. Duke i analizuar këto shkaqe mund të konstatohet se rruga e mysliimanëve është e hapur vetëm nëse i mënjanojmë këta dhe faktorë të ngjashëm. Faktorët jashtëmysliimane janë të rëndësishëm, por megjithatë janë dytësorë dhe më lehtë të përballueshëm, nëse substanca është e shëndoshë.¹⁵

14. Imam Buhari, *Sahih'ul-Buhari*, nr. 2264, sipas: Abdulhamid A - med Ebu Sulejman, *Kriza mysliimanskog mišljenja*, po aty, fq. 101.

15. Shih një analizë të mirë: Akbar S. Ahmed, *Islam pod opsadom*,



الله أكبر

All Riza Temel

Mesazhi

“ALLAHU EKBER”

Fjala, të cilën e shqiptojmë më tepër në formë adhurimi, është “Allahu Ekber”. Nëse në të pesë kohët e namazit, bashkë me farzet falen edhe sunetet e vaxhibet, gjithsej bëhen dyzet rekat. Për rrjedhojë, numri i tekbirëve (Allahu Ekber) që shqiptohet gjatë gjithë këtyre namazeve, është 221. Nëse shtojmë edhe ato që përmenden gjatë ezanëve dhe ikameteve, bëhen 261. Ndërsa gjatë Muajit të Ramazanit, së bashku me namazet e teravive bëhen 371.

A e kuptojmë se vetëm gjatë namazeve shqiptohen kaç shumë tekbirë dhe a kemi menduar në lidhje me urtësinë e kësaj? Çfarë mesazhi japim kur thërrasim pesë herë në ditë nga vendet më të larta (minaret) dhe me zërin më të bukur fjalën dhe deklaratën “Allahu Ekber”?

Padyshim se përdorimi i shprehjes “Allahu Ekber/Allahu është më i Madhi”, më shpesh në krahasim me shumë emra të tjerë që e shprehin madhësitë e Allahut të Madhëruar, e ka një urtësi.

“Allahu Ekber”, është përkujtimi dhe deklarimi në çdo kohë dhe me zë të lartë se sundimi, fuqia dhe pushteti absolut i takojnë vetëm Allahut. Ky deklarim është si një shuplakë që bie mbi surratin e njerëzve që i atribuojnë vetes së tyre fuqi dhe pushtet të jashtëzakonshëm, si Nemrudi dhe Faraoni. Në mënyrë indirekte, atyre u thuhet: “Kush jeni ju? Mos e teproni! Madhështia e vërtetë i takon Allahut. Ajo që ju takon juve, është të ulni kokën dhe të tregoheni të përlulur përballë madhësisë së Tij”. Sa bukur janë shprehur të parët tanë përpara sulltanit: “Mos u mburr sulltani im, Allahu është më i madh se ti!”

Përsëritja e vazhdueshme dhe me zë të lartë e shprehjes "Allahu Ekber", ka dobi të mëdha. Kur biri i njeriut arrin njëfarë force dhe pushteti, fillon ta teprojë dhe t'i përçmojë ata që ka poshtë vetes. Ai e harron se fuqia dhe mundësitë që ka, i janë dhënë si sprovë nga Allahu i Madhëruar.

Ata që thonë "Allahu Ekber", nuk njohin tjetër-kënd më të madh; rukunë dhe sexhden, e bëjnë vetëm para Tij. Ata që përkulen para Tij, nuk është e mundur të përkulen para dikujt tjetër. Nëse rukuja dhe sexhdja bëhet pengesë për përkuljen ndaj të tjerëve, ajo është rukuja dhe sexhdja e vërtetë.

Përsëritja e vazhdueshme dhe me zë të lartë e shprehjes "Allahu Ekber", ka dobi të mëdha. Kur biri i njeriut arrin njëfarë force dhe pushteti, fillon ta teprojë dhe t'i përçmojë ata që ka poshtë vetes. Ai e harron se fuqia dhe mundësitë që ka, i janë dhënë si sprovë nga Allahu i Madhëruar. Për këtë arsye, ai guxon të thotë si Karuni; **"Kjo më është dhënë vetëm për shkak të diturisë sime."** (Kasas, 78) Kurse Faraoni u mashtrua me pushtetin e vet dhe tha: **"Unë jam zoti juaj më i lartë!"** (Nazi'at, 24) Ndërsa Nemrudi, për shkak të arrogancës që i kishte dhënë pushteti, hyri në debat me pejgamberin Ibrahim (a.s.), në lidhje me Allahun. Teprimi dhe arroganca kur arrihet pushteti dhe fuqia, është një dobësi e përgjithshme e birit të njeriut. **"Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."** (Alak, 6-7) Prandaj, për ta parandaluar këtë arrogancë, duhet deklaruar shpesh dhe me zë të lartë "Allahu Ekber". Nëse ata që shtypin të dobëtit, duke u mashtruar pas mundësive e fuqive të përkohshme që zotërojnë dhe ata që bëhen si Faraoni dhe Nemrudi, do t'i kishin venë veshin këtij zëri, as të tjerëve nuk do t'i kishin bërë padrejtësi dhe as vetë nuk do të shkatërroheshin për shkak të arrogancës së tyre.

Madhështia i takon Allahut, kurse njeriut, të jetë robi i Tij. Në një hadith kudsî, Allahu i Madhëruar, urdhëron:

"Lavdia konsiderohet veshja ime e poshtme, ndërsa madhështia veshja e sipërme. Nëse dikush sillet sikur zotëron një nga këto të dyja, do ta dënoj atë!" (Muslim, Birr, 136. Shih. Ebu Daud, Libas 26; Ibni Maxhe, Zuhd 16.) Këtu është përdorur një përngjasim shumë i bukur. Me këto fjalë, Zoti ynë thekson se lavdia dhe madhështia janë si një veshje që mbështjell trupin dhe këto i takojnë vetëm Atij; kush kujton se i zotëron këto cilësi, i ka bërë ortak Allahut dhe kush guxon të matet me Të, Ai do ta shkatërrojë.

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të tjerë në lidhje me faktin se njerëzit, të cilët janë krijesa të dobëta dhe të pafuqishme, do të shkatërrohen si në këtë botë edhe në botën tjetër për shkak të arrogancës dhe krekosjes së tyre. Le t'i përmendim disa prej tyre:



"Nuk mund të hyjë në xhenet, kush bart në zemër goftë edhe një grimcë mendjemadhësie." (Muslim, Iman, 147.)

"A t'ju them se kush janë banorët e xhehenemit? Janë njerëzit zemërgurë, të pacipë, koprracë dhe ata që ecin duke u mburrur." (Buhari, Ejman, 9; Muslim, Xhenet, 47.)

"Në Ditën e Kiametit, Allahu nuk ka për t'ia parë fytyrën atij që tërheq zvarrë rrobën e tij duke u mburrur." (Buhari, Libas, 1; Muslim, Libas, 42.)

Mendjemadhësia tek njeriu, formohet shkallë shkallë. Me shtimin e fuqisë dhe mundësive, të servilëve dhe sahanlëpirësve njeriu fillon të bëhet si faraon pa e kuptuar fare. Këtë fakt, Pejgamberi (a.s.), e ka theksuar me këto fjalë: *"Duke u mburrur vazhdimisht, njeriu futet në kategorinë e tiranëve. Kështu që edhe atij i jepet dënimi i tiranëve." (Tirmidhi, Birr, 61.)*

Njeriut i shkon përlulesia. Përlulesi do të thotë të pranosh të vërtetën dhe të ulësh kokën. Ndërsa mendjemadhësia është e kundërta e kësaj. Nëse dikush pyet: "Përse për njeriun mburra është e keqe, ndërsa për Allahun është e mirë?", atij i jepet kjo përgjigje: Të gjitha cilësitë me të cilat mund të mburresh, burojnë nga Allahu. Për rrjedhojë, Ai ka të drejtë të mburret. Përveç kësaj, Allahu i Madhëruar është i pastër nga të metat dhe gabimet. Ai nuk u nënshtrohet urdhrave e ndalesave dhe nuk gjykohet për atë që bën. Ndërsa njeriu nuk është kështu. Aftësitë që zotëron, nuk burojnë prej tij, por janë mirësi që ia ka dhënë Allahu. Nuk mund të krekosesh me aftësi të cilat të janë lënë amanet. Askush nuk ka të drejtë dhe autoritet të garojë me Zotin. Mbi të gjitha, njeriu nuk është i pastër nga të metat dhe në çdo moment mund të gabojë. Në fund të fundit, madhështia dhe perfeksioni në mënyrë absolute, i takojnë vetëm Allahut. "Allahu Ekber" dhe "Elhamdulillah", janë shprehja me gjuhë e kësaj pozite hyjnore.

Përlulja, është simboli i robërisë ndaj Allahut. Ndërsa Pejgamberi ynë (a.s.), është shembulli më ideal i robërisë ndaj Allahut. Ai, më parë është rob, pastaj është pejgamber. Jeta e tij është modesti nga fillimi deri në fund. Edhe një shërbyes mund ta kapte përdore dhe ta çonte atje ku dëshironte. Ai u jepte selam fëmijëve dhe i hipte ata në pjesën e pasme të samarit. I merrte në shpinë nipërit dhe i shërbente familjes së vet. Kafshatën që binte në tokë e merrte dhe e hante. Punoi si çoban dhe u përgjigjej edhe ftesave më modeste të skllevërve. Gjithashtu, ai ka thënë: *"Kush tregohet modest për hir të Allahut, Ai e ngre atë".* Madje, ai nuk e pëlqente as kur dikush ngrihej në këmbë për të.

Atyre që gjithmonë u tingëllon në vesh shprehja "Allahu Ekber", janë të vetëdijshëm për robërinë e tyre në çdo moment dhe nuk kërkojnë zota të tjerë. Ata nuk

njohin të mëdhenj të tjerë pranë Allahut. Ata nuk përlulen para të tjerëve, sepse strehohen tek madhështia e Tij. Ata marrin forcë prej forcës së Allahut dhe nuk e ulin kokën para tiranisë e tiranit.

Izzeddin bin Abdusselam, shkoi në Egjipt dhe u takua me mbretin Nexhmeddin. Mbreti ishte njeri shumë i ashpër. Njerëzit kishin frikë prej tij dhe askush nuk mund t'i thoshte diçka lehtësisht. Gjatë një mbledhjeje, Abdusselami iu drejtua në emër mbretit dhe e paralajmëroi atë në lidhje me disa të këqija. Kur u pyet se si guxoi ta bënte këtë, ai u përgjigj:

"M'u kujtua madhështia e Allahut dhe mbreti përnjëherë m'u duk i dobët si një mace."

Ata që thonë "Allahu Ekber", nuk kanë frikë nga askush tjetër. Kur magjistarët e Faraonit ranë në sexhde përballë mrekullisë së Musait (a.s.), Faraoni i poshtëruar, i kërcënoi ata se do t'u priste duart e këmbët dhe do t'i varte në degët e hurmave. Magjistarët që u frikësuan prej fuqisë së Allahut dhe jo të Faraonit, mbajtën qëndrim ndaj tij dhe i thanë: ***"Ne kurrë nuk do të të japim përparësi ty ndaj provave që na kanë ardhur neve dhe ndaj Atij që na ka krijuar ne. Prandaj, gjyko si të duash; ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote!"*** (Ta-Ha, 72)

Pejgamberi ynë (a.s.), duke iu bindur urdhrat të Allahut ***"(Vetëm) Zotin tënd madhëroje"*** (Muddeththir, 3), nuk iu përlul asnjë fuqie tjetër dhe duke u mbështetur në fuqinë hyjnore, arriti të realizojë revolucionin më madhështor të historisë.

"Allahu Ekber", ka qenë gjithmonë arma më e fuqishme që të shtypurit kanë përdorur ndaj tiranëve arrogantë e mendjemëdhenj. Luftëtarët që rezistojnë përballë tiranëve, marrin energji duke thënë njëzëri "Allahu Ekber" dhe me këtë energji vazhdojnë të luftojnë. Lufta që po zhvillohet sot në Palestinë dhe Siri, është prova më e gjallë e këtij fakti, sepse rezistenca e tyre ndaj forcave të mëdha armike, nuk mund të shpjegohet ndryshe.

Shkurtimisht, "Allahu Ekber", është deklarimi në çdo moment dhe me zë të lartë para gjithë botës, se pushteti, fuqia absolute dhe sundimi i vërtetë, i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar. Ajo është një shuplakë që bie mbi fytyrat e atyre që mburren për shkak të pasurisë, pozitës e postit. Ajo i tregon gjithkujt vendin që i takon. Ajo sfidon idhujtarinë. Ajo është forca e besimtarëve dhe tmerri i mohuesve. E gjithë çështja është të jesh i vetëdijshëm ndaj kësaj force. Po ashtu, shprehjen "Allahu Ekber/ Allahu është më i Madhi", të cilën gjuhët tona e shqiptojnë me qindra herë, duhet ta dëgjojnë edhe veshët tanë. Por ky dëgjim, nuk duhet të jetë si çdo dëgjim tjetër. Ajo duhet të dëgjohet e perceptuar si një frymë gjallëruese. Dhe pikërisht atëherë, do ta kemi kuptuar mirë edhe mesazhin "Allahu Ekber".



NDIKIMI I KURANIT

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, që ata të meditojnë.” (Hashr, 21)

Kurani Fisnik është aq ndikues, sa që po të kishte zbritur mbi një mal, ai do të ishte ndikuar shumë, edhe pse nuk ka përgjegjësi në zbatimin e urdhrave kuranorë. Nisur nga kjo, nëse njerëzit të cilët kanë përgjegjësi në zbatimin e urdhrave kuranorë, nuk ndikohen nga Kurani, tregon se ata nuk kanë frikë nga Allahu dhe se zemrat e tyre janë më të ngurta se malet e lartë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta...” (Bekare, 74)

Ndërsa Ebu Suud Efendiu thotë:

“Edhe pse malet nuk kanë përgjegjësi ndaj Kuranit Adhimu’sh-Shan, nëse ai do t’u kishte zbritur atyre, ata do të ishin ndikuar aq shumë nga frika ndaj Allahut të Madhëruar, sa që do të ishin bërë copë e thërrime. Nisur nga ky fakt, mosndikimi i njeriut nga Kurani, kundrejt të cilit është përgjegjës për t’u bindur, tregon se zemrat e tyre janë shumë të ngurta dhe të sëmura.”

Djali i vogël i Ebu Bekir Verrakut, rahimehullah, shkante tek mësuesi për të mësuar Kuran. Një ditë, ai u kthye nga mësimi më herët se ditët e tjera dhe me fytyrë të zverdhur. Babai e pyeti:

- Çfarë ke mor bir?

- O baba! Sot mësuesi më dha një mësim nga një ajet i Kuranit. Sapo e mësova kuptimin e tij, u bëra kështu nga frika.

Babai e pyeti përsëri:

- Cili ajet është ai mor bir!

Djali përgjigjet:

“Si do ta ruani veten, nëse vazhdoni të jeni mohues, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen?” (Muzzemmil, 17)

Ja pra, kur ky fëmijë e mësoi kuptimin e këtij ajeti prej mësuesit të tij, u sëmur prej frikës, ra në shtratin e vdekjes dhe dha shpirt. Babai i tij shkante tek varri i tij, qante dhe thoshte:

- Biri yt dëgjoi një ajet prej Kuranit dhe dha shpirt prej frikës së Allahut. Ndërsa ti ke kaq kohë që e lexon të gjithë Kurantin, po të mbaron jeta e po të afrohet exheli, mirëpo ti ende nuk frikësohesh prej urdhrave hyjnorë as sa ky fëmijë! Zemra jote paska qenë më e fortë se guri, prandaj dhe Kurani Adhimu’sh-Shan nuk ndikon në zemrën tënde.

Sipas një transmetimi të Ebu Musa Esh’ariut (r.a.), Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Shembulli i besimtarit të mirë, që e lexon Kurantin, është si fruti i qitrës me shije të mirë dhe aromë të këndshme. Shembulli i besimtarit, që nuk e lexon Kurantin, është sikurse hurma që shijen e ka të mirë, por nuk ka aromë. Shembulli i mynafikut (hipokritit), i cili e lexon Kurantin, është sikur shembulli i krizantemës (lule vjeshtës), aroma e të cilës është e mirë, ndërsa shija e hidhur. Kurse shembulli i mynafikut, i cili nuk e lexon Kurantin, është sikur shembulli i kungullit të egër, që ka shije të hidhur dhe është pa aromë.” (Buhari, Fedailu'l-Kuran, 17; Muslim, Musafirin, 243.)



TË FITOSH ZEMRA

Ky shkrim është si përkujtim për të qenë të kujdes-shëm në lidhje me rëndësinë e zemrës. Ne besojmë se çdo qëllim dhe vepër që bëhet me zemër të pastër, do të jetë e pranuar tek Allahu i Madhëruar.

Ata që kanë zemër të pastër dhe të butë, bëjnë shumë kujdes të mos thyejnë e cenojnë zemrat e njerëzve. Ndërsa, ata që kanë shpirt të ashpër, shumë rrallë mund të arrijnë të fitojnë ndonjë zemër. Kur Allahu i Madhëruar po e dërgonte Musain (a.s.), tek Faraoni, e urdhëroi atë të përdorte një gjuhë të lehtë dhe të butë. Nga kjo, kuptojmë se gjatë bisedës, qoftë me mikun, qoftë me armikun, duhet të tregohemi të kujdesshëm dhe të jemi të butë, sepse butësia është një nga degët e moralit të bukur.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Njerëzit e butë janë të nderuar edhe në këtë botë, edhe në tjetrën”

“Butësia është virtyt i afërt me profetësinë.” (Kenzul'Irfan)

Ndërsa në një hadith tjetër, Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

“Padyshim se Allahu i Madhëruar është i butë dhe i matur. Për rrjedhojë, Ai i pëlqen veprat që bëhen me butësi dhe maturi. Shpërblimin që ia jep një veprë të bërë me butësi e maturi, nuk ia jep veprës së bërë me ashpërsi.”

Po ashtu, në një hadith tjetër, Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

“Kur Allahu i Madhëruar dëshiron mirësi ndaj një familjeje, i bën ata të sillen me butësi dhe maturi ndaj njëri-tjetrit. Nëse butësia dhe maturia do të dukeshin si një qenie me trup, njerëzit nuk do të shihnin gjë më të bukur se ajo. Nëse edhe ashpërsia do të dukej si

një qenie me trup, njerëzit nuk do të shihnin gjë më të shëmtuar se ajo.”

Të ndjekim dhe t'i japim rëndësi aspektit shpirtëror dhe moral të Rasulullahut (a.s.), është nga adhurimet më të mira. I nderuari Mahmud Sami Ramazanoglu, Allahu e mëshiroftë, sillej me mirësi dhe butësi ndaj të gjithëve, pa përjashtim. Gjatë gjithë jetës së tij nuk është parë kurrë të jetë sjellë ashpër me ndokënd e t'i ketë thyer zemrën. Ai ruhej shumë, si nga teprimi, ashtu edhe nga lëshimi, duke zgjedhur rrugën e mesme dhe duke vepruar me maturi në çdo çështje.

O Zot! Për hir të Rasulullahut (a.s.) dhe të dashurve të Tu:

Na e shto dijen!

Na stolis me butësi!

Na ndero me devotshmëri!

Na zbukuro me shëndet!

Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t'ua shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t'u lihet gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t'u zhvlerësohet ajo që kanë punuar.” (Hud, 15-16)

Ebu Dherri (r.a.), ka thënë:

“Njëherë, kur isha së bashku me Rasulullahun (a.s.), ai tha: «Ata që kanë pasuri në këtë botë, do të kenë pak sevape në botën tjetër. Përjashtim bëjnë vetëm ata që ndihmojnë dhe bëjnë mirë majtas e djathtas (përreth).” (Rikak, 13.)



Ajo që kam **MË TEPËR** **FRIKË**

Dr. Murat Kaja

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte më afër besimtarëve se sa ata ndaj vetes së tyre. Për rrjedhojë, ai ka menduar për umetin e tij, më shumë se ata për vete. Jetën e tij ia kushtoi paqes dhe shpëtimit të tyre, duatë e tij ishin gjithmonë për ta dhe ndërmjetësimin (shefaatin) e tij tek Allahu, e ka ruajtur vetëm për ta. Ai shqetësohej shumë për rreziqet e mëdha me të cilat do të përballlej umeti islam pas tij. Për këtë arsye, kohë pas kohe e ka njoftuar umetin e tij për këto rreziqe, duke i paralajmëruar ata. Disa prej këtyre rreziqeve janë:

1. DIJETARËT QË DO TË RENDIN PAS FAMËS DHE INTERESIT

Rasulallahu (a.s.), ka thënë:

“Ajo që kam frikë më tepër për umetin tim, është dyfyturëshi i ditur.” (Ahmed bin Hanbel, Musned, I, 22.)

Këta janë dijetarë që kanë njohuri të gjera, një gjuhë të rrjedhshme dhe ndikuese, por zemrat e tyre janë në injorancë dhe nuk punojnë me dijen e tyre. Këta persona, që edhe besimin/itikadin e kanë të devijuar,

arrijnë të mashtrojnë shumë njerëz me gjuhët e tyre magjepsëse. Ata e kanë kthyer dijen në profesion dhe me të synojnë të arrijnë interesat e tyre materiale dhe shpirtërore. Për këtë arsye, ata nxjerrin në rend të ditës çështje mbi të cilat ekzistojnë polemika dhe sulmojnë çështjet mbi të cilat është arritur konsensus dhe marrëveshje, me qëllim që të tërheqin vëmendjen e njerëzve mbi vete dhe të bëhen të famshëm. Ata e dëmtojnë rëndë fenë, duke luajtur me besimin dhe adhurimin e shumë njerëzve. Prandaj, duhet të tregohemi vigjilentë ndaj tyre dhe t'i besojmë fjalës së dijetarëve të drejtë. Pejgamberi ynë (a.s.), thotë:

“O Ibn-i Omer! Kapu fort pas fesë tënde, kapu fort pas fesë tënde! Sepse ajo është mishi dhe gjaku yt. Bëj kujdes prej kujt e mëson fenë tënde! Dijet dhe ligjet e fesë merri prej dijetarëve që ndodhen në rrugë të drejtë, jo prej atyre që lëkunden sa majtas djathtas!” (Hatib Bagdadi, Kifaje fî lmi'r-rivaje, Medinetu'l-Munevvere, Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121.)

Gjithashtu, Pejgamberi (a.s.), thotë:

"Nga fundi i kohës së popullit tim, do të dalin disa dexhallë dhe gënjeshtarë, të cilët do të transmetojnë fjalë që nuk i keni dëgjuar as ju dhe as të parët tuaj. Bëni kujdes, qëndroni larg tyre, ruhuni se mos ju shtyjnë në ngatërresa dhe ju nxjerrin nga rruga (e drejtë)." (Muslim, Mukaddime, 6, 7.)

"Padyshim, se prej umetit tim do të dalin tridhjetë gënjeshtarë (dexhallë). Çdonjëri prej tyre do të pretenojë se është pejgamber. Mirëpo, unë jam pejgamberi i fundit dhe pas meje nuk ka pejgamber tjetër. Ndërsa një grup tjetër prej umetit tim, do të vazhdojë të jetë në rrugë të drejtë deri sa të vijë urdhri i Allahut. Kush del kundër tyre, nuk do të mund t'i dëmtojë ata." (Ebu Daud, Fiten, 1/4252; për krahasim shih. Muslim, Fiten 19; Tirmidhi, Fiten 32.)

2. DREJTUESIT QË TË SHPIEN NË HUMBJE

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"...Ajo gjë që kam frikë më tepër për umetin tim, është shfaqja e liderëve që i shpien njerëzit në humbje (që i devijojnë ata nga rruga dhe i urdhërojnë në bid'ate)..." (Ebu Daud, Fiten, 1/4252; për krahasim shih. Muslim, Fiten 19; Tirmidhi, Fiten 32.)

3. BINDJA NDAJ DËSHIRAVE DHE TUNDIMEVE TË EGOS; DËSHIRAT E SHFRENUARA

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Për umetin tim kam frikë këto tri gjëra: Veprën e dijetarit në kundërshtim me dijen e tij, bindjen ndaj dëshirave e tundimeve dhe padrejtësinë e udhëheqësve." (Hejthemi, I, 187; Ebu Nuajm, Hilje, II, 10; Sujuti, Xhamiu's-sagir, I, 12.)

"Nga gjërat që kam më tepër frikë për ju, janë dëshirat e shfrenuara që ju çojnë në kalimin e kufijve në lidhje me stomakun dhe moralin tuaj. Ndërsa tjetra, është devijimi për shkak të dëshirave dhe tundimeve tuaja." (Ahmed, IV, 420, 423; Hejthemi, I, 188; Ebu Nuajm, Hilje, II, 32.)

"Ajo që kam më tepër frikë për umetin tim, është tundimi dhe dëshira e shfrenuar. Tundimi e pengon njeriun nga Zoti. Ndërsa dëshira e shfrenuar e bën të harrojë botën tjetër. Kjo botë ka kthyer shpinën dhe po ikën. Ndërsa bota tjetër ka kthyer fytyrën dhe po vjen. Çdo njëra prej tyre ka bijtë e saj (dëshirues) të mirë. Nëse keni mundësi të jeni prej dëshiruesve të botës tjetër dhe të mos bëheni prej bijve të kësaj bote,

ashtu veproni! Bëni shumë punë të mira! Sepse sot jeni në vendin ku punohet dhe këtu nuk ka llogari. Ndërsa nesër do të shkoni në një vend ku ka llogari, por nuk ka mundësi për të punuar." (Bejhaki, Shuabu'l-iman, XIII, 174/10132.)

Dëshirat e shfrenuara, pra dëshira e tepruar për arritjen e diçkaje, janë iluzione dhe fantazi për të cilat jeta e njeriut nuk mjafton kurrë. Këtu hyjnë edhe ambiciet për pasuri dhe pushtet.

4. KOPRRACIA DHE EGOIZMI

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Ajo që kam më tepër frikë për umetin tim, janë këto tre rreziqe shkatërruese: bindja ndaj koprracisë, rendja pas dëshirave e tundimeve dhe pëlqimi i mendimit të vet." (Ebu Nuajm, Hilje, II, 160)

5. DOBËSIMI I DIJES SË VËRTETË

Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

"Ajo që kam frikë për umetin tim, është dobësimi i dijes së vërtetë." (Hejthemi, I, 107)

Dobësimi i dijes së vërtetë, dobëson edhe ndjenjat fetare të njeriut, duke e bërë atë t'i japë më shumë rëndësi jetës së kësaj bote. Kur zemra anon nga materia, edhe dituria e vërtetë dobësohet. Aq sa zemra anon nga materia, aq largohet edhe prej Zotit të saj.

6. MOHIMI I KADERIT/ CAKTIMIT TË ALLAHUT

Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

"Ekzistojnë tri gjëra, prej të cilave kam frikë për umetin tim: Besimi se do të bjerë shi kur yjet hyjnë nën ndikimin e disa shenjave të zodiakut, padrejtësia e sunduesit dhe përgënjeshtrimi i kaderit." (Ahmed, V, 89.)

7. SYFAQËSIA DHE EPSHET E FSHEHTA

Një ditë, një nga sahabët, Sheddad bin Eusi (r.a.), po qante. Kur u pyet:

"Çfarë të bëri të qash?", ai u përgjigj:

"Më bëri të qaj një hadith i Pejgamberi (a.s.). Një ditë, e dëgjova të Dërguarin e Allahut (a.s.), të thoshte: «Ajo që kam frikë më shumë për umetin tim, është shirkun ndaj Allahut dhe epshi i fshehtë.» Pastaj e pyeta: «O Rasulullah! A do të bjerë umeti yt në shirk pas teje?» Kurse ai u përgjigj:

«Po! Por ata nuk do të adhurojnë diellin, hënën, gurët apo idhujt. Ata do të bëjnë punë vetëm për sy e faqe. E





për sa i përket epshit të fshehtë; do të ketë prej tyre që do të gdhihen agjërueshëm, por sapo t'u dalë përpara ndonjë nga epshet e tyre të fshehta, ata do të rendin pas tij dhe do ta braktisin agjërimin.» (Hejthemi, III, 201. Për krahasim shih. Ibn-i Maxhe, Zuhd, 21; Hakim, IV, 366/7940; Ebu Nuajm, Hilje, I, 268.)

Tek epshet e fshehta, pra dëshirat e forta dhe të fshehta, hyjnë të gjitha gjynahet prej të cilave njeriu duhet të ruhet. Për shembull, kur dikush sheh një grua të bukur, edhe pse i largon sytë prej saj, ai vazhdon ta shohë me zemrën e tij. Para njerëzve ai duket sikur e ka braktisur këtë botë dhe dëshirat e egos, por në zemrën e tij, ato ende vazhdojnë të ekzistojnë. Dhe kur ngelet i vetmuar, ai i bën këto gjynahe në mënyrë të fshehtë.

Sipas një shpjegimi tjetër, syfaqësi është kur njeriu vepron hapur duke dëshiruar të duket në sy të njerëzve. Ndërsa epshi i fshehtë është kur njeriu dëshiron që njerëzit ta shohin dhe ta dinë punën që ai bën.

8. AMBICIA PËR PASURI DHE ANGAZHIMI ME SHKENCAT E KURANIT DUKE NEGLIZHUAR DEVOTSHMËRINË DHE SUNETIN E PEJGAMBERIT (A.S.).

Rasulallahu (a.s.), ka thënë:

“Një nga gjërat që kam më shumë frikë për popullin tim, është shtimi i pasurisë ndër ta dhe rivaliteti me njëri-tjetrin për të. Një nga gjërat e tjera që kam më shumë frikë për popullin tim, është se kur Kurani t'u qartësohet, atë do të mund ta lexojnë lehtësisht të gjithë, besimtari, mohuesi dhe dyfytirësi. «...Ata, zemrat e të cilëve janë të devijuara, ndjekin vargjet më pak të qarta (alegorike), duke kërkuar të krijojnë pështjellim dhe duke kërkuar t'i komentojnë sipas dëshirës së vet. Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm Allahu. Ndërsa ata që janë thelluar në dije, thonë: “Ne i besojmë (Kurani). Të gjitha këto (vargjet e qarta dhe alegorike) janë nga Zoti ynë!” Këtë e kuptojnë vetëm mendarët.» (Al 'Imran, 7)” (Hakim,

Mustedrek, II, 316/3139; Hejthemi, I, 128.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Kam frikë për umetin tim në lidhje me Librin dhe qumështin!” Kur u pyet:

“O Rasulullah! A po na e shpjegon se ç'është puna e Librit?” Rasulullahu (a.s.), tha:

“Kur dyfytirëshit ta mësojnë atë, do të luftojnë me të besimtarët.”

“Po ç'ështëja e qumështit?”, u pyet përsëri:

“Njerëzit e duan qumështin. Për rrjedhojë, ata ndahen nga xhemati, madje braktisin edhe xhumanë.” (Ahmed, IV, 146, 155)

Për shkak se bagëtitë nuk mund të mbahen e të shtohen midis shoqërisë, të zotët e tyre e nxjerrin ato në male e livadhe larg njerëzve. Për rrjedhojë, ata ndahen nga bashkësia dhe duke menduar vetëm për shtimin e tufës, harrojnë namazet, madje edhe xhumanë. Në të njëjtën mënyrë, vepronjë edhe ata që zhyten në punët e tyre të përditshme, duke e nxjerrë plotësisht fenë nga jeta e tyre. Si rezultat i kësaj, arrihet deri aty sa braktiset bashkësia islame, xhamia dhe namazi i xhumanë. Qumështi dhe pasuria e kësaj bote, në dukje janë mirësi dhe nuk mund të shqetësohesh që njerëzve t'u vijë ndonjë dëm prej tyre. Mirëpo, këtu bëhet fjalë për ndërhyrjen e fshehtë të shejtanit. Në të shumtën e rasteve, shejtani i përdor këto dhe në sajë të preteksteve që duken të arsyeshme, i çon njerëzit në humbje.

9. PRISHJA E MORALIT

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Një nga gjërat që kam më tepër frikë për umetin tim, është kryerja e veprës së popullit të Lutit.” (Tirmidhi, Hudud, 24/1457.)

Ky degjenerim morali, që sot quhet homoseksualizëm, është rreptësisht i ndaluar në Islam dhe ata që e veprojnë këtë, janë të mallkuar. (shih. Tirmidhi, Hudud, 24/1457.)

T'i dorëzohesh Atij

A. Jasin Demirxhi

Allahu i Madhëruar thotë:

"Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!" (Maide, 23)

"Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Al'Imran, 159)

"Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai." (Talak, 3)

"A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?" (Zumer, 36)

Thuaj: "Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!" (Teube, 51)

"(Xheneti është për) ata që kanë duruar dhe janë mbështetur në Zotin e tyre." (Nahl, 42)

"Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin." (Shuara, 217)

Resulullahu, (a.s.), ka thënë:

"Ma prezantuan një pjesë të ymetit. Kishin mbushur malet dhe shkretëtirat. U habita që ishin aq shumë dhe u gëzova njëkohësisht.

"U gëzove?" - më pyetën. "Po", -u thashë. Më thanë se vetëm shtatëdhjetë prej tyre do të hyjnë në xhenet pa u marrë në llogari. "Cilët prej tyre?" - i pyeta. Më thanë se ata që nuk kanë përzier në punët e tyre magji e falle të ndryshme, ata që nuk i kanë besuar askujt tjetër përveç Allahut të Madhëruar."

Përsëri, në një rast tjetër, Resulullahu (a.s.), ka thënë:

"Sikur t'i kishit besuar plotësisht Allahut, Ai do t'ju furnizonte sikurse furnizon zogjtë, të cilët në mëngjes dalin me stomak të zbrazët dhe kthehen në darkë me stomak të mbushur."

Kush i mbështetet Allahut të Madhëruar, Ai do t'i bëhet ndihmë për çdo punë. Do t'i sjellë furnizim nga vendet ku nuk i pret aspak. Kush i beson kësaj bote, Ai do ta lërë atë të përballat me këtë botë.

Imam Gazali (k. s.), në veprën e tij "Kimja-i Saade" (Balsami i Lumturisë), thotë:

"Shumë nga njerëzit e mendojnë dorëzimin tek Allahu sikur është t'ia lësh punët rastësisë, të mos bësh asgjë me zgjedhjen personale, të mos përpiqesh të fitosh para, të mos ruhesh nga gjarpri, akrepi apo luani, të mos pish ilaçe kur të sëmuresh, të mos mësosh fenë e sheriatin apo të mos ruhesh nga armiqtë. Ta mendosh kështu dorëzimin tek Allahu është e gabuar. Nuk është e përshtatshme me vetë sheriatin. Si mund të jetë dorëzim tek Allahu diçka e tillë, ndërkohë që bie ndesh me sheriatin?"

Ebu Bekri (r.a.), ishte njeri që i qe dorëzuar tërësisht Allahut të Madhëruar në çdo vepër të tij. Kur qe përgjedhur si kalif i myslimanëve, ishte shitës i copave në pazar. Kur e patën pyetur: "O kalif! Si mund të bësh tregti, ndërkohë që ti drejton një shtet?", ai u qe përgjigjur kështu: "Nëse nuk kujdesem për fëmijët e mi, si mund të kujdesem për të tjerët?" Pas kësaj, e panë të udhës që kalifes t'i ndanin një pagesë mujore nga thesari i shtetit. Kështu, ai nisi në çdo kohë të merrej vetëm me punët e shtetit. Ai bënte tregti, ndërkohë që ishte njeriu më shembullor lidhur me dorëzimin tek Allahu. Nuk kishte për qëllim thjesht të fitonte para. Fitesën e tij nuk e konsideronte si pasuri personale, por si pasuri e Zotit të Madhëruar. Nuk e donte pasurinë e vet më shumë se pasurinë e vëllezërve të vet në fe."

Si përfundim, thelbi i dorëzimit tek Allahu është të presësh vetëm nga Allahu dhe jo nga njerëzit dhe të mos u besosh shkaqeve.

Resulullahu (a.s.), çdo natë lyente sytë me *syrme*. Çdo muaj bënte *hixham*. Pinte edhe ilaç, sa herë që kishte nevojë. Kur kishte ndonjë plagë, aty vendoste këna. Kur nuk arrinte të gjente diçka për plagën, vendoste pluhur dheu të pastër. Ai përdorte ilaçe. Këto shpjegohen gjatë në librat që flasin për mjekësinë profetike.



Ahmet Basher

Të martosh
TË FARFËRIT

Siç dihet, njësitë më të vogla të shoqërisë, përbëhen nga familjet. Sa të shëndetshme, të qeta dhe të lumtura të jenë familjet, aq e shëndetshme, e qetë dhe e lumtur është shoqëria.

Në formimin e një familjeje myslimane, gjëja më kryesore fillon me nikahun (kurorën). Lidhja e dashurisë midis djemve dhe vajzave të reja, të cilët kanë arritur moshën e martesës, përcinohet me anë të nikahut. Nëse këta të rinj ushqehen me kafshatë hallall, edhe fëmijët që do të vijnë në jetë prej tyre do të jenë po aq të pastër, të shëndetshëm dhe me karakter të fortë.

Në ditët tona, veçanërisht nëpër fshatra, të rinjtë me moshë shumë të vogël po martohen nga familjet e tyre me pretekste ekonomike, pa e njohur ende mirë rëndësinë e martesës dhe delikatesën e saj. Ndërsa nëpër qytete, moshë e martesës është shtyrë shumë me pretendimin, se "po studioj" apo "do të gjej punë".

Në fakt, nuk është e drejtë që çështja e martesës të lihet, as shumë herët, por as shumë vonë. Në sajë të institucionit të martesës, të rinjtë ruhen nga haramet (amoralitetet). Në lidhje me këtë, Pejgamberi ynë (a.s.), thotë:

"Kush martohet, ka ruajtur gjysmën e fesë."

"Kush arrin moshën e martesës dhe ka mundësi të martohet, le të martohet. Kush nuk ka mundësi, le të agjërojë."

Për fat të keq, në vendet tona, gjatë ceremonive të martesave bëhen shumë gjëra të gabuara, të cilat nuk duhet të ndodhin në një shoqëri islame, si luks i tepëruar, shpërdorimi, veprime të papëlqyeshme, madje edhe gjëra të ndaluara nga feja. Me pretendimin, se "ç'thotë bota?" apo "kjo është ditë e veçantë", etj., po shohim gjithandej dasma me orkestër, me alkool dhe argëtime të përziera me gra e burra bashkë.

Ndërsa në lidhje me mobilitet e shtëpisë, të rinjtë e sotëm duan gjithçka të plotësuar, që nga A-ja deri tek Zh-ja. Ata nuk duan të qëndrojnë pranë prindërve, por duan të jetojnë në shtëpi të veçanta. Madje, duke u munduar t'u ngjajnë të pasurve, dëshirojnë që pas dasmës të shkojnë edhe për muajin e mjaltit.

Pikërisht këto fenomene e vështirësojnë jashtëzakonisht shumë martesën e të rinjve të varfër. Në fakt, pjesa e pasur e shoqërisë është më e vogël se pjesa e varfër. Por, edhe pse janë të varfër, të gjithë duan të imitojnë të pasurit. Dhe për këtë arsye, familjet hyjnë nën barrën e borxheve, aq sa nuk mund t'i mbajnë. Jeta martesore e të rinjve që fillon me borxhe, shkatërron harmoninë familjare. Vështirësitë ekonomike bëhen shkak që me kalimin e kohës të pakësohet edhe dashu-

ria midis bashkëshortëve, madje ndonjëherë edhe e eliminon fare atë. Për këtë arsye, ndodhin edhe shumë divorce të çifteve të reja.

Sa mirë do të ishte sikur të pasurit t'i shpenzonin paratë e tyre, të cilat normalisht i shpërdorojnë në luks e gjëra të tjera, për të martuar të rinjtë që dëshirojnë të formojnë familje. Martesa për hir të Allahut e të rinjve, që nuk mund të martohen për arsye ekonomike, është një adhurim më i mirë se adhurimet vullnetare. Martesa e të rinjve të varfër është shumë e rëndësishme në mbrojtjen e nderit, turpits, edukatës dhe moralit të mirë në shoqëri.

Të pasurit që martojnë të varfrit, shpëtojnë nga përgjegjësia duke e përdorur pasurinë në rrugë të Allahut, marrin duatë e të rinjve përgjatë gjithë jetës dhe kontribuojnë në mbrojtjen e edukatës shoqërore duke e larguar atë nga haramet. Ndërsa të varfrit që duan të martohen, duhet të kënaqen me mobilitet të thjeshta dhe një dasmë të lehtë. Nëse një pjesë të mobilieve e marrin pas dasmës, duke i paguar pak nga pak sipas radhës së nevojës që kanë, do të dinë edhe vlerën e pajisjeve shtëpiake që marrin, por do të ndjejnë edhe një lumturi të veçantë për çdo pajisje të re që marrin në shtëpinë e tyre. Thesari i Zotit është i pashtershëm; me kalimin e kohës Ai jep çdo gjë.

Allahu e mëshiroftë, i nderuari Musa Efendiu, çdo vit martonte me ceremoni dasme dhjetë apo njëzet çifte të rinjsh që mbaronin kursin e Kuranit. Pas një dreke në Vakëfin Aziz Mahmud Hydaji, kjo ceremoni mbyllej me një bisedë fetare dhe dua. Në fund, të ftuarit ofronin dhuratat e tyre për çiftet e rinj dhe largoheshin prej aty. Sa bukur, për të gjithë bëhej një ceremoni. Padyshim se edhe sot, ka ende bamirës që e vazhdojnë këtë traditë të mirë, pra martesën e të varfërve që nuk kanë mundësi të martohen. Mirëpo, ne dëshirojmë që këta njerëz të shtohen edhe më shumë.

Zinjaja (imoraliteti), të cilën Zoti ynë në Kuran e ka ndaluar madje edhe afrimin tek ajo, në kuadër të përputhjes me ligjet e Evropës, nuk konsiderohet më si faj as në ligjet e shtetit. Për më tepër, duke filluar që nga televizioni, interneti, shtypi i përditshëm, e deri tek reklamat e ndryshme, seksualiteti është një fenomen që po nxitet shumë dhe në mënyrë të vazhdueshme. Një gjendje e tillë e vështirëson shumë punën e të rinjve që nuk mund të martohen.

Zoti na ruajttë sytë, zemrat, duart dhe belin prej haramëve. Gjithashtu, u faltë fëmijëve tanë bashkëshortë/e dhe pasardhës që do të jenë drita e syve tanë.

Amin!..



KU SHKOI INTUITA JONË?

Xhemal Nar

Myslimanët, pak a shumë, duhet t'i ndejnë pëshpëritjet e njerëzve përballë tyre, fjalët, sjelljet, lëvizjet dhe qëllimet e mira apo të këqija në zemrat e tyre dhe, në bazë të këtyre, të marrin masat e duhura ose të zhvillojnë strategjinë dhe metodën e tyre.

Edhe ngjarjet kanë gjuhën e tyre. Siç thotë një shprehje, kjo është si "të nuhasësh ajrin". Dhe kjo kërkon intuitë të veçantë.

Moskuptimi i këtyre qëllime dhe ngjarjeve, që ndonjëherë janë shumë të qarta dhe hedhja e vetes në rrezik në mënyrë të shkujdesur, duke pësuar dëme dhe humbje e bën njeriun të hutohet përballë kësaj mungese të zgjuarsisë dhe dashje pa dashje e bën atë të bëjë pyetjen në titullin e mësipërm: "Ku shkoi intuita jonë?"

ÇFARË ËSHTË INTUITA?

Intuita është ndjesia e ngrohtësisë dhe e dritës, e cila formohet me ndezjen e një zjarri në pjekurinë e zemrës, si rezultat i përplasjes së gurit të dijes me hekurin e punës së mirë, gjë e cila nxjerr në pah një udhëzues për njeriun gjatë gjithë udhëtimit të tij në jetën e kësaj bote. Kjo duhet



të jetë edhe ajo që të parët e shprehin si “të kapësh kuptimin pa ndjerë nevojën e fjalëve”.

Një ditë, kur Enesi (r.a.), po shkante tek Osmani (r.a.), pa një grua në rrugë dhe syri i tij mbeti pak si tepër i fiksuar në bukurinë e saj. Mbase njeriu nuk është përgjegjës për shikimin e parë, por fiksimi, zgjatja e shikimit ose përsëritja e tij, është dhunim i kufijve dhe për këtë arsye, ky shikim është bërë i ndaluar (haram). Me këto mendime në kokë, ai shkon tek Osmani (r.a.), i cili sapo e sheh, i thotë:

-O Enes! Erdhe këtu, edhe pse në sytë e tu ka she-nja zinaje (imoraliteti)!..

Enesi (r.a.), i cili u hutua përballë këtyre fjalëve, pyeti:

-A vazhdon të vijë shpallja edhe pas Rasulullahut (a.s.)?

Ndërsa Osmani (r.a.), i tha:

-Jo! Kjo është urtësi dhe një intuitë e saktë.

Në kohën tonë, shumë prej vëllezërve tanë -të mos u ngelet qejfi, por kjo është e vërteta- dalin kundër tasavufit pa pasur dije. Për këtë arsye, ata mohojnë edhe mrekullitë si intuitën. Por Ehl-i Suneti thotë se “mrekullitë (kerametet) e evlijave janë të vërtetë” dhe është një e vërtetë e cila njoftohet edhe në Libër, edhe në Sunet. Ne vetëm sa mërzitemi me gjendjen e këtyre vëllezërve tanë, por nuk e bëjmë problem. Madje, nuk bëjmë as ashtu siç bëjnë disa kundër nesh, duke e kthyer këtë në një çështje shirku dhe besimi. Ne e dimë se edhe pa jetën e tasavufit, sheriat (ligji i Allahut) mund të jetohej dhe mund të hyhet në xhenet. Të gjithë besimtarët janë vëllezër dhe kanë të drejtë të duhen.

Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), thotë:

“Ruhuni prej intuitës së besimtarit; sepse ai sheh me Dritën e Allahut.” (Tirmidhi, Tefsir, 15.)

Siç shihet, intuita është një dritë. Një dritë që Allahu i Madhëruar e vendos në zemrën e robërve të cilët i do. Ashtu siç drita ndriçon vendin përreth saj, edhe drita në zemër na ndihmon të shohim, të ndjejmë dhe të kuptojmë gjërat përreth, të cilat do të ngeleshin në errësi po të mos ishte ajo. Në sajë

të kësaj drite, besimtari kupton pjesën e brendshme të ngjarjeve, sheh rreziqet dhe duke i parashikuar saktë ato që ndodhen në mendje dhe zemra, i merr masat në kohën e duhur dhe arrin të shpëtojë.

Në një hadith fisnik, Rasulullahu (a.s.), thotë:

“Ndër popujt që kanë jetuar para jush, ka pasur njerëz të veçantë me frymëzim. Nëse në popullin tim ka ndonjë prej tyre, padyshim që ai është Omeri.” (Buhari, Ashabu'n-Nebi, 6.)

Përveç kësaj, dihet mirë se mendimi i Omerit (r.a.), në lidhje me shumë çështje, është përputhur saktë edhe me ajetet që kanë ardhur më pas.

Jeta është si një lumë i përbërë prej mijëra detajesh, i cili duke gurgulluar rrjedh drejt e në oqeanë. Jeta e njeriu nuk mjafton për t'i shqyrtuar dhe gjykuar një nga një këto mijëra e miliona detaje të përditshme. Në vend të mësimit dhe

grykimit një nga një të këtyre detajeve, njeriu duhet të mësojë rregulla të përgjithshme, metoda dhe mënyra të sakta, me anë të të cilave do të vlerësojë këto detaje duke i krahasuar me to. Pastaj, në bazë të këtyre, ai duhet të gjykojë vetë për çdo ngjarje. Kjo është ajo që arsimit dhe edukimit i jep njeriut. Për këtë arsye, nuk është e pëlqyeshme të flasësh shumë dhe të pyesësh pa vend. Prandaj dhe njerëzit e heshtur janë dashur e lavdëruar nga të gjithë. Kjo është ajo që quhet “urtësi”.

Një njeri i urtë, është pyetur në një kohë para zgjedhjes: “Cilës parti t'ia japim votën?” Ndërsa ai iu përgjigj: “Bijtë e mi e dinë se kujt duhet t'ia japin votën.”

Po, kaq e thjesht është çështja!

Sigurisht që shembulli i votës është një shembull i rëndomtë. Në fakt, ajo që kërkohet të thuhet këtu, është: “Këto dhe ngjarje të tjera të ngjashme nuk është nevoja të pyeten. Ata që marrin të njëjtin arsim dhe edukim, mësojnë me të njëjtat mënyra e metoda, bëhen pothuajse të ngjashëm dhe pa pasur nevojë të pyesin njëri-tjetrin se ku dhe si duhet të sillen, arrijnë të kuptohen dhe të veprojnë në mënyrë të përbashkët.”

Atëherë, a ka nevojë për më shumë pyetje?





A ka Islami stil jete?

Sami Byjkkajnak

Nuk ka asnjë dyshim që Islami ka një mënyrë të veçantë të jetuari, sepse ai ka ndërtuar një sistem jete specifike, duke filluar nga të ushqyerit deri tek të qëndruarit, të fjeturit deri tek të udhëtuarit, bile edhe të shëtiturit, nga natyra e marrëdhënieve shoqërore deri tek të përmbushurit e nevojave personale. Kjo rregullsi nuk është një format i mbetur nga e kaluara, përkundrazi ajo është formësuar, e tillë që të sfidojë shekujt e të mbijetojë deri në Ditën e Fundit.

Pejgamberi (a.s.), duke praktikuar personalisht urtësitë e dhuruara kuranore ka arritur të themelojë një sistem jete të dashur te Krijuesi. Në këtë sistem jete kufijtë janë të qartë; ose jeni brenda kornizës islame, ose keni mbetur jashtë saj. Mentaliteti “të përfitojmë pak andej a pak këndejt” nuk përputhet me metodën islame të jetës.

Sot, në kushtet në të cilat jetojmë, çështja në të cilën mashtrohen më shumë myslimanët është çekuilibrimi nga mënyra islame e të jetuarit.

Myslimanët, të vetëdijshëm që ndodhen nën “presionin modernist”, mundohen t’i përshtaten “jetës moderne islame”, duke u zvarritur pas qasjes liberale të ashtuquajtur islame, gati si një menu “turli”, në të cilën s’lënë gjë pa përzier e si të tillë e bëjnë të pangrënshme... një “turli” e gatuar nga një mendje “liberale”, pak nga tradita islame e shumë nga menuja moderne...

Ky është një sistem i gatuar gjetkë, por prodhim i një projekti të servurur pikërisht përpara myslimanëve. Ky është një sistem që e ka burgosur Islamin vetëm brenda kornizave të ndërjegjegjes... Shprehje të tilla si: “E kam zemrën e pastër, babain haxhi, gjyshin hoxhë” e orientojnë njeriun drejt justifikimeve të pabaza. Kjo

ingjan një projekt të heshtur të shndërrimit të kristianizmit në protestanizëm. Nën ndikimin e këtij projekti, përkatësia ndaj materiales po prin përpara, mendimi liberal po përfshin jetën.

Kur themi përkatësia ndaj materiales, nënkuptojmë të jetosh në këtë botë sikur nuk ka jetë të përtejme, ndërsa domethënia e mendimit liberal është tendenca e të jetuarit të çdokujt siç dëshiron, pa asnjë kufizim.

Si përfundim, modernizmi dhe postmodernizmi kanë përfitime të mëdha prej këtij lloj mentaliteti, të ardhurat ekonomike të tij ndezin kapitalizmin. Çdo individ që qaset ndaj materiales dhe liberalizmit, në shumicën e rasteve e dorëzon veten pas konsumit.

Nevoja për konsum prodhon qendra të mëdha tregtare, konsumi rrit burimet e kapitalizmit. Një jetë e çmendur, konsum i papërmbajtshëm, tërbim i papërshkrueshëm...

A E LEJON ISLAMI NJË METODË TË TILLË JETE?

Islami nuk mund të pranojë një myslimanizëm të përbërë nga pak besim, pak adhurim dhe pak moral. Përkundrazi, Islami aprovon atë qëndrim islam të formësuar tërësisht nga besimi, adhurimi, morali, si dhe të praktikuar dhe të jetuar në realitet. Një mendësi e tillë, që e sheh jetën vetëm në këtë botë, që nuk ka një merakosje për jetën e përtejme, që mundohet të ecë mbi supet e të tjerëve dhe nuk lejon që të tjerët të përfitojnë prej tij, që mendon se gjithësecili mund dhe duhet të bëjë ç'të dojë, nuk mund të përputhet me Islamin. Kjo mendësi e ka emrin "Islam i moderuar". Perëndimi është munduar shumë që ta ngulisë këtë shprehje në mesin e myslimanëve. Në këtë përpjekje të tij, perëndimi ka përdorur dhe vazhdon të përdorë Tuqinë dhe turqit. Në të vërtetë, serialet dhe telenovelat turke, videoklipet e këngëve janë përhapur në çdo qoshe të botës islame. Kjo është një përpjekje për të manipuluar botën islame me pretekste të tilla, si: "Shihni si jetohej jeta në një vend po aq mysliman sa Turqia, si vishen djem e vajza, si është jeta familjare. Edhe ju mund të jetoni kështu. Sikur të kishte ndonjë problem, turqit nuk do të jetonin kështu." Programet televizive, reklammat u bënë një mjet për arritjen e këtij projekti. Me këto lloj mjetesh, perëndimi ka filluar tashmë të formësojë sipas vetes: familjen, shoqërinë, modelin e flokëve, të mjekrës, veshjen, metodën e jetës, marrëdhëniet shoqërore, ekonominë...

Myslimanët duhet të rishikojnë edhe një herë qëndrimet e tyre ndaj këtij fenomeni. Ejani, le të bëjmë një vetëllogari të lidhjes sonë me metodën islame të të jetuarit apo me metodën e injektuar nga jeta moderne. Le ta pyesim veten:

NË Ç'VEND TË ISLAMIT PO QËNDROJMË?

Ç'vend zë Allahu në jetën tonë? Sa e ndjejmë prani-

në e Krijuesit, që sheh e dëgjon gjithçka? A mos vallë veprojmë të vetëdijshëm që punët tona regjistrohen nga melekët apo mashtrojmë veten, duke menduar që punët tona të fshehta s'i sheh njeri? Edhe pse themi që Allahu është më afër nesh sesa damari i qafës, a jemi me të vërtetë të vetëdijshëm?

Sa jemi ndikuar nga mentaliteti i të jetuarit modern e postmodern, a thellohemi të meditojmë nga adhurimet e kryera? A ndajmë po aq kohë për adhurimet e përditshme, sa ndajmë për mjetet e ndryshme të komunikimit, që sa vijnë e ndikojnë më tepër jetën tonë?

A mos vallë kemi thyer kufirin haram-hallall, duke u bërë pre e kapitalizmit? Në shërbim të kujt janë paratë tona, portofolet tona? A janë të pastra ato apo të përziera me lloj-lloj gjërash të dyshimta?

A po zhvendosen marrëdhëniet farefisnore drejt atij niveli që modernizmi kërkon "si të jetë, si të mos jetë nuk ka rëndësi, unë e mbyll derën time dhe nuk dua t'ia di...?"

A mos vallë po praktikojmë botëkuptimin: "Ç'më duhen mua të tjerët, gjithkush të jetojë jetën e vet, ç'më interesojnë mua fëmijët, lypsarët apo pleqtë në rrugë?"

A mos po dallohen tek ne shenja të largimit nga Kurani dhe Suneti? A po hyjnë në jetën tonë besime dhe qëndrime të tjera?

Sa është përqindja e Islamit në jetën tonë familjare? Sa ka Islam në dasmat tona, në fejesat tona? Apo mos jemi bërë të pazotë të dallojmë madje edhe llojin e unazës?

Sa po përpiqemi të edukojmë fëmijët tanë me një karakter mysliman? A mos po i orientojmë më tepër se ç'duhet nga kjo botë me pretekstin "aman le të ecin në jetë, të bëhen doktorë, inxhinierë, të bëjnë karrierë" apo po i edukojmë ta duan Ahiretin, duke u thënë: "Të lutem biri im! Mos të ndahemi as në Ahiret nga njëri-tjetri, të jemi bashkë edhe në Xhenet."

Sa ndikues është Islami në punën tonë? A po përfshijmë kamatën në marrëdhëniet tona, a po e kemi të lehtë të përdorim interesin në shitblerjet tona? A po mendojmë se "ne nuk duhet ta shkatërrojmë Ahiretin tonë, e pakta pastë bereqetin, apo po mashtrojmë veten, duke menduar që "të pasurohem sa më tepër, të punësoj sa më shumë, në mënyrë që të jap zeqat sa më shumë."

PYETJA E FUNDIT:

A punojmë për një libër veprash të mira, që do të na mbrojnë kur të gjykohej para Allahut apo për një libër të nxirë me punë të pavlera, që do të na rrokullisë në humnerën e humbjes?...

6 KONVERTIMET MË TË FAMSHME NË ISLAM

Indira Krymi

FAMILJA BARMAKID (600-900)

Barmakidët ishin një familje e administratorëve Budistë nga qyteti i Balkh-ut, që tani njihet si Afganistani. Kur kalifati i Umajad-ëve pushtoi zonën rreth të 600-ve, familja u konvertua në Islam. Pas revolucionit Abasid në 750, Barmakidët u bënë të famshëm si administratorë të talentuar. Ata morën me vete shekuj eksperience në Perandorinë Persiane për mënyrën e menaxhimit të burokracive të mëdha qeveritare, diçka për të cilën Kalifët arabë Abasidë nuk ishin të aftë.

Si vezirë, ata ushtruan influencë të madhe në formimin e qeverisë në fund të shekullit të 8. Jahja Ibn Khalid al-Barmaki kishte ndikuar pjesërisht. Ai ishte caktuar si mësuesi dhe mentori i të riut Harun al Rashid, i cili do të bëhet kalif në periudhën e artë të kalifatit Abasid. Nën orientimin e tij, Harun al Rashid arriti të vendoste paqe me fqinjët e Perandorisë, rritje ekonomike, mbrojtje të dijetarëve, krijimin e një sistemi infrastrukturor që rivalizoi atë të Romës antike. E gjithë familja Barmakide kishte një ndikim të madh në formën politike të botës myslimane që do të vazhdonte për shekuj.

BERKE KHAN (PERIUDHA E FILLIMIT E PANJOHUR- 1266)

Si nipi i pushtuesit të madh mongol Xhengis Khan, Berke Khan ishte një figurë e rëndësishme e botës mongole në mesin e viteve 1200. Si mongolët e tjerë, ai fillimisht praktikonte një formë adhurimi pagan. Si lider i Hordhisë së Artë (Ushtrisë Mongole), ai u dërgua në veri të maleve Kaukaz, dhe Europës lindore për të pushtuar turqit Kipçakë. Ai rrjedhimisht arriti të drej-

tonte ushtritë drejt Hungarisë. Pastaj gjatë udhëtimit të tij drejt atdheut Mongol, ai ndaloi në Bukhara ku pyeti myslimanët vendas për besimin e tyre. Ai u bind për mesazhet e Islamit dhe u konvertua, duke u bërë kështu lideri i parë mongol i cili pranoi Islamin. Pas konvertimit, shumë ushtarë të ushtrisë së tij gjithashtu u konvertuan, gjë që çoi në tension me ushtritë e tjera mongole.


Pasi dëgjoi për plaçkitjen e Bagdatit në 1258 nga kushëri i tij, Hulagu Khan, Berke premtoi të hakmerrej, duke deklaruar:

Ai (Hulagu) ka plaçkitur të gjithë qytetet e myslimanëve, dhe ka sjellur vdekjen e Kalifit. Me ndihmën e Zotit unë do të kërkoj llogari për gjithë këtë gjakderdhje. Duke lidhur aleancë me Sulltanatin Mamluk të Egjiptit, Berke arriti të ndalonte ushtrinë e Hulagusë që të pushtonin tokat e mbetura të myslimanëve në Egjipt, Siri, dhe Hixhaz.

ZAGANOS PASHA (PERIUDHA E FILLIMIT E PANJOHUR-1461)

Me origjinë shqiptare apo greke, që fëmijë, Zaganos





Pasha u thirr për shërbim ushtarak në elitën e trupave jeniçere të Perandorisë osmane. Si jeniçerët e tjerë, ai u edukua me Islam, për administrimin civil, dhe për çështje ushtarake. Ai u caktua si mentor dhe këshillues I Mehmetit II (i riu) i cili më pas do të bëhej sulltani i 7-të i dinastisë Otomane. Kur Mehmeti u bë sulltan, ai caktoi Zaganos Pashanë si vezir të dytë. Zaganos Pasha konsultohet zakonisht për të gjitha çështjet e shtetit, veçanërisht për rrëthimin dhe pushtimin e Kostandinopojës në 1453. Gjatë rrëthimit, atij iu dha komanda e një pjese të ushtrisë në veri të qytetit, dhe trupat e tij ishin të parët që arritën të kapnin me sukses një pjesë të mureve legjendare të Kostandinopojës. Trashëgimia e tij jeton dhe sot me pasuri të shumta (duke përfshirë xhami, hamame, etj.) në atdheun e tij të Balikesitit gjithashtu dhe në Edirne.

IBRAHIM MUTEFERRIKA (1674-1745)

Një akuzë e zakonshme e hedhur mbi Perandorinë Osmane është se ishte e fjetur dhe rezistente ndaj çdo shpikjeje të re. Një hungarez i konvertuar në Islam Ibrahim Muteferrika. Ai ishte fillimisht një diplomat osman i cili arriti të kultivonte marrëdhënie të ngushta me Perandorinë Osmane, Francën dhe Suedinë. Si rezultat i punës diplomatike, ai ishte i ekspozuar me idetë Europiane mbi Rilindjen dhe përdorimin e kudogjetur të Shtypshkronjës. Kur u kthye në Stamboll, ai krijoi një shtypshkronjë, ku printoi shumë atlasë të kopjuar, fjalorë, dhe disa libra fetarë. Midis punëve të publikuara, ishte një atlas i botës i bërë nga gjeografi i famshëm Katip Çelebi, i cili ilustroi tërë botën e njohur të asaj kohe më saktësi dhe detaje të pabesueshme. Përveç printimit të thjeshtë të librave, Muteferrika gjithashtu shkroi lëndë të ndryshme, si Histori, Teologji, Sociologji, dhe Astronomi.

ALEXANDER RUSSEL WEBB (1846-1916)

Në mesin e shekullit 19-të, në Amerikë, gazetaria kishte filluar të përhapej si një masë influenciale për publikun. Një nga burrat që ndihmoi në përhapjen e kësaj vale gazetareske, ishte Alexander Russell Webb. I pabindur për fenë e tij të krishterë, dhe duke qenë një gazetarë i mirënjohur, ai filloi të lexonte shumë për fetë e tjera, dhe ishte veçanërisht i interesuar për Islamin. Kur u caktua nga Departamenti i shtetit të Shteteve të Bashkuara për të punuar në ambasadën amerikane në Filipine në 1887, ai përfitoi nga mundësia për të filluar takimet intensive me myslimanët në Indi rreth Islamit. Edhe pse ai ishte njohur fillimisht me Islamin përmes anëtarëve jo ortodoks (sinqerisht, jo myslimanë) të Lëvizjes Ahmedije, ai gjeti një rrugë drejt Islamit. Ai

vazhdonte të udhëtonte përmes botës Islame, duke studiuar Islamin dhe duke u takuar me dijetarë. Në 1893, ai hoqi dorë nga posti në Departamentin e shtetit dhe u rikthye në Amerikë. Kur u rikthye në Shtetet e Bashkuara, ai publikoi shumë libra rreth Islamit dhe filloi një gazetë islame, duke shpjeguar Islamin publikut amerikan. Në dekadat e hershme të shekullit 20-të, ai vazhdonte të ishte një zë i shquar për Islamin në Shtetet e Bashkuara, edhe pse i caktuar si një këshilltar nderi i Sulltan Abdul Hamidit II. Ai vdiq në 1916, dhe u varros jashtë Radhrfordit, New Jersey.

MALCOM X

Ndryshe nga të tjerët në këtë listë, Malcom X është një mashkull i cili ka nevojë për shumë prezantim. Në vitet e hershme të jetës, ai u përpoq shumë të gjente vendin e tij në botë. Pasi braktisi shkollën herët, ai futej shpesh në telashe, rrjedhimisht duke e çuar veten në burg në 1946. Gjatë tetë viteve në burg, ai u njoh me idetë e Kombit të Islamit-një "pseudo" grup islamik i krijuar në vitet e hershme të 1900, bazuar në idetë e epërsisë së zezë, dhe dëmtimin e racës së bardhë. Pasi u lirua në 1952, ai u takua me "profetin" e NOI, dhe u bë ministër i grupit. Për shkak të elokuencës dhe inteligjencës së tij të pabesueshme, Malcom X u ngrit shpejt në majat e NOI, duke u bërë lider i grupit në mesin e viteve 1950. Duke qenë periudha e Lëvizjes së të drejtave të qytetarëve amerikanë, Malcom X u bë një nga zërat më të njohur në Amerikë, që luftonte për të drejtat e barabarta të afro-amerikanëve. Ndryshe nga një lider tjetër i madh, Martin Luter King, Malcom X besonte që zezakët duhet të mbronin veten, edhe pse me dhunë, pavarësisht shtypjes së qeverisë. Nga fundi i viteve 1950. Malcom X filloi të shikonte disa boshllëqe në besimet dhe idetë e Lëvizjes së Kombit të Islamit. Ai e la grupin dhe filloi një turn në vendet myslimane dhe afrikane. Gjatë kësaj kohe, ai pranoi Islamin e vërtetë, dhe u kthye në Amerikë me një vendosmëri të madhe për përhapjen e Islamit midis komunitetit afro-amerikan. Ai gjithashtu ndryshoi emrin e tij në Hajj Malik Shabazz, edhe pse akoma njihej nga njerëzit me emrin Malcom X. Fjalimet e tij publike mbi Islamin dhe kundër Kombit të Islamit e bënë atë të fitonte shumë armiq në mesin e aleatëve të vjetër, veçanërisht kur shumë fansa të tij filluan të linin Kombin në favor të Islamit të zakonshëm. Rezultati i kësaj qe vrasja e tij në 1965, nga banditët e Kombit islam. Edhe pse koha e tij si mysliman ishte e shkurtër, ai pati një ndikim të jashtëzakonshëm dhe vazhdon të shërbejë si symbol i myslimanëve amerikanë dhe aktivist i të drejtave civile në Shtetet e Bashkuara.



"O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri..."

(A'raf, 26)

Vepri i parë që ndërmori shejtani kundër Ademit (a.s.) dhe bashkëshortes së tij Havasë e, për pasojë, kundër gjithë njerëzimit, ishte shfaqja e lakuriqësisë. Pra synimi kryesor i shejtanit në tokë është shfaqja e lakuriqësisë, nëpërmjet së cilës do të arrijë t'u hapë rrugë sjelljeve të ndryshme perverse dhe po në këtë mënyrë do të pengojë përsëri rikthimin në xhenet. Ndaj përpjekjeve të shejtanit për ta futur në kurth njeriun, Allahu e urdhëroi atë të vishej me rroba që mbulojnë lakuriqësinë dhe njëkohësisht e zbuqurojnë atë.

Veshja është konsideruar që në fillimet e historisë së njerëzimit si një domosdoshmëri qytetare. Siç shërben për të mbuluar pjesët e turpshme dhe për t'u dukur hijshëm, veshja kryen edhe funksionin e ruajtjes së trupit nga të ftohtit ose të nxehtit. Allahu na informon gjithashtu se petku i devotshmërisë është petku më i hijshëm. Allahu në këtë ajet e ka krahasuar devotshmerinë me një rrobë që mbulon dhe ruan zemrën e besimtarit nga ndotja.

Ekziston një lidhje ndërmjet petkut të trupit dhe petkut të devotshmërisë. Ndërsa njëri shërben për të mbuluar dhe ruajtur trupin, tjetri shërben për të ruajtur zemrën. Të dyja këto mbulesa

plotësojnë njëra-tjetrën, sepse petku i devotshmërisë përfshin bindjen ndaj Allahut, dashurinë për të dhe ndjenjën e turpfit. Shkurtimisht, është ruajtja e vetes nga çdo lloj ndotjeje shpirtërore apo materiale.

Zotërimi i këtyre cilësive shpie në mbulimin e pjesëve të obliguara për t'u mbuluar, kurse ata që njollosin mbulesën e devotshmërisë, sado që të mbulohen, nuk shpëtojnë dot nga kthetrat e shejtanit. Petku, me të cilin ishin mbuluar Ademi dhe Havaja në xhenet, ra vetëm kur këta përdhosën petkun e devotshmërisë. Ademi (a.s.) dhe bashkëshortja e tij, me ngrënien e pemës së ndalur përdhosën petkun e devotshmërisë dhe, për pasojë, iu shfaq lakuriqësia. Por gjithashtu edhe petku i trupit luan rolin e një mburoje për petkun e devocionit. Kjo është arsyeja që janë përmendur paralelisht në ajetin kuranor.

Nga ajeti del qartë që petku i devocionit është më i mirë se petku i veshjes, sepse devotshmeria na mbron nga dënimi i Allahut. Ky ajet është një nga argumentet e Allahut për të kuptuar që ne jemi qenie materiale dhe shpirtërore. Siç shfaqet lakuriqësia materiale, kur heqim rrobat, ndodh edhe zhveshja e vlerave nga mungesa e devotshmërisë.

Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.),
se Pejgamberi -sal-lall-llahu alejhi ve slem-, ka thënë:

*“Dy grupe nga banorët e xhehenemit akoma nuk i kam parë.
Disa njerëz që mbajnë në duar kamxhikë si bishtat e lopëve,
me të cilët godasin njerëzit dhe disa femra (që duken si) të
veshura dhe (në të vërtetë janë) të zhveshura...”*

Muhamedi (a.s.), përkufizon dy grupe njerëzish që kanë qenë të panjohur në kohën e tij, por që janë të pranishëm në kohën tonë. Dijetarët e kanë konsideruar shfaqjen e këtyre dy grupeve ndër shenjat e vogla të kiametit. Pika e përbashkët e këtyre dy grupeve është të mosqenët prej banorëve të xhenetit.

Në grupin e parë futen të gjithë personat që marrin pjesë në goditjen e njerëzve apo që përgatisin ekipe të veçanta për të rrahur njerëzit pa të drejtë, vetëm për të mbrojtur interesat e veta.

Përsa i përket grupit të dytë, “femra të veshura, por të zhveshura”, dijetarët kanë bërë interpretime të ndryshme, duke marrë parasysh kushtet e kohës në të cilën kanë jetuar. Një grup e ka interpretuar si, “megjithëse notojnë në begatitë e Allahut, nuk e falënderojnë atë” apo “të veshura me rroba, por të zhveshura nga petku i dovocionit”. Më vonë u interpre-

tua si “pjesërisht të veshura pjesërisht të zhveshura, që përpiqen të shfaqin bukuritë fizike”. Pastaj u interpretua si, “të veshura, por me rroba të holla që nuk mbulojnë linjat e trupit”. Duke parë realitetin e sotëm, nuk ndihet fare nevoja për interpretim, sepse çdo gjë është shumë e qartë. Dhe ky hadith është një mrekulli, sepse lajmëron në lidhje me diçka që i përkiste së ardhmes.

Megjithatë, imam Tibini (1277) ka bërë një interpretim që është i vlefshëm për të gjitha kohërat. Ai thotë: “Pejgamberi (a.s.), në hadith thekson se gratë janë të veshura, mandej të zbuluara. Pra, Pejgamberi (a.s.), nuk e mohon që janë të veshura, por refuzon mënyrën e veshjes. Sepse qëllimi kryesor i veshjes në Islam është mbulimi i pjesëve të turpshme dhe veshja që nuk e përmbush këtë mision nuk quhet mbulim. Për këtë arsye, të gjitha “gratë e veshura, por jo të mbuluara”, përfshihen në këtë hadith.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nuk do të hyjë në xhenet kush rreh njerëzit pa të drejtë dhe gratë që, megjithëse janë të veshura, në të vërtetë janë të zhveshura.
2. Shfaqja e këtyre dy dukurive është nga shenjat e vogla të kiametit.
3. Për të ndaluar degjenerimin e familjes fillimisht, pastaj të të gjithë shoqërisë, duhen formuar breza me identitet të gjallë fetar.



IMAM RABBANI - 1

I nderuari **Imam Rabbani** thotë:

“Po cila është pjesa jonë në përpjekjet për t’u bërë një rob i mirë i Allahut? Çdo gjë që kemi është mirësi e Allahut. Por, nëse patjetër na duhet të tregojmë një arsye për këtë, mund të them se shkak i të gjitha këtyre mirësive është lidhja pas **Rasulullahut (a.s.)** dhe ndjekja e gjurmëve të tij...”

Nëse njeriu nuk ka pasur sukses në arritjen e ndonjë pune ose të një pjese të saj, shkak për këtë mund të jetë mangësia në ndjekjen e plotë të sunetit të Rasulullahut (a.s.).

Njëherë u tregova i shkujdesur dhe hyra në abdes’hane me këmbën e djathtë. (Për shkak të kësaj sjelljeje, që nuk përshtatet me Sunetin e Rasulallahut (a.s.), atë ditë u privova nga shumë mirësi shpirtërore.” (Kishmi, *Berekat*, fq. 197.)

Frymëzimi shpirtëror që e afroon robin me Allahun, mund të arrihet vetëm me dorëzimin dhe bindjen e plotë ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Në Kurandin fisnik urdhërohet:

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju

falë gjynahet!..” (Al’Imran, 31)

Pra, dashuria e Allahut të Madhëruar mund të arrihet vetëm duke iu bindur e dorëzuar të dashurit të Tij e veçanërisht, duke ndjerë dashuri për të. Kush neglizhon sado pak në këtë rrugë, nguron apo dyshon, dera e dashurisë hyjnore mbetet e mbyllur për të. Kjo, sepse ekzistojnë ajete të qarta që tregojnë se dashuria për Pejgamberin (a.s.), është dashuri për Allahun; bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut; e mosbindja ndaj tij, është mosbindje ndaj Allahut.

Për këtë arsye, besimtari, çdo punë të tij, qoftë e madhe apo e vogël, është i detyruar ta bëjë me kujdesin dhe respektin më të plotë ndaj Sunetit pejgamberik, pra të stilit të jetës së Pejgamberit tonë, të Dashurit të Allahut (a.s.), që është edhe interpretimi praktik i Kuranit Fisnik.

Është fakt se, në përgjithësi, besimtarët që kapen siç duhet pas Sunetit të Pejgamberit (a.s.), i zbatojnë me përpikëri farzet dhe nuk lëshojnë apo lenë mangut diçka prej tyre. Ndërsa, ata që neglizhojnë sunetet, janë më të prirur të japin firo edhe në farze.

Nisur nga kjo, kujdesi në respektimin ndaj sunetit, është si një mburojë e fortë që merr nën





mbrojtje edhe farzet, të cilat janë pjesët themelore të jetës fetare. Për këtë arsye, kur iblisi dhe ndihmësit e tij i ngjiten fesë dhe besimit të një njeriu, në fillim përpiqen ta largojnë atë nga sunetet. Por, nëse nuk arrijnë të kenë sukses në këtë, ata e dinë shumë mirë se farzet nuk mund t'i prekin dot kurrë.

Për këtë arsye, **Abdullah bin Dejlemi**, rahmetullahi alejh, në lidhje me ndjekjen e sunetit me bindje dhe dorëzim të plotë, është shprehur:

“Fillimi i humbjes (dobësimit) së fesë, do të jetë me braktisjen e Sunetit. Siç zgjidhet litari fije fije dhe më në fund këputet, ashtu edhe feja humbet me braktisjen një nga një të suneteve.” (Darimi, Mukaddime, 16.)

Nisur nga kjo, dalja e suneteve një nga një prej jetës sonë, -Allahu na ruajttë- e vështirëson shpëtimin tonë të përgjithshëm në botën tjetër. Nëse shohim historinë e feve, vërejmë se edhe Hebraizmi dhe Krishterimi kështu kanë filluar të prishen. Në fillim, ata kanë braktisur sunetet e pejgamberëve, më vonë u është prishur edhe besimi edhe adhurimi. Si përfundim, u braktis namazi dhe në vend të tij u futën meshat e ceremonitë; u braktis agjërimi dhe në vend të tij zuri vend pehri; mbulesa e femrës u braktis, duke ngelur e veçantë vetëm për murgeshat, madje në ditët tona edhe murgeshat kanë filluar ta heqin mbulesën.

Në këtë pikë, si besimtarë që jemi, të gjithë ne duhet të tregojmë urtësi dhe ta dimë se në ditët tona, armiqtë e hapur dhe të fshehtë po përpiqen me të gjitha mundësitë që ta realizojnë edhe mbi Islamin këtë prishje të Krishterimit. Këta, me qëllim që të mos e bëjnë të qartë synimin e tyre të vërtetë, në fillim nuk sulmojnë

parimet themelore të fesë dhe ligjet që janë farz, por mundohen të zhvlerësojnë sunetet, të cilat luajnë rolin e mburojës që i ruan këto.

Por më e keqja është se në ditët tona, kur po përhapen shumë idetë dhe mendimet që janë larg Ehl-i Sunetit ue Xhematit dhe kur besimi i shumë myslimanëve po lëkundet e adhurimet dhe veprat e tyre po prishen, brenda këtyre lëvizjeve për prishje, shpesh vihen re edhe njerëz me cilësinë e dijetarit të fesë dhe mësuesve të teologjisë. Aq sa

këta persona po përshtellojnë mendjet dhe po turbullojnë zemrat edhe në çështje që kanë arritur konsensus nga dijetarët që prej 1400 vjetësh.

Për shkak të mendjeve të tyre të kufizuara, këta njerëz i mohojnë mrekullitë dhe përpiqen të bëjnë ndryshime sipas qejfit të tyre edhe në kodin ligjor të trashëgimisë, duke e ditur se në këtë çështje ka argumente të prera dhe nuk ka nevojë për interpretime. Ata e nënvleftësojnë mbulesën e gruas, refuzojnë hadithet që nuk u përshtaten mendimeve të veta dhe sunetet i shohin si të parëndësishme.

Me anë të sloganit: “Ne na mjafton Kurani!”, që duket sikur janë në rrugë të drejtë, ata e përgjashtojnë Sunetin e Pejgamberit, i cili është edhe shpjegimi, komentimi dhe zbatimi në jetë i Kuranit Fisnik dhe, mundohen të nxjerrin sipas qejfit

të tyre, gjoja një “Islam të Kuranit”.

Në lidhje me këta “prishës të fesë”, të veshur me rrobën e “dijetarit të fesë”, të cilët duke nxjerr Kuranin në plan të parë i fshehin qëllimet e tyre të vërteta, Rasullullahu (a.s.), shprehet:

“Kujdes! Mua më është dhënë Libri dhe një i ngjashëm me të. Kujdes! Është afër koha kur një person me

Abdullah bin Dejlemi,
rahmetullahi alejh, në
lidhje me ndjekjen e
sunetit me bindje dhe
dorëzim të plotë, është
shprehur:
“Fillimi i humbjes
(dobësimit) së fesë, do
të jetë me braktisjen e
Sunetit. Siç zgjidhet litari
fije fije dhe më në fund
këputet, ashtu edhe feja
humbet me braktisjen
një nga një të suneteve.”
(Darimi, Mukaddime, 16.)

barkun plot dhe i mbështetur në kolltukun e tij do t'ju thotë: «Duhet të ndiqni këtë Kuran. Hallallin që gjeni aty, është hallall dhe haramin që gjeni aty, është haram (s'keni nevojë për burim tjetër!). Kujdes! Ato që ndalon i Dërguari i Allahut, janë njësoj si ato që ndalon Allahu.» (Ebu Daud, Sunnet 6, hd. nr: 4604, 4/200; Ibn-i Maxhe, Mukaddime 2, hd. nr: 12, 1/6; Tirmidhi, Ilm 10, 2663, 2801; 5/37; Ahmed bin Hanbel, 6/8.)

Ndërsa në një transmetim tjetër, Rasulallahu (a.s.), shprehet se ndjekja e Sunetit është e detyrueshme dhe thotë:

“A mendon dikush prej jush i mbështetur në kolltukun e tij, se përveç këtyre që Allahu i ka ndaluar në këtë Kuran, nuk ka ndaluar gjë tjetër? Kujdes! Vallahi, unë këshillova, urdhërova dhe ndalova. Këto (urdhëra dhe ndalesa) janë po aq sa ka edhe në Kuran, mbase edhe më tepër.” (Ebu Daud, Haraxh, 31.)

Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar na tërheq vëmendjen në lidhje me faktin se Kurani mund të kuptohet drejt vetëm me anë të Sunetit:

“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed), që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.” (Shuara, 193-195)

Nisur nga kjo, të fshehtat dhe urtësitë e Kuranit mund të kuptohen vetëm nëse merret hise prej zemrës së Pejgamberit tonë (a.s.). Jeta pejjgamberike prej 23 vitesh e Muhamedit (a.s.), është nga fillimi deri në fund një interpretim i gjallë i Kuranit. Prandaj, të kuptosh Rasulullahun (a.s.), është shkalla më e rëndësishme në devotshmërinë ndaj Allahut. Pa e njohur dhe pa e kuptuar atë, pa ndjekur gjurmët e tij dhe pa marrë hise prej ndjenjave të tij shpirtërore, as besimi ynë nuk do të jetë i plotë, as Kurani Fisnik nuk do të mund ta kuptojmë ashtu siç duhet dhe as devotshmëria jonë nuk do të jetë devotshmëri me kuptimin e plotë të fjalës...

Zbatimi i një pjese të urdhrave hyjnorë në Kurani Fisnik, nuk na është bërë i ditur me detaje. Ato i mësojmë vetëm në sajë të zbatimeve të Pejgamberit tonë (a.s.).

Për shembull; në Kurani Fisnik është bërë e ditur se ngrënia e cofëtinës është haram. Mirëpo, peshku i

cili kapet i gjallë dhe më pas ngordh vetvetiu, është një përjashtim brenda këtij rregulli. Dhe këtë ne e mësojmë nga Suneti i Pejgamberit (a.s.).

Po ashtu, në Kuran urdhërohet edhe namazi; por detajet se si duhet ta falim atë, numrin e rekatëve, suret dhe duatë që duhet të lexohen në të dhe çështje të tjera, si rregullat e qëndrimit në namaz ne i mësojmë nga Suneti.

Kurani Fisnik, të fshehtat dhe urtësitë e veta, ua hap “besimtarëve të devotshëm”. Në lidhje me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (Bekare, 2)

Për këtë arsye, ata që e kuptojnë në më mirë Kurani, janë besimtarët që bëjnë një jetë të devotshme dhe arrijnë nivele të larta shpirtërore. Edhe pse të gjithë lexojnë në njëtin Kuran, gjithësecili përfiton prej Kuranit sipas nivelit shpirtëror që zotëron.

Kjo ndodhi e **Omerit** (r.a.), e shpjegon shumë bukur këtë të vërtetë:

Një ditë, kur Omeri (r.a.), po kalonte para një shtëpie, dëgjoji se i zoti i shtëpisë po lexonte me zë të lartë suren Tur. Kur ai arriti tek ajetet: **“Me të vërtetë, dëni mi i Zotit tënd do të ndodhë dhe askush nuk mund ta pengojë.”** (Tur, 7-8), Omeri (r.a.), zbriti nga kafsha e vet dhe e dëgjoji për një farë kohe i mbështetur në mur. Më vonë, për shkak se u ndikua shumë nga paralajmërimi i ashpër i këtij ajeti, qëndroi i sëmure për disa ditë. (Ibn-i Rexheb Hanbeli, *Tahui mine'n-Nar*, Damask 1979, fq. 30.)

Ja pra, Kurani Fisnik është si një oqean pa anë e pa fund, në thellësitë e të cilit mund të zhytesh sipas nivelit shpirtëror. Ashtu si dikush që nuk di të notojë dhe qëndron në ujë të cekët, ndërkohë që një zhytës i aftë mund të futet në vendet më të thella të detit dhe sheh pamje e botë të tjera, të çuditshme, të mahnitshme dhe të ndryshme, të cilat nuk mund t'i shohin ata që qëndrojnë në breg, ashtu edhe ata që ngrihen në shkallë të larta shpirtërore në rrugën e devotshmërisë, përballen me shfaqjet e shumë urtësive të Kuranit dhe marrin prej tij frymëzimin e vërtetë shpirtëror.

Mirëpo, të mjerët që bëjnë sikur nuk i shohin këto



dhe shumë të vërteta të tjera -gjoja me synimin për të zbatuar Kurandin-, e përgjysmojnë fenë, duke u përpjekur t'ia përshtatin atë mendimeve të tyre të cekëta. Përveç kësaj, ata guxojnë të kritikojnë paturpësisht edhe dijetarët dhe muxhtehidët e mëdhenj, pranë dijes dhe urtësisë së të cilëve nuk janë as çirakët e tyre:

Duke u mbështetur në mendimin se "Ata kanë qenë dijetarët e para njëmijë viteve dhe tashmë kohët kanë ndryshuar shumë...", luajnë me ligjet e fesë që janë të pandryshueshme dhe të pandikueshme nga koha. Dhe kjo e dëmton fenë më tepër se ato që kanë bërë orientalistët jomyslimanë dhe misionarët. Këta janë një tufë njerëzish të pavetëdijshëm, të cilët pandehin se të jesh dijetar i fesë, do të thotë ta kritikosh atë në vend që t'i shërbesh.

Nga ky këndvështrim, në mënyrë të veçantë, vëllezërit tanë të rinj që kryejnë studimet në fushën e fesë, duhet të tregohen vigjilentë në lidhje me këto çështje dhe të kenë kujdes se prej kujt e mësojnë fenë. Kjo, sepse Pejgamberi ynë (a.s.), një nga sahabët e tij më të dashur, **Abdullah bin Omerin** (r.a.m), e ka porositur duke i thënë:

"O Ibn-i Omer! Kapu fort pas fesë tënde, kapu fort pas fesë tënde! Sepse ajo është mishi dhe gjaku yt. Bëj kujdes prej kujt e mëson fenë tënde! Dijet dhe ligjet e fesë merri prej dijetarëve që ndodhen në rrugë të drejtë, jo pre atyre që lëkundën sa majtas djathtas!" (Hatib Bagdadi, *Kifaje fî'ilmî'r-rivaje*, Medinetu'l-Munevvere, Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121.)

Sahabët fisnikë dhe besimtarët e devotshëm, që ndoqën gjurmët e tyre dhe u treguan të kujdesshëm në këtë çështje, ndonjëherë, për të marrë një hadith nga një transmetues, udhëtonin drejt dijes për muaj të tërë në kushtet e asaj kohe. Gjithashtu, në sajë të edukimit pejgamberik, ata arritën të bëheshin monumente virtytesh të atillë, sa që nuk e konsideronin të vlefshëm moralin e një njeriu, i cili për të ndjellë kafshën e vet, e mashtronte atë duke i treguar trastën bosh të ushqimit. Pra, personin, në karakterin dhe moralin e të cilit gjendej dobësia e mashtrimit qoftë edhe ndaj një kafshe, nuk e konsideronin të merituar për të transmetuar hadithet, për shkak se ai nuk jetonte në përputhje me hadithet e Pejgamberit (a.s.).

Një nga imamët e famshëm të brezit të tabiinëve, **Ebu'l-Alije**, rahmetullahi alejh, thotë:

"Kur ne shkonim tek dikush për të marrë (hadith) prej tij, më parë shikonim namazin e tij; nëse namazin e falte në rregull, thoshim se «ai edhe punët e tjera i bën në rregull» dhe uleshim pranë tij. Por, nëse namazin e falte pa përkushtim dhe pa respektuar qëndrimin e rregullt në të, thoshim se «ai edhe punët e tjera i bën kështu» dhe largoheshim prej tij." (Darimi, *Mukaddimet*, 38/429.)

Ja pra, edhe sot është kusht që dijetarët të cilëve u duhet besuar, të vlerësohen nën dritën e këtyre kriteleve. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik urdhëron:

"...Allahut i frikësohen vetëm dijetarët..." (Fatir, 28) Nga kjo, kuptojmë se kushti i parë i një dijetari të

vërtetë duhet të jetë "takua"-ja, pra "frika ndaj Allahut", sepse Ai, vetëm këtë rob e konsideron si "dijetar të vërtetë". Jo ata që pa u frikësuar ndaj Allahut dhe pa iu skuqur fytyra ndaj Rasulallahut (a.s.), pandehin se kriteri i vetëm i së vërtetës janë mendjet e tyre të kufizuara dhe duke e kaluar fenë prej kësaj site, marrin atë që u përshtatet mendimeve të tyre dhe hedhin ato që nuk u përshtaten!..

Në thelb, besimi është një parapranim, që kërkon aprovimin me zemër të shumë çështjeve, të cilat mendja është e pafuqishme t'i kuptojë plotësisht. Ashtu si syri që ka një largësi të caktuar të shikimit, ashtu edhe mendja ka një aftësi të kufizuar kuptimi; prandaj, ajo nuk mund të kuptojë çdo gjë. Mirëpo, a nuk ekziston asnjë

e vërtetë tjetër përtej aftësisë së kuptimit të mendjes? Përderisa është Allahu i Madhëruar me dijen e Tij absolute, Ai që ia shpjegon të vërtetat e fesë birit të njeriut, i cili ka mendje dhe dije të kufizuar, atëherë, natyrisht që ekzistojnë të fshehta dhe urtësi të panumërta të cilat mendja është e paaftë t'i kuptojë.

Ky hadith fisnik, na e shpjegon më qartë këtë të vërtetë:

"Gjatë udhëtimit kur Hizri (a.s.), i tregoi Musait (a.s.), ngjarje të çuditshme me kuptime të fshehta, një trumcak u ul në anë të anijes ku kishin hipur ata dhe me sqepin e tij mori ujë nga deti. Duke ia tërhequr vëmendjen mbi këtë veprim, Hizri (a.s.), i tha kështu Musait (a.s.):

Kurani Fisnik

është si një oqean pa anë e pafund, në thellësitë e të cilit mund të zhytesh sipas nivelit shpirtëror. Ashtu si dikush që nuk di të notojë dhe qëndron në ujë të cekët, ndërkohë që një zhytës i aftë mund të futet në vendet më të thella të detit dhe sheh pamje e botë të tjera, të çuditshme, të mahnitshme dhe të ndryshme, të cilat nuk mund t'i shohin ata që qëndrojnë në breg, ashtu edhe ata që ngrihen në shkallë të larta shpirtërore në rrugën e devotshmërisë, përballen me shfaqjet e shumë urtësive të Kuranit dhe marrin prej tij frymëzimin e vërtetë shpirtëror.

«Pranë dijes së Allahut, dija jote, e imja dhe e të gjitha krijesave, është aq sa uji që mori ky trumcak nga deti!»
(Buhari, Tefsir, 18/4.)

Ashtu siç është dija dhe mendja e një milingone gati zero në krahasim me dijen dhe mendjen e njeriut, ashtu edhe gjendja jonë përballë Allahut të Madhëruar është veçse një "hiç". Ato që njeriu di, janë asgjë në krahasim me ato që nuk di. Kjo është edhe arsyeja që një ajet fisnik shprehet se një nga cilësitë e njeriut është "xhehul", pra "shumë i paditur". Përkundër kësaj, Allahu i Madhëruar e shpreh me këto fjalë madhështinë dhe pafundësinë e dijes së Tij hyjnore:

"Sikur të gjithë drurët që gjenden në Tokë të ishin pena, e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shterreshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti."
(Lukman, 27)

Për shkak se dija e të gjitha krijesave është sa një pikë prej oqeanit, pranë dijes së Allahut të Madhëruar, i Cili i krijoi ato, ekzistojnë shumë të fshehta dhe urtësi që njeriu nuk mund t'i kuptojë me mendjen e tij të kufizuar. Një pjesë prej këtyre u janë zbuluar njerëzve të zgjedhur, disa të fshehta më të thella u janë zbuluar pejgamberëve dhe disa të tjera edhe më të thella, i janë zbuluar vetëm Pejgamberit tonë (a.s.). Për këtë arsye, Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

"Nëse do të dinit ato që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë." (Buhari, Tefsir, 5/12.)

Nisur nga kjo, mendja e kufizuar që na është dhuruar, ka një vlerë vetëm brenda kuadrin të Kuranit dhe Sunetit. I nderuari **Mevlana**, në lidhje me rëndësinë që ka lënia mënjanë e të gjitha dyshimeve e pyetjeve, duke u dorëzuar me gjithë zemër ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, shprehet:

"Megjithëse mendja është e suksesshme në çështjet e kësaj bote, për shkak të përbërjes së saj, ajo është e pamjaftueshme për arritjen e së vërtetës, të fshehtës hyjnore, pra për njohjen e përkryer të Allahut. Për këtë udhëtim të nivelit të lartë, ka nevojë për një mjet. Ky mjet është shpirti, dashuria dhe pasioni. Ndërsa mendja iu bëftë kurban Mustafait!"

Vetëm në sajë të këtij dorëzimi, mendja mund t'i shërbejë lumturisë së njeriut në këtë botë dhe në tjetrën. Përndryshe, ajo vetëm sa e sjell njeriun vërdallë nëpër qorrrokakë.

Ja pra, Allahu i Madhëruar kërkon që ne, në lidhje me pranimin e të vërtetave -si mrekullitë, kaderin dhe besimin në të fshehtën-, të cilat mendja është e paaftë t'i kuptojë plotësisht, të vëmë në punë zemrën, e cila është edhe qendra e një kuptimit më të lartë se mendja. Me këtë, Ai dëshiron që ne të ngrihemi në horizontin e një dorëzimi të plotë.

Besimi i vërtetë, më tepër se shqiptimi me gjuhë, vjen si pasojë e aprovimit me zemër; jo aprovimit me mendje. Të pranosh vetëm ato që t'i merr mendja, nuk do të thotë "të besosh", por të "bindesh". Dhe për arsye se kjo nuk përmban asnjë aspekt të dorëzimit ndaj Allahut, nuk ka as vlerë tek Ai.

Shkurtimisht, është kusht që feja jonë madhështore, Islami, të mësohet prej dijetarëve të devotshëm, me moral të bukur dhe që bëjnë një jetë të mbushur me vepër të mira nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit. Të jesh në rrugën e drejtë, duke u kapur fort pas Kuranit dhe Sunetit, konsiderohet si mrekullia e ditëve tona.

Kjo gjendje e njërit prej të dashurve të Allahut, **Bejazid Bistami**, është një shembull shumë domethënës në lidhje me evidencimin e atyre që duhen vlerësuar në aspektin e dijes fetare:

Një ditë, Bejazid Bistami doli për udhë së bashku me nxënësit e tij për të vizituar një person, i cili ishte bërë i njohur në popull si "evlija". Kur ai person doli nga shtëpia

për të shkuar në xhami, pështyu në drejtim të kiblës. Bejazidi, Allahu e mëshiroftë, u prek shumë prej sjelljes së tij të paedukatë dhe u kthye nga kishte ardhur, pa i dhënë fare selam. Ndërsa nxënëseve të vet u tha:

"Ky njeri nuk është i besueshëm në asnjërën prej sjelljeve të bukura që na ka mësuar Rasulallahu (a.s.)! Si t'i besohet atij në lidhje me të fshehtën hyjnore!" (Kushejri, *Risale*, fq. 57, 416-417.)

I nderuari Imam Rabbani thotë:

"Kryerja e punëve të pëlqyeshme (mustehab) nuk duhet neglizhuar, sepse punët e pëlqyeshme janë gjëra që Allahu i Madhëruar i do dhe i pëlqen. Nëse njeriu di



1. -Shih. Ahzab, 72.

një punë të mirë në ndonjë cep të tokës, të cilën Allahu e do dhe kënaqet me të dhe ka mundësinë ta bëjë, atëherë ai duhet ta konsiderojë atë si një mirësi të madhe. Kjo i ngjan atij që blen diamante të çmueshëm me disa copa vazoje të thyer.” (Imam-ı Rabbani, *Mektubat*, II, 172, no: 266.)

Një ditë, Imam Rabbani i thotë njërit prej nxënësve të tij:

“Më sill ca karafila nga kopshti!” Ai shkoi dhe solli gjashtë karafila. Kur e pa, Imam Rabbani në një mënyrë paksa të mërzhitur, tha:

“Nxënësit tanë ende nuk tregojnë kujdes ndaj fjalës së Profetit (a.s.), që thotë: *“Allahu është tek dhe e do tekun.”*² Të tregoheshi i kujdesshëm ndaj këtij hadithi, është gjë e pëlqyeshme (mustehab).

Çfarë pandehin njerëzit se është mustehabi? Një vepër e tillë mustehab me të cilën kënaqet Allahu, nuk ndërrohet, edhe nëse të jepet e gjithë kjo botë dhe bota tjetër. Ne e vlerësojmë aq shumë mustehabin, sa që edhe kur lajmë fytyrën, lagim më parë anën e djathtë. Kjo, sepse të fillosh nga e djathta është mustehab.” (Kishmi, *Berekat*, fq. 198; Ebu'l-Hasan Nedvi, Imam Rabbani, fq. 180-181.)

Siç shihet, gjëja më e jash-tëzakonshme që kanë bërë të dashurit e Allahut, dijetarët dhe njerëzit e devotshëm që e kanë njohur mirë Pejgamberin tonë (a.s.), është përpjekja e tyre për ta jetuar Sunetin me një përpikëri të veçantë, pa bërë dallim në punë të vogla apo të mëdha.

Një gjë nuk duhet ta harrojmë, se me qëllim që ne të përpiqemi në të gjitha veprat e mira dhe të ruhemi nga të këqijat, Allahu i Madhëruar e ka lënë të fshehtë faktin se në cilën vepër shfaqet kënaqësia apo zemërimi i Tij. Si kënaqësia, ashtu edhe zemërimi i Allahut, ndonjëherë, mund të shfaqet në një punë të madhe, ndonjëherë në ndonjë punë të mesme dhe ndonjëherë në ndonjë punë shumë të vogël.

Siç na lajmëron edhe një hadith fisnik, një grua gjy-nahqare, e cila i dha ujë një qeni të etur, u bë prej bano-rëve të xhenetit, në sajë të mëshirës që tregoi për të. Përkundër kësaj, një grua tjetër e devotshme në fe, e

2. -Shih. Buhari, *Deauat*, 68.

cila e braktisi macen e saj të ngordhte prej urisë, u bë prej banorëve të xhehenimit, për shkak se u tregua e pamëshirshme.³

Një sahab fisnik, **Enes bin Malik** (r.a.), ka thënë:

“Ju bëni disa punë, të cilave nuk u kushtoni rëndësi as sa një qime. Por në kohën e Rasulullahut (a.s.), ato punë ne i konsideronim si gabime të mëdha e shkatërruese.” (Buhari, *Rikak*, 32.)

Ata, në sajë të dashurisë dhe frikës që kishin në zemrat e tyre ndaj Allahut edhe gjynahet e vogla i konsideronin humbje të mëdha, madje i konsideronin si shkak shkatërrimi. Nuk shikonin vogëlsinë e gabimit, por madhëstinë e Allahut ndaj të cilit bëhej gabimi.

Domethënë, për t'u bërë një besimtar i devotshëm, nuk mjafton të kryesh vetëm farzet dhe të ruhesh nga haramet, por kërkohet edhe një zemër e mbushur me entuziazmin e besimit. Rahmet pastë, babai im i nderuar **Musa Efendi**, në lidhje me këtë çështje është shprehur:

“Shumë njerëz janë të qetë duke pandehur se me faljen e namazeve dhe mbajtjen e agjërimeve i kanë kryer të gjitha detyrat fetare. Mirëpo, kjo nuk mjafton. Bashkë me respektimin dhe madhërimin e urdhrave të Allahut, duhet të tregohet mëshirë edhe ndaj krijesave. Kjo mund të arrihet vetëm me sakrificë dhe shërbim të sinqertë. Çështja që duhet të ketë më tepër kujdes çdo musliman me mendje të shëndoshë, pasi të ketë plotësuar farzet dhe të jetë ruajtur nga gjynahet, është shërbimi ndaj Islamit, shoqërisë dhe të gjitha krijesave, duke u bërë i dobishëm për to... sepse këto që u përmendën janë plotësuesit e farzeve dhe pjesë të Sunetit të Pejgamberit tonë (a.s.)...”⁴

I japim fund fjalëve tona me këtë lutje të bukur të Imam Rabbanit:

“Allahu i Madhëruar, për hir të dashurisë ndaj Pejgamberit (a.s.), i cili u dërgua për të gjitha racat, të bardhë e të zinj, na shpëtoftë prej fjalëve që nuk përjetohen dhe dijes me të cilën nuk punohet.”⁵

Amin!..

3. -Shih. Muslim, *Selam*, 151-153.

4. -Shih. Sadik Dana, *Altinoluk Sohbetleri*, III, 117, 167; V, 78-79.

5. -Imam-ı Rabbani, *Mektubat*, I, 159, no: 23.



Rregullat e kortezisë Islame

Prof. dr. Ibrahim Emiroglu

Njeriu është një qenie me intelekt. Kjo veçori kryesore i jep mundësinë atij të shikojë bukur, të mendojë bukur, të vlerësojë bukur dhe të sillet bukur. Në sajë të sjelljeve ose përgëzohet, ose nënvleftësohet. Mirëpo, ajo çfarë përbën rëndësi është që njeriu të mendojë mirë, të zgjedhë të mirën, të veprojë të mirën; të mos mendojë të keqen, të mos sillet në mënyrë të keqe dhe të vrazhdë. Për të zgjedhur dhe zbatuar të mirën ai duhet të sillet në mënyrë të mesme, larg ekstremeve.

Të jetosh i lumtur dhe i suksesshëm është një art më vete. Çdo art ka një stil të lidhur me disa rregulla të caktuara. Ata që i kushtojnë rëndësi jetës dhe ata që janë të vetëdijshëm se jeta është një “sprovë”, nuk

neglizhojnë asnjë akt e asnjë sjellje. Njeriu është një qenie sociale. Feja jonë është një fe “e civilizuar”. Vetëdija e bashkëjetesës i jep kuptim jetës, si dhe e lehtëson atë. Bashkëjetesa ka disa rregulla. Këto rregulla, ndonëse disa njerëzve u duken si pa rëndësi, në fakt për arsye se janë të lidhura në mënyrë direkte me “qytetërimin e njeriut” janë mjaft të rëndësishme. Feja jonë e bukur ka ofruar disa masa lidhur me etikën dhe hijeshinë në mendim, në të folur, në veshje, në punë dhe në sjellje. Të jetuarit me edukatë është një nga parimet e fesë, ndaj dhe është obligim për çdo besimtar.

Kodi etik, është një bashkësi rregullash mbi bashkëjetesën shoqërore; është emri i përbashkët i ak-

teve që qytetërojnë dhe stolisin njeriun, që shprehin fjalët, sjelljet dhe veprimet e individit. Në një fjalë të urtë thuhet: **“Gjithçka thyhet tek pjesa më delikate, kurse njeriu thyhet nga vrazhdësia.”**

Duhet shkëmbyer selami mes njëri – tjetrit, duhet shprehur interesimi për shëndetin dhe mbarëvajtjen e punëve të njëri – tjetrit; duhet sjellë me dhembshuri, në veçanti ndaj fëmijëve; duhet shprehur respekti ndaj të moshuarve dhe duhet komunikuar me edukatë dhe delikatesë ndaj femrave, të cilat janë simboli i hijeshisë dhe finesës. Duhet kushtuar vëmendje dhe duhet marrë pjesë në fejesa, dasma, ceremoni fetare apo mortore; duhen vizituar të sëmurët, si dhe duhet bërë kujdes me mirësjelljen në udhëtime dhe kundrejt mysafirëve.

Farat e para të mirësjelljes, edukatës dhe finesës duhen hedhur fillimisht në familje dhe duhet bërë kujdes të mbijnë si duhet. Fëmija juaj duhet të fitojë prej jush praktikën e të qenit higjienik, i rregullt dhe parimor. Fëmijëve u duhet mësuar sjellja që duhet të shfaqin ndaj vëllezërve dhe motrave të veta. Duhet t’ua mësojmë mënyrën se si duhen sjellur kur janë mysafir. Duhet kushtuar vëmendje që fëmija të bëjë pjesë të jetës së tij leximin e librave, madje edhe se si duhet ruajtur libri, se si duhet mësuar, se si duhet të rregullojë tryezën e studimit, dhe si duhet të vendosë çantën me libra. Fëmijës duhet t’i mësojmë raportin mes shpërdorimit dhe haramit, duke i dhënë shembujt dhe përmes fjalëve të bukura; që të ngrënit me ekuilibër dhe me rregull është *mubah*; kurse tepërimi në ngrënie, shprehja e tamahut dhe ngulitja e syve tek ajo çfarë ka tjetri nuk është e përshtatshme fetarisht; të folurit rreth ndonjë myslimani që nuk gjendet prezent, duke i veshur ndonjë të metë që ai nuk e ka, pra përgojimi duhet mësuar se është i ndaluar. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: *“Feja është këshillë.”* Kështuqë, secila nënë dhe secili baba duhet të luftojë që “të përhapet e mira dhe të pengohet e liga” mbi ata vetë, si dhe mbi fëmijët e tyre. Shkurtime, fëmijët duhen mbështetur në sjelljet e mira që shfaqin dhe duhen penguar të shfaqin sjellje të këqija dhe të vrazhda. Duhet treguar metodat e përvetësimit të hadithit *“Mysliman është ai, nga shprehjet dhe sjelljet e të cilit nuk shqetësohet tjetri.”*



Myslimani duhet të respektojë kodin etik në veshje, në ngrënie, kur është mysafir, kur bisedon, kur përshëndet, kur prezantohet, kur komunikon në telefon, gjatë udhëtimit, në rrugë, kur largohet, shkurtimisht në çdo fushë të jetës.

Kujdesi që i kushton njeriu veshjes dhe paraqitjes në përgjithësi ka aq shumë rëndësi, sa që është përcaktues i personalitetit të tjetrit. Ndaj dhe thuhet: *“Njeriu pritet sipas paraqitjes së tij dhe përcillet sipas meritave dhe sjelljeve të tij.”* Njeriu duhet të vishet me gjërat e lejuara, të pastra, sipas përcaktimeve që ka feja dhe shoqëria. Nuk duhen veshur veshje të shkurtra dhe transparente. Nuk duhet veshur me ngjyra të ndezura. Por duhet veshur në mënyrë të harmonizuar.

Të dish të ushqehesh sipas kodit etik, është një punë më vete. Që nga shijet mbi ushqimet, përgatitja e sofrës, mënyra se si ulesh, përdorimi i lugës dhe pirunit, mënyra se si çohen deri tek goja, mënyra sesi përçapet kafshata dhe çdo detaj tjetër lidhet me një rregull dhe me një mënyrë mirësjelljeje. Kushti parësor i ushqimit është të qenit hallall. Pastaj i duhet kushtuar vëmendje higjienës së ushqimit. Duart duhen larë para dhe pas ushqimit. Para se të kemi filluar të hamë, të themi *“Bismil-lah”*. Kur jemi duke ngrënë nuk përçapet kafshata me zhurmë e as nuk flitet me kafshatë në gojë. Është turp të përkulesh mbi pjatën e supës apo të gjellës. Kokrra e ullirit nuk merret me dorë për t’u futur në gojë, por me pirun. Nuk duhet të përfundohet ushqimi e as që duhet çuar nga sofa para mysafirit. Pas ushqimit duhet bërë dua; pra duhet ngritur pasi të kesh falënderuar Allahun. Pas ushqimit duhet pastruar goja dhe dhëmbët.

Mysafir shkohet me një dhuratë sado të vogël në dorë, brenda mundësive. Kur je mysafir, fëmijët flasin më pak sesa prindërit e tyre. Ashtu sikurse janë pavend diskutimet mes njëri-tjetrit të partnerëve gjatë ushqimit, po ashtu është e detyrueshme të përshtatesh me rregullin familjar të shtëpisë ku shkohet. Gruaja nuk duhet ta nënçmojë të shoqin në sytë e të tjerëve, po ashtu as i shoqi nuk duhet ta turpërojë gruan. Nuk janë sjellje të denja e qeshura përgjithçka që thuhet a bëhet. Veçanërisht femrat të mos

qeshin me të madhe me gojë të mbushur plot. Kur je i ftuar si mysafir apo në një rast të caktuar, nuk duhet treguar lakmitar për ushqim, duhet ushqyer në mënyrë të qetë. Të hash shpejt e shpejt dhe të mbarosh, bie ndesh me kodin etik. Ndërkohë që je mysafir, të mos pëlqesh ushqim e të mos hash pa pasur ndonjë arsye serioze, është mungesë e theksuar e edukatës. Hahet ajo çfarë të shërbehet, nuk zgjidhet ushqimi, nuk duhet vënë në vështirësi i zoti i shtëpisë. Kur je mysafir, falënderohen bujtësit për shërbimet dhe duhet bërë e dukshme se ishin të shijshme. Është qytetari të marrësh në telefon të zotit e shtëpisë që të bujti një natë më parë dhe ta falënderosh sërish për darkën e mbrëmshme.

Kur bëhen dialogje, duhet nderuar dhe respektuar njëri-tjetri. Janë pjesë e kodit etik që i përket komunikimit, të folurit në gjuhën që kupton tjetri, të folurit me një ton zëri të mesëm, të mos fyesh, mosnxjerrja e gjuhës jashtë, mosshtrëmbërimi i buzëve dhe mossharja; kurse si përmbajtje duhet të jesh përmbledhës, i kuptueshëm dhe të thuash gjëra të dobishme. Ndjaj dhe Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), ka thënë: *“O flisni gjëra të mbara, ose heshtni!”*

Përshëndetja e njëri – tjetrit është treguesi më identifikues i qytetarisë. Shprehja e njërit nga emrat e Allahut “Selam”, që bëjnë dy njerëz kur takohen në rrugë, ka kuptimin që nga ai vetëm paqe do të ketë, si dhe shpreh lutjen që Allahu t’i dhurojë mirësi, paqe, shëndet dhe lumturi. Edhe personi përballë e shpreh përmes marrjes së selamit, që edhe ai i uron të njëjtat gjëra. Një njeri që shkon tek një i moshuar, fillimisht i jep selam; por të moshuarit nuk i drejtohesh “si jeni?”. Pasi, e drejta për të pyetur i pari “si jeni” i përket të moshuarit. I vogli nuk ulet pa i treguar të tjerët se ku do ulet.

Kur takohen për herë të parë dy njerëz, nëse nuk ka një të tretë që do t’i prezantojë, atëherë prezantimin e vetes e bën duke thënë emrin dhe mbiemrin bashkë. Nëse është e nevojshme, sipas situatës, tregohet edhe profesioni apo punët e veçanta që bën. I pari që nis prezantimin është i vogli, pastaj i madhi; ai që është me profesion një shkallë më të lartë bën prezantimin para tjetrit; mashkulli para femrës, i

sapoardhuri prezantohet para atij që gjendej aty. Gjatë prezantimit mashkulli nuk e zgjat dorën pa e zgjatur femra.

Ai që bën telefonatën fillimisht i duhet të prezantohet atij që telefonon, pastaj i thotë emrin e personit me të cilin dëshiron të flasë. Nëse ka marrë në telefon numër të gabuar, duhet t’i kërkojë ndjesë me mirësjellje. Telefoni, i cili është një mjet komunikimi, duhet përdorur mirë. Në kabinat telefonike duhet pritur radha, nuk duhet harxhuar më shumë kohë se duhet, nëse ka njerëz të tjerë që presin për të folur. Kur shkohet diku mysafir, celulari ose fiket ose mbahet pa zë. Është shprehje e mungesës së qytetërimit mbajtja hapur e celularit. Mbajtja hapur (me zile) e celularëve kur je në xhami, konferencë, kinema, teatër, autobuz etj., është mungesë e qartë edukate.

Kur jemi duke u ngjitur në shkallare, përpara duhet të ecë mashkulli dhe mbrapa femra. Edhe në zbritje e njëjta gjë duhet të ndodhë. Arsyeja pse gratë lihen për të ecur prapa është, sepse hyhet në vende të panjohura. Ngaqë nuk dihet se me kë dhe me çfarë do të përballemi, ecën burri përpara. Kurse arsyeja përse ecën burri përpara edhe në zbritje është sepse në rast rrëshqitjeje të këmbës së gruas, ta mbajë dhe ta ndihmojë burri.

Në mjetet e transportit publik duhet liruuar vendi për të moshuarit, për gratë shtatzëna dhe për gratë që janë me fëmijë përdore; të bësh sikur nuk i shikon ato me idenë se “edhe unë jap para”, nuk është aspak një mendim i saktë. Në mjetet e transportit duhen bërë kujdes duart, krahët, gjunjët. Krehja e flokëve, rinovimi i makiazhit në mjetet e transportit publik është mungesë edukate. Kur përdorni automobilin, dhënia gaz përnjëherësh, lëvizja e papritur, frenimi i menjëherëshëm i automobilit, të lëshosh muzikë me zë të lartë, të zësh ngushtë shoferin përballë, mosrespektimi i sinjalistikës rrugore, rënia e borisë vend pa vend; të dhunosh shoferët e tjerë, fyerja me fjalë apo me gjeste, është mungesë e theksuar edukate dhe vulgaritet. Gjithnjë duhet mbajtur në mendje kjo thënie e Pejgamberit (a.s.): *“Mysliman është ai, nga shprehjet dhe sjelljet e të cilit, nuk shqetësohet tjetri.”* Të



jesh i qetë kur nisën makinën, të kesh durim dhe të jesh tolerant është me mjaft rëndësi si për ne, ashtu edhe për të tjerët jashtë nesh.

Të hedhësh mbeturina në rrugë dhe të pështysh është një tjetër shprehje e mungesës së edukatës. Kur të shohësh një mik të shoqëruar me të tjerë në rrugë, të mos mjaftoheni me selamin, por të nisni ndonjë bisedë me të është mungesë edukate ndaj personit apo personave që janë të shoqëruar me të. Kur ecin në rrugë një çift, qendrimi i gruas në krahun e djathtë të burrit është pjesë e kodit etik. Kur kalon tek një derë, nuk duhet mbyllur menjëherë dera, por duhet parë se mos ka njeri pas jush dhe ju duhet të mbani derën derisa të kalojë. Falënderimi që i shprehet atij që po mban derën për ju, është pjesë e kodit etik.

Kur dikush po ndahet nga diku, thotë: "Mirupafshim!" dhe jo në gjuhë të huaja "Bye Bye" apo "Ciao". Kjo gjë është shprehje e mungesës së edukatës.

Lidhur me kodin etik, është e dobishme t'ua kujtojmë edhe këto:

- Në komunikim dhe në sjellje duhet të jeni të natyrshëm, duhet të jeni larg çdo lloj artificialiteti.

- Për bashkëshortet duhet përdorur shprehje komplimentuese, si: e dashur, mbretëresha ime, drita e syve të mi, shpirti im etj.

- Në hyrje të pallateve nuk duhet folur me zë të lartë dhe nuk duhet bërë zhurmë.

- Jashtë ditëve të caktuara nuk duhet shkundur sofrabezi, batanija apo tapeti në ballkon. Ky veprim kalon kufijtë e edukatës, por është edhe fyerje për ata që janë në katet e mëposhtme.

- Nuk duhet kaluar pa u dhënë selam fqinjëve e as nuk duhet harruar të pyeten se si janë me shëndet.

- Nuk duhen nënvleftësuar njerëzit dhe veçanërisht fqinjët, si dhe duhen respektuar ftesat që vijnë prej tyre.

- Nuk dilet kudo në mënyrë të papërshtatshme, fjala vjen: përballë mysafirëve me mëngë të përveshura, me pantallona të shkurtra, me kostum sportiv, duke përtypur çimçakëz.

- Dhurata që sillen në shtëpi nga mysafirët duhet pranuar dhe duhet shprehur pëlqimi i saj. Nëse është një buqetë me lule, duhet hapur dhe vendosur në ujë.

- Nëse personi përballë është më i madh në moshë apo më i ngritur me dije, nuk lejohet vendosja e këmbës përmbi këmbë në prani të tij apo në një mënyrë tjetër të pahijshme.

- Edhe sikur të mos jesh dakord me mendimin e personit që po bisedon, ai duhet respektuar, nuk duhet ndërprerë fjala e tij, duhet dëgjuar në heshjte.

- Të gogësisht në prani të të tjerëve dhe të mos mbyllësh gojën me dorë, është mungesë edukate.

- Të nënvleftësosh një person në mesin e të tjerëve, është një sjellje shumë vulgare dhe e vrazhdë. Shumica e atyre që sillen kështu janë njerëz me komplekse.

- Të vendosësh këmbët në stolat ku ulen njerëzit në parqe apo anash rrugëve, është një gjest që nuk puqet me kodin etik.

- Njerëzit me aftësi të kufizuar duhen ndihmuar kur paraqitet nevoja. Të verbërit apo ata që kanë probleme ortopedike duhen ndihmuar të kalojnë rrugën, të hipin në makinë apo të mbajnë plaçkat që kanë në duar.

- Nuk duhet përqeshur asnjëri, për arsye të ndonjë të mete fizike apo të ndonjë lapsusi të caktuar.

- Nuk duhet t'i hidhen shikime me vëmendje e as të shpeshta një njeriu që sheh për së pari. Kjo gjë nuk duhet bërë, pasi ky gjest mund ta shqetësojë personin në fjalë.

- Njerëzit duhen konsideruar si amanetet e Zotit të Madhëruar, ndaj duhen respektuar.

- Duhen respektuar zgjedhjet apo shijet e njerëzve.

- Duhen respektuar të drejtat e natyrshme të njerëzve, si dhe duhet kontribuar për barazinë, drejtësinë, lirinë dhe mirësjelljen në mesin e njerëzve.

- Si përfundim, njeriu duhet ta përvetësojë idenë se "*dashuria është çelësi i gjithçkaje*".



Kurani

Famëlarhtë

Ergys Hoxha


Vëllezër e motra, myslimanë e myslimane, ju o besimdrejtë dijeni se e kemi obligim të jemi të ditur. Djeni se kemi urdhrin e Fuqplotit si arsye për ta thënë të vërtetën sido që të jetë, andaj kush të mundet le ta flasë atë për ata që dëgjojnë. Nëse s'mund ta flasë, le ta shkruajë për ata që lexojnë e, nëse edhe këtë nuk mund ta bëjë, atëherë le të punojë fort me veten e tij për të qenë shembull i denjë i Kuranit, Profetit (s.a.v.) dhe i Islamit madhështor, që Allahu e zgjodhi fe për njerëzinë.

Djeni se në këtë botë ka vetëm dy rrugë, njëra është ajo që caktoi Krijuesi ynë si mëshirë, udhëzim e shpëtim për njeriun e tjetra e shejtanit të mallkuar që cyt për ligësi e humbje. Në njërën anë është Krijuesi, Mëshiruesi, i Gjithëpushtetshmi, Falësi, Udhëzuesi, Ai që robin e Tij e do më shumë se ç'e do nëna foshnjën e saj, Ai tek i Cili do të kthehemi pa diskutim, ndërsa në anën tjetër është mohuesi i parë i Zotit të botëve e i yni gjithashtu. Ai i cili është betuar se do ta cysë njeriun deri në kiamet për ta devijuar nga udha e drejtë e për ta humbur. Në njërën anë është mirësia, mëshira e begatia e në tjetrën ligësia dhe e keqja. Ty, o biri i Ademit, që po jeton si ymeti i profetit Muhamed (a.s.), të takon të zgjedhësh. Po të jesh ndër ata që mendojnë, pa dyshim do të zgjedhësh mirësinë e do të udhëzohesh. Po të jesh ndër ata që nuk mendojnë e në zemrat e tyre sundon shejtani, fatkeqësisht nuk do të zgjedhësh mirësinë e nuk do të udhëzohesh. Ti do të jesh prej të humburve,

Zoti na ruajtë.

Për të marrë mësim, në ditët tona janë ndërtuar shkolla e universitete me stafe akademike, të cilët në bazë të njohurive të marra nga studimet dhe atyre të fiksuara nëpër libra mbajnë leksione (predikim) për studentët. Duke dëgjuar referimet e tyre, këta të fundit mbajnë shënime plotësuese, përdorin literaturën e duhur për të arritur sukses në fusha të caktuara.

Këtë gjë Allahu i Madhëruar e ka bërë qysh me Adem (a.s.), e në radhë me të gjithë të dërguarit e tjerë, paqja qoftë mbi ta. Kurse të dërguarit, pa përjashtim, e bënë me popujt e tyre. Ata me të vërtetë e përmbushën misionin e caktuar nga Zoti i gjithësisë, e çuan në vend në mënyrën më të mirë amanetin e Fuqplotit. Allahu i Madhëruar ia mësoi Adem (a.s.), emrat e sendeve dhe e bëri më të diturin ndër krijesat e tjera. Më pas, engjëjt u përulën para Adem (a.s.), kurse shejtani jo. Ai e rriti mendjen dhe u bë i pafe. Allahu i Madhëruar ua shpalli të vërtetën profetëve të Tij në forma të ndryshme. Disave me frymëzim, disave me fletushka ose nëpërmjet engjëllit Xhebrail. Të gjithë ata predikuan (mbajtën leksione) për popujt e tyre, duke e çuar besnikërisht amanetin e urdhrin e Zotit në vend. Kështu bëri Fuqploti edhe para 1433 vitesh, në kohën kur njerëzimi kishte devijuar nga mësimet e Isait (a.s.) dhe kur vetë Isai (a.s.), kishte paralajmëruar për ardhjen e Profetit të fundit. Me caktimin e Allahut erdhi lajmëtari i udhëzimit hyjnor, mëshirë e gjithë botërave, morali më i lartë ndër krijesa,



Krijesa më e përsosur e Krijuesit. Bashkë me Profetin e gjithë profetëve, Allahu i Madhëruar i zbriti atij për 23 vjet me radhë nëpërmjet Kryeengjellit Xhebrail, Librin e librave, Kuranin Famëlartë. Nuk ka gjë që të mos përfshihet në të. Ai është padyshim vepër e Fuqiptotit, udhëzim për besimdrejtët, shpëtim për ata që mendojnë, mëshirë, begati, furnizim, kënaqësi, lumturi, paqe, mbarësi e gjithçka tjetër e mirë për ata që e mbajnë në zemër e jetojnë me parimet e Tij. Fuqiptoti është garant i Tij deri në Ditën e Kiametit. Profeti i Zotit ua "referoi" Kuranin njerëzve, ashtu siç bënë edhe profetët e tjerë para tij. Njerëzit i përqaftuan mësimet e tij; e mësuuan Kuranin Famëlartë përmendsh, pa humbur asnjë presje nga Ai, derisa në ditët tona nuk mund të gjesh në të gjithë globin dy Kuranë të ndryshëm, qoftë edhe me një presje. Në tërë botën është dhe do të mbetet një, i pandryshueshëm. Por në kohën e Profetit (a.s.), kishte edhe nga mohuesit, nga ata që i kanë zemrat e ngurta. Shejtani dhe e keqja kishin pushtuar zemrat e tyre e vetëm dyshonin, mohonin e shpifnin ndaj Profetit (a.s.) e Kuranit Famëlartë. Kështu, në shumë ajete Kuranore Fuqiptoti na tregon për gjendjen e tyre të mjerë e në shumë të tjera dëshmon me argumente të qarta për vërtetësinë e fjalës së Tij. Unë do të ndalem vetëm në disa ajete që dëshmojnë qartë që Kurani është shpallje dhe fjalë e padiskutim të Zotit të botëve. Kështu, në ajeti 2, të sures Bekare, Allahu i Madhëruar thotë:

Ky është libri, në të cilin nuk ka dyshim (sepse është prej Allahut); është udhëzues për ata që janë të devotshëm. (Bekare, 2)

Nga ajeti i mësipërm kuptohen qartë dy mesazhe që Zoti (xh.sh.), u jep njerëzve: i pari i fton të mos jenë dyshues për atë që zbriti për njerëzinë dhe i dyti, jo për të gjithë Kurani është udhëzues. Të përjashtuar nga kjo, janë ata që nuk pajtohen me parimet e tij, ata që nuk i përkushtohen atij. Sa më shumë të jesh me të, aq më shumë je afër udhëzimit të tij.

Ndërsa në ajetet 23 e 24 të sures Bekare, Allahu i Madhëruar u drejtohet dyshuesve e mohuesve, duke u thënë:

E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kurani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotat), përveç Allahut, nëse jeni të sigurtë (në theniet tuaja se Kurani nuk është prej Zotit). (Bekare, 23)

E mos e paçi bërë (deri më tash) e as që do ta bëni kurrë në të ardhmen, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për jobesimtarët. (Bekare, 24)

Meqë mohuesit nuk hiqnin dorë nga dyshimet, Fuqiptoti i ftonte ata bashkë me zotat e tyre të sillnin një kaptinë të ngjashme me Kuranin, nëse ishin të sigurtë në dyshimet e tyre. Por Allahu i Lartësuar e dinte sa të

sinqertë e sa të aftë ishin ata për ta bërë një gjë të tillë. Kurani Famëlartë është vepër e Fuqplotit e njerëzit bashkë me xhindët as që mund t'afrohen atij. Kështu, në ajetet 88, 89 të sures Isra, Zoti i Madhëruar thotë:

Thuaj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhindët për të sjellë një Kuran të tillë, ata nuk do të mund ta bënin si ky, sado që ta ndihmonin njëri-tjetrin." (Isra, 88)

Edhe në këtë ajet, Zoti i gjithësisë i garanton njerëzit për pamundësinë e tyre për të sjellë, qoftë edhe një kaptinë të vetme, edhe nëse me ta bashkohen xhindët. Kështu, Zoti (xh.sh.), i fton njerëzit të heqin dorë nga dyshimet dhe ta njohin madhësinë e shpalljes së Tij. Në ajetin vijues të po kësaj sureje, Zoti i gjithësisë thotë:

"Ne u sqaruar njerëzve në këtë Kuran shembuj (argumente) të çdo lloji, por shumica e njerëzve nuk deshi tjetër, vetëm mohimin." (Isra, 89)

Allahu i fton njerëzit të kuptojnë vërtetësinë e tij nëpërmjet shembujve që përmban, argumente të padebatueshme. Sërish Allahu i Madhëruar na bën me dije se disa prej njerëzve janë mohues e për rrjedhojë, nuk duan t'i kuptojnë shembujt (argumentet) e Zotit.

Në një ajet tjetër, Allahu urdhëron:

"Edhe ky (Kurani) është libër që e zbritëm, është i bekuar, vërtetues i të mëparshmes e që t'i tërheqë vërejtjen nënës së fshatrave (të banorëve të Mekës) dhe atyre përreth saj (mbarë botës). Ata që e besojnë Ahiretin, besojnë në Kurandin; ata edhe e falin namazin rregullisht." (En'am, 92)

Edhe në këtë ajet, Allahu i Madhëruar na njeh me vërtetësinë e Kuranit Famëlartë dhe mirësitë e tij. Vetëm në Kurandin Famëlartë mund të gjejmë të flitet për të mëparshmen në një mënyrë të pashoqe, deri në detaje. Fuqploti e bëri këtë që Kurani të jetë argument i qartë për njerëzit e për të shtuar bindjen e besimtarëve.

Në një ajet tjetër, Zoti shpall:

Thuaj: "Atë (Kurandin) e solli "Ruhul Kudus", shpirti i shenjtë, plot vërtetësi nga Zoti yt, për të përforcuar edhe më ata që besuan dhe për të qenë udhërrëfyes e myzhdë për myslimanët." (Nahl, 102)

Duke qenë plot vërtetësi, Kurani ua shton besimin myslimanëve. Ai është për ta mrekullia e të gjitha kohërave, është udhërrëfyes e myzhdë për myslimanët.

"O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kurani) edhe shërimi i asaj që gjendet në kraharrorët tuaj edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët." (Junus, 57)

"Ky (Kurani) është dritë e dijes për njerëz, është udhëzues e mëshirë për një popull që beson bindshëm." (Xhathije, 20)

Edhe në dy ajetet e mësipërme i Gjithëdijshmi na tre-

gon se shërimi i zemrave, mëshira, drita e dijes gjenden padyshim te Këshilla, Kurani Famëlartë.

Në ajetin e mëposhtëm Allahu (xh.sh.), pasi e përshkruan Kurandin si të folmen më të mirë, plot me këshilla e mrekulli, u drejtohet atyre që i druhen Atij, që e përjetojnë në shpirt kur e dëgjojnë e më pas qetësohen me përkujtim ndaj Zotit të botëve.

"Allahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij të rrëqethen lëkurat e atyre që i druhen Zotit të tyre, pastaj me përkujtim ndaj Allahut t'u qetësohen lëkurat dhe zemrat. Ky libër është udhëzim i Allahut. Ai udhëzon me të atë që do. E atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë udhëzues." (Zumer, 23)

"Ne u kemi sjellë njerëzve në këtë Kuran, shembuj nga çdo lëmi e nevojshme, në mënyrë që ata të marrin përvojë (mësim)." (Zumer, 27)

Ajeti i mësipërm është dëshmi e pashoqe e një gjendjeje, e cila jetohet sot, e një realiteti që është bërë i qartë këtu e 14 shekuj më parë. Shembuj nga çdo lëmi e nevojshme, që përmend Allahu i Madhëruar, po zbulohen sot nga shkencëtarët, të cilët në më shumë se 90% të zbulimeve, sapo vihen në dijeni të ajeteve kuranore, mahniten e pranojnë Islamin.

"Duke qenë arabisht, Kurani nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar." (Zumer, 28)

Në ajetin e mësipërm, Allahu i Lartësuar tregon për pastërtinë dhe qartësinë e gjuhës arabe, në krahasim me gjuhët e tjera, gjuhë e cila nuk lë vend për shtrembërime e keqkuptime, "besnike" e mesazhit të Fuqplotit.

"Dhe po ashtu (siç zbritëm librat e mëparëshëm) Ne ta zbritëm ty librin. E ata, të cilëve Ne u kemi dhënë librin i besojnë këtij (Kurani). Ka edhe nga ata (idhujtarët arabë) që i besojnë këtij, kurse argumentet tona nuk i refuzon askush, përveç jobesimtarëve." (Ankebut, 47)

"Ti (o Muhamed) nuk kishe lexuar ndonjë libër para këtij e as që e shkrove atë me dorën tënde të djathtë. Pse atëherë të dyshonin ata të prishurit?" (Ankebut, 48)

"Por ai është plot argumente të qarta për zemrat e atyre që u është dhënë dituria; e argumentet tona nuk i mohon kush, veç të shfrenuarve." (Ankebut, 49)

Edhe ajetet e mësipërme janë dëshmi e qartë rreth vërtetësisë së Kuranit Famëlartë. Allahu (xh.sh.), bën me dije se, ashtu siç zbriti librat e mëparëshëm, ashtu edhe Kurani është prej Tij. Më tej, në ajetin vijues, ua kujton mohuesve se si ishte Profeti (a.s.), para se t'i vinte shpallja. As lexim e as shkrim nuk dinte. Atëherë, pse do të dyshonin të prishurit, thotë Fuqploti Allah.

Në këtë ajet tregohet qartë se në ç'gjendje të ulët ishin mohuesit, sa të verbër e injorantë ishin karshi argumenteve të Fuqiplotit.

Ajetet e mëposhtme janë nga dëshmitë më të forta e më të qarta që shpall Allahu i Madhëruar. Fakti se Kurani Famëlartë është i përmendur në librat e mëparshëm dhe se dijetarët e Beni Israilëve kishin dijeni për këtë gjë, flet qartë mbi gjendjen e mohuesve. Mohimi i tyre kishte përfshirë edhe shpalljet e tyre të mëparshme. Argumentet e qarta që vinin nga Zoti (xh.sh.), rreth të mëparshmes, plus atë që dëshmonin librat e mëparshëm, si dhe dijetarët e Beni Israilëve për Kurantin Famëlartë, nuk mjaftonin për mohuesit e as nuk do të mjaftojnë ndonjëherë. Gjendjen e tyre e di më së miri vetëm Allahu Gjithëdijshëm.

E edhe ai Kurani është shpallje e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhebraili). (E sollti) në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen. (Ta shpallëm) me gjuhë të kulluar arabe. Dhe se ai (Kurani) është i përmendur edhe në librat e mëparshëm. A nuk është për ata (jobesimtarët mekas) argument se atë e dinin dijetarët e Beni Israilëve? E sikur t'ia shpallnim atë (Kurantin) ndonjë joarabi e ai t'ua lexonte atyre, ata nuk do t'i besonin atij. Dhe kështu, ne u futëm atë (dyshimin) në zemrat e kriminelëve. E ata nuk i besojnë atij (Kuranit), derisa të shohin dënimin e dhembshëm. (Shuara, 192-201)

Thuaj: "Atë e shpalli Ai që e di të fshehtë në qiej e në tokë, Ai është që fal shumë, është mëshirues." (Furkan, 6)

Në një ajet kuranor, Zoti thotë:

"Sikur Kurani të ishte prej dikujt tjetër, përveç Zotit, njerëzit do të gjenin në të shumë kundërthënie." (Nisa, 82)

Jo vetëm që kundërthëniet nuk ekzistojnë në Kuran, por shumë pjesë të këtij Libri të Shenjtë përmbajnë mrekulli të ndryshme, të cilat zbulohen dita-ditës.

Njerëzimi duhet të kapet fort pas këtij libri hyjnor, të shpallur nga Zoti dhe ta pranojë atë si udhëzimin e tij të vetëm. Në një nga ajetet kuranore, Zoti na bën thirrje:

"Këtë libër ne e bëmë dobiprurës e të begatshëm, ndaj përmbajuni atij dhe ruajuni (nga gjynahet), me qëllim që të mëshiroheni." (En'am, 155)

Në një ajet tjetër, Zoti tërheq vërejtjen:

Thuaj: "E vërteta është ajo që vjen nga Zoti juaj,

ndaj kush të dojë, le të besojë dhe kush të dojë, le të mohojë." (Kehf, 29)

"Në të vërtetë, këto janë këshilla. Kush dëshiron, merr mësim nga ky Kuran." (Abese, 11-12.)

Të gjitha këto ajete që shqyrtoam më sipër, vërtetojnë qartë se Kurani është një libër, në të cilin çdo gjë e shpallur është provuar dhe do të provohet të jetë e vërtetë edhe në të ardhmen. Faktet rreth temave shkencore, lajmet mbi të ardhmen dhe përshkrimi i historive të ndodhura në kohët e lashta, tregojnë se askush nuk mund t'i njihete ato në kohën e shpalljes së Kuranit. Kjo na vërteton bindshëm një gjë: se Kurani nuk ka mundësi të jetë fjalë e njeriut, ai është fjala e Zotit të Plotfuqishëm, Krijuesit të gjithçkaje, dija e të Cilit përfshin çdo gjë.

Myslimanë të nderuar, ju që e keni besuar Kurantin Famëlartë, dijeni se e keni amanet t'ua përcillni atyre që nuk kanë dijeni për të. Jua kujtoj juve, por edhe vetes sime, që gjëja më serioze në këtë botë, të jetë feja, marrëdhënia më e shenjtë të jetë ajo me Zotin (xh.sh.), sinqeriteti më i madh të jetë ndaj Krijuesit të gjithçkaje, falënderimi, falja, pendimi, mbrojtja, mbështetja, udhëzimi, shpresa, mëshira, furnizimi, begatia e pafund e të tjera si këto, ia dedikojmë vetëm Allahut të Gjithëpushtetshëm. Shpejt vjen dita e takimit me Allahun (xh.sh.), e gjithkush duhet ta kuptojë se nga kjo botë s'ka për të marrë veçse atë që ka punuar. Ndarja nga kjo botë s'është tjetër veçse një prej argumenteve që Allahu nuk e ka krijuar gjithë këtë ekzistencë me gjithë ç'ka përqark vetëm për atë që shpalli në Kurantin Famëlartë. Kthimi tek Ai, Llogaria, Xheneti e Xhehnemi janë të vërteta (hak). Ndaj beso bindshëm, sepse pa dyshim zbulimet, vërtetimet e shkencës rreth asaj që është shpallur në Kurantin e Allahut të Gjithëdijshëm, përbëjnë mrekulli të qartë, ashtu siç është edhe ai vetë. Ta mbajmë Kurantin si udhërrëfyës e të mos jemi mospërfillës ndaj dijes (shkencës), derisa ajo të mos ketë kundërshti me të. Kështu do të jemi në rrugën që porositi Allahu i Lartësuar dhe Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të. Uroj që ky shkrim të jetë një përpjekje modeste, që do të shërbejë për të zgjuar ndërgjegjen e njerëzve që e duan Zotin (xh.sh.) dhe fenë e Tij dhe të forcojë imanin e tyre gjithashtu.

Ne me madhësitinë Tonë e shpallëm Kurantin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij. (Hixhr, 9)





RESPEKTI NDAJ PEJGAMBERIT (A.S.)

Dr. Kerim Bulladë

Kur bëhet fjalë për respektin ndaj Pejgamberit (a.s.), na vjen në mendje urdhri i Kuranit Famëlartë që të biem salavat kur përmendet emri i të Dërguarit të Allahut. Ky urdhër shpjegohet në këtë mënyrë: **“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam!”**” (Ahzab, 56)

Një sahab, i quajtur Ka'b b. Uxhre, tregon: “Kur u zbrit ky ajet, shkova pranë Pejgamberit (a.s.) dhe i thashë: “O i Dërguari i Allahut! Selamin e kuptojmë (si do ta japim), por salatin nuk e kuptojmë (si duhet ta bëjmë)” Pejgamberi (a.s.), udhëzoi të thuej kështu: “*Allahumme sal-li ala Muhammed'in ue ala ali Muhammed.* Kema sal-lejte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid. Allahumme barik ala Muhammed'in ue ala ali Muhammed. Kema barekte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid” (O Allah! Mëshiroje Muhamedin (a.s.) dhe familjen e tij, ashtu siç mëshirove Ibrahimin (a.s.) dhe familjen e tij. Me të vërtetë, Ti je i Falënderuar dhe i Madhëruar. O Allah! Begatoje Muhamedin (a.s.) dhe familjen e tij, ashtu siç begatove Ibrahimin (a.s.) dhe familjen e tij. Me të vërtetë, Ti je i Falënderuar dhe i Madhëruar.” (Buhari, Tefsir, 33/10; Muslim, Salat, 66.)

Të respektosh Pejgamberin (a.s.), duke i dhënë selam dhe të bësh salavat për të, është farz. Në lidhje me këtë çështje janë transmetuar edhe disa hadithe. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: **“Turp për atë që nuk bie salavat për mua kur përmendet emri im.”** (Ahmed b. Hanbel, II, 254; Tirmidhi, Daaat, 100.) Ndërsa në një

hadith tjetër Pejgamberi (a.s.), ka thënë: **“Allahu Teala ka ngarkuar me detyrë dy melekë për mua. Kur unë përmendem në prani të ndonjë myslimani dhe ai bie salavat për mua, ata dy melekë, thonë: ‘Allahu të faltë! Allahu Teala dhe melekët e tjerë u përgjigjen atyre dy melekëve duke thënë, “amin!”** Nëse një mysliman nuk bie salavat për mua kur emri im përmendet në prani të tij, ata dy melekë thonë: ‘Allahu mos të faltë!’ Allahu Teala dhe melekët e tjerë u përgjigjen atyre dy melekëve duke thënë, “amin!””

Myslimanët, që janë të vetëdijshëm për urdhrin e Kuranit dhe hadithet në lidhje me salavatën ndaj Pejgamberit (a.s.), nuk harrojnë kurrë që pasi të kenë falënderuar Allahun, t'i çojnë selam dhe të bëjnë salavate për Pejgamberin (a.s.), në çdo rast apo vend qofshin. Kur përmendet emri i bekuar i Pejgamberit tonë (a.s.), çdo mysliman duhet të tregojë respektin e thellë që ka ndaj tij, duke thënë: **“Allahumme sal-li ala Muhammed'in ue ala ali Muhammed”** dhe duhet t'i çojë selam duke shprehur dashurinë dhe lidhjen e fortë që ka me të.

Salavati i Allahut ndaj Pejgamberit (a.s.), do të thotë, se Allahu Teala është shumë i mëshirshëm ndaj Pejgamberit (a.s.), e lavdëron atë, ia begaton punët, e lartëson emrin e tij dhe zbret mëshirën mbi të. Ndërsa salavati i melekëve ndaj Pejgamberit (a.s.), do të thotë, se melekët e duan shumë Pejgamberin (a.s.) dhe i luten Allahut që t'i japë atij pozitë të lartë.²

Respektimi i Pejgamberit (a.s.), të cilit Allahu Teala i ka dhënë vlerë dhe melekët e përmendin me respekt, është detyra e çdo besimtari. Idhujtarët dhe dyfytërrëshit dëshironin dështimin e Pejgamberit (a.s.) dhe mundoheshin me mish e me shpirt që me çdo lloj mënyre e propagande ta ulnin vlerën e tij e ta poshtëronin atë në sy të njerëzve.

Pas ajetit i cili urdhëron selamin dhe salavatën ndaj

1. Ibn Kethir, Tesiru'l-Kur'ani'l-Adhim, Stamboll, 1985, VI, 466.

2. Ebu'l-Ala Meududi, Tefhimu'l-Kur'an, përkthimi, Kurul, Istanbul, 1996, IV, 450.

Pejgamberit (a.s.), menjëherë vjen ajeti tjetër ku Allahu Teala shprehet: **“Pa dyshim, ata që fyejnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, i mallkon Allahu në këtë botë dhe në tjetrën. Ai ka përgatitur për ta ndëshkim poshtëruës.”** (Ahzab, 57.) Siç shihet, Allahu Teala e mbron Pejgamberin (a.s.), duke i kërcënuar ata që e mundonin atë me dënim në këtë botë dhe në botën tjetër. Në ajetet që vijnë theksohet se ata që nuk e respektojnë Pejgamberin (a.s.), nuk janë gjë tjetër veçse dyfyturësh dhe mohues.

Me anë të ajetit, i cili urdhëron salavatit ndaj Pejgamberit (a.s.), Allahu Teala u kujton besimtarëve mirësinë e shpalljes dhe u tërheq vëmendjen, se në sajë të Pejgamberit (a.s.), gjetën rrugën e drejtë dhe për këtë duhet t'i jenë mirënjohës atij.

Është shumë me vend që të përmendim këtu edhe vlerësimin e Meududit në lidhje me këtë temë: “O ju që keni gjetur rrugën e drejtë në sajë të Rasulallahut (a.s.)! Ju duhet ta kuptoni vlerën e tij të vërtetë dhe të jeni mirënjohës për mirësitë e mëdha ndaj jush. Ju kishit humbur në errësirën e injorancës dhe ai ju solli dritën e diturisë. Morali juaj ishte përtokë dhe ai ju ngriti në një moral aq të lartë, sa që ju kanë zili të gjithë ata që keni përreth. Ju ishit të egër e barabar, kurse ai ju solli në civilizim. Për shkak të këtyre mirësive që ju dha, mohuesit u armiqësuan me të, edhe pse ai nuk i kishte dëmtuar ata personalisht. Për këtë arsye, në emër të mirënjohjes suaj ndaj këtyre mirësive, ju duhet ta respektoni atë njësoj ose më tepër se armiqësia dhe urrejtja që tregojnë mohuesit ndaj tij. Përballë dëshirave të tyre të liga, ju duhet të kërkoni mirësinë ndaj tij edhe me më shumë dëshirë dhe duhet të bëni dua për të ditë e natë ashtu siç bëjnë edhe melekët. O Zoti i botëve! Pejgamberi (a.s.), u përpoq, u mundua, vuajti, u torturua dhe kaloi shumë vështirësi për ne. Prandaj, mëshiroje atë me mëshirën Tënde të pafundme. Lartësoje emrin e tij në këtë botë dhe fali atij gradat më të larta pranë Teje në botën tjetër.”³

Pejgamberi (a.s.), ka shumë të drejta mbi ne. Kjo sepse ai na e kumtoi Kuranin, na mësoi urtësinë, punoi ditë e natë që ne të udhëzohemi, të ruhemi prej shirkut dhe kryeneçësisë ndaj Allahut dhe të pastrohemi prej gjynaheve. Ai ka më shumë të drejta mbi ne se sa prindërit tanë, sepse Pejgamberi (a.s.), konsiderohet babai shpirtëror i umetit.

Pejgamberi (a.s.), kishte natyrë njerëzore. Hante, pinte, flinte, martohej, lodhej, gëzohej e hidhërohej. Por, në të njëjtën kohë, ishte edhe një njeri i zgjedhur që i vinte shpallje prej Allahut. **Thuaj** (o Muhamed!): **“Në të vërtetë, unë jam vetëm një njeri si ju. Mua më është shpallur që Zoti juaj është një Zot i Vetëm, andaj ecni në rrugën e drejtë...”** (Fussilet, 6) **Thuaj**: **“Mua më është shpallur që Zoti juaj është një Zot i vetëm;**

3. Mevdudi, e njëjta vepër, IV, 451.

pra, a jeni myslimanë?”

(Enbija, 108) **Thuaj**: **“Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshmen dhe as nuk them se jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet...”** (En'am, 50) Këto dhe ajete të tjera na tregojnë qartë se Pejgamberi (a.s.), ishte veç një njeri si ne. Mirëpo, shpallja që i zbriste dhe zgjedhja e tij si pejgamber nga ana e Allahut Teala, tregojnë se ai dallonte nga njerëzit e tjerë. Gjithashtu, Allahu Teala e edukoi dhe e lartësoi mbi çdo njeri tjetër. Për këto dhe të tjera arsye, ne nuk mund të sillemi me të ashtu siç sillemi me njerëzit e tjerë. Kjo shprehet qartë edhe në një ajet fisnik: **“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit; Allahu, me siguri, i di ata që shkëputen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.”** (Nur, 63)

Ky ajet thekson qartë se asnjë besimtar nuk duhet ta krahasojë thirrjen që u bëhet të tjerëve me thirrjen që i bëhet Pejgamberit (a.s.) dhe se nuk duhet ta thërrasin atë në emër siç thërrasin njëri-tjetrin. Pra, nuk është e drejtë nga ana jonë që Pejgamberin (a.s.), ta përmendim me emër, si “O Muhamed!”. Atë duhet ta përmendim me respekt dhe përlulje, si “O Nebijallah! O Rasulallah!” etj. Në ajet, të gjithë ata që e ofendojnë atë, që refuzojnë ftesën e tij dhe që kundërshtojnë urdhrat e tij, kërcënohen me bela të shumta në këtë botë, si fatkeqësi natyrore dhe sociale dhe veçanërisht me dënim të ashpër në botën tjetër.

DETYRAT TONA NDAJ PEJGAMBERIT (A.S.)

Pranimi i ftesës së Pejgamberit (a.s.), është farz (i detyrueshëm). Lutja e tij pranohet menjëherë nga Allahu Teala. Për këtë arsye, besimtarët duhet t'i zbatojnë me përpikmëri të gjitha urdhrat e tij dhe duhet të ruhen nga çdo gjë që do ta fyente atë.

Historia është dëshmitare e pakontestueshme e madhësisë që kanë arritur myslimanët, të cilët i zbatuan me përpikmëri urdhrat dhe këshillat e Pejgamberit (a.s.). Gjithashtu, ajo ka dëshmuar edhe për belatë dhe fatkeqësitë që kanë përjetuar popujt të cilët kanë vepruar të kundërtën e tyre.

Ne nuk mund t'i drejtohem Pejgamberit (a.s.), ashtu siç i drejtohem njëri-tjetrit. Kur të përmendet emri i tij, çdo mysliman e ka për detyrë të bjerë salavate dhe t'i çojë selame me respekt dhe përlulje. Allahu Teala e ka përmendur emrin e tij në Kuranin Famëlartë, duke ia prezantuar njerëzimit të shoqëruar me cilësinë e pejgamberisë. Ky është një mësim i rëndësishëm që Allahu Teala u jep njerëzve në lidhje me sjelljen ndaj Pejgamberit (a.s.). Përveç kësaj, kjo tregon edhe vlerën e madhe që Allahu Teala i jep Pejgamberit tonë (a.s.).

FEJA DHE

Krahasimi mes fesë dhe totalitarizmit komunist, si përzjerje e integritit të ideologjisë së vetme sunduese, partisë-shtet, kultit të udhëheqësit, madhësisë së kombshetit, terrorit dhe frikësismit masiv, do të shpërfaqet si imitim i strukturës së fesë nga ana e komunizmit, edhe pse ideologjikisht komunizmi është i papajtueshëm me fenë, konsequent në luftën ndaj saj pa kompromise, pa koncesione.

FEJA

Thelbi i fesë është besimi te Zoti, Qenie absolutisht absolute, me emra dhe cilësi po absolute. Ai është i Pagabueshëm, i Përjetshëm, asgjë nuk është si Ai, është Dëgjuesi, Shikuesi dhe Sunduesi absolut, që di, kontrollon e përcakton çdo gjë, çdo lëvizje qoftë edhe të grimcës më të imët. Ai kujdeset për çdo krijesë që e furnizon pa kushte dhe marrëveshje. Njerëzit duhet t'i frikësohen Zotit, përpara se ta veprojnë të keqen, që fundi i tyre të mos jetë dënimi në këtë botë dhe në botën tjetër. Adhurimi si demonstrim i besimit që buron nga thellësia e zemrës e që është fjalë dhe vepër i dedikohet Zotit me dashuri dhe nënshtrim të plotë. Fjala e Zotit është ligj i padiskutueshëm që duhet jetësuar. Rituale mund të kryhen në çdo cep të lëmshit të dheut qoftë edhe individualisht, por marrin natyrë komunitare e gjithëpërfshirëse kur kryhen në tempuj, faltore të ngritura për adhurimin e Zotit. Ai cilësohet vetëm me cilësi të mira dhe nuk mund t'i atribuohen cilësi negative.

Feja ka si pikëmbështetje doktrinale librin e shenjtë, Fjalë e Zotit, shpallur për njerëzit, ndryshe nuk do të kishte kuptim të qenurit e këtij libri, udhërrëfyes, ndriçues, rregullator i rrugëtimit të njeriut drejt transhendentales. Nuk mund të ndryshohet apo të vihet në dyshim autenticiteti i tij hyjnor, nuk mund të kritikohet apo t'i mvishet e pavërteta nga cilido pikëlëshim atakimi. Çdo fjali, fjalë, shkronjë e tij është e vërtetë, sepse buron nga i Vërteti, Zotërues

i cilësive absolute që nuk mund të jenë imanente, por transhendente. Ky libër i karakterizuar me këto cilësi në këtyllësinë e tij, mbërrin te krijesat nëpërmjet njeriut të zgjedhur, po nga Zoti dhe jo i vetëzgjedhur për këtë detyrë - profeti. Ligjet dhe rregullat që burojnë nga libri i shenjtë duhet të zbatohen me konsekuencë, për aq sa njeriu mund të jetë konsequent. Njeriu nuk mund të protestojë ndaj ligjeve të Zotit, sepse kjo do të thoshte protestë ndaj të përsosurës, absolute nga joabsolutja, relativja, e papërsosura që nuk mund ta përfshijë në suazat e gjykimit të vet me shumë mangësi, urtësinë e gjykimit absolut. Substrati i ligjeve hyjnore është deviza "dëgjuam dhe u bindëm".

Feja, duke qenë *modus vivendi*, universaliste dhe jo antiuniversaliste, jo dogmë që kërkon arratisjen e njeriut nga bota materiale, e pandryshueshme në hapësirë dhe kohë, kërkon nga njeriu jo thjesht besimin me zemër, që *de facto* është dhe pikënisja e çdo praktike, por dhe jetësimin praktik të asaj çka njeriu beson. Kështu, feja, duke trasuar rrugëtimit e njeriut në këtë botë, si shtëpia e tij as e parme dhe as e fundme, ka si qëllim final shpëtimin e njeriut nga ligësitë dhe zullumet dhe jo përsosmërinë e tij, për të garantuar lumturinë në tokë më së pari, në rast se fjalët dhe veprimet e tij nuk kanë qenë tjetërfarë pasqyrimi i asaj çka ka besuar në zemrën e tij. Çdo fjalë, çdo veprim, çdo sakrificë përballet me fundin e pashmangshëm, shpërblimin apo ndëshkimin në jetën e përjetshme, në varësi të qëllimit. Kështu feja mëton në respektimin e drejtësisë, mirësisë, shpresës se përmes vullnetit për t'u orientuar drejt së mirës, do të mbizotërojë dashuria, respekti, harmonia ndërmjet pjestarëve të shoqërisë dhe do të kufizohet aftësia vepruese e padrejtësisë dhe ligësisë.

KOMUNIZMI

Udhëheqësi cilësohet i pagabueshëm, udhëheqës i madh të cilit i blatohej cilësitë më të mira dhe pozitive.



KOMUNIZMI


Ai është i përjetshëm në qeverisje, i pazëvendësueshëm, i pandryshueshëm, absolut në sundimin e tij, pa kujdesin e të cilit çdo gjë shkatërrohet e humbet. Trendi i tij është kontrollues krejtësor i çdo veprimi të nënshetasve të vet. Njerëzit i frikësohen atij dhe nuk mund të flasin kundër tij, se i pret dënimi, ndryshe nga feja, ku Zoti fal çdo gjë për aq sa njeriu pendohet sa është gjallë. Nderimi, respektimi dhe frika ndaj udhëheqësit, shkakëson përputhshmërinë e fjalëve dhe veprave të njeriut, me urdhërat e tij që janë ligj i padiskutueshëm që duhet zbatuar, përderisa është e pagabueshëm. Tendenca antropolatriste është e qartë. Në Shqipëri diktatori u faraonizua duke ndërtuar piramidën për hir të tij, që përtej kombinacionit të gurëve me forcën arkitektizuese të njeriut, simbolizon tempullin e faraonit “zot”. Madje edhe në rastet kur nuk përmendej me emër drejtpërdrejt, diktatori do të përmendej me Ai, i Atij, i Tij, që përdoren në këtë trajtë vetëm për Fuqinë e Epërme. Faraonizimi i udhëheqësit nuk ishte as më shumë e as më pak vetëm se *apoteosis*.

Komunizmi ka si pikëmbështetje doktrinale jo thjesht një libër të vetëm, por shumësia e këtyre librave përmbledhet te një emër marksizëm-leninizëm, që është ideologjia e vetme sunduese. Doktrina komuniste është e pakritikueshme. Ajo konsiderohet e vërtetë absolute. Çdo deviancë nga boshti marksizëm-leninizmit konsiderohet herezi, revizionizëm. Doktrina është e pakritikueshme. Prej saj marrin shkas udhëheqësit për shkrimin e veprave të tyre dhe çdo shpjegim për ngjarje, dukuri apo fenomene duhet të bëhet në kohezion me doktrinën. Duke u përshkruar me këto cilësi, ai konsiderohet si “libër i shenjtë”. Madje veprat e vetë diktatorëve në kohezion me “librin e shenjtë”, për silogjizëm kthehen në “libër të shenjtë”. Këtu diktatori, që siç e theksuam më sipër, merr përsipër rolin e Zotit, por pa absolutizmin e Tij, duke shpallur “të vërtetat e përjetshme” në librin e tij, detyrimisht të zbatueshme për ata që janë nën kontrollin e tij në hapësirën

ekzistenciale të totalitarizmit. Këto “të vërteta” nuk vihen në dyshim, madje as që duhet diskutuar për to. Hermeneutizimi i tyre duhet të jetë në përputhje me ideologjinë sunduese. Këto “të vërteta” duhet të zbatohen me konsekuencë të plotë pa marrë parasysh natyrën, rrethanat dhe gjendjen njerëzore.

Komunizmi vjen si ideologji që kërkon t'i japë shpresë njeriut se e ardhmja do të jetë e lumtur për të gjithë ata që besojnë te parimet e kësaj ideologjie dhe që marrin përsipër të sakrifkohen për jetësimin e tyre. Komunizmi i grish njerëzit, për të sakrifkuar që të shpëtojnë nga dekadencia morale dhe kalbëzimi i rendit kapitalist, se do të ndërtojë një rend të ri, një shoqëri të re universaliste dhe ideologjike të pandryshueshme për çdo kohë dhe vend. Komunizmi vjen në trajtën e luftuesit të së keqes, duke marrë përsipër të shpëtojë të varfërit nga shfrytëzimi; duke marrë përsipër të shpëtojë gruan dhe fëmijët nga egërsia e kapitalizmit; duke vendosur drejtësinë dhe egalitarizmin në këtë rend të ri botëror; duke u dhënë shpresë njerëzve për lumturinë e përhershme, kuptohet jo atë të përtejvarrit. Përmasat e doktrinës janë të përbotshme, jo të posaçëruara për ndonjë racë apo komb. Kështu, doktrina ateisto-materialiste duke mos i shpëtuar dot idealizmit kthehet në mesianizëm.

Ngjashmëritë strukturore nuk do të thonë që domosdoshmërisht janë ekuivalente të njëra-tjetrës dhe i përqaasen njëra-tjetrës. Ngjashmëritë e jashtme nuk janë kusht për ngjashmërinë brendësore të tyre. Imitimi i strukturës së fesë nga ana e komunizmit, duke larguar Fuqinë Hyjnore prej aty, është tregues i qartë i dështimit të mbështetjes krejtësore të njeriut tek vetvetja, ëshë tregues i qartë i dështimit të njeriut për të ngritur një fe pa Zot.



PENDIMI

NGA ASPEKTI I KËSAJ BOTE DHE I BOTËS TJETËR

Fahredin Jëlldëz

Njeriu është krijuar me natyrshmërinë e tij. Bërja e mëkatit ndoshta është një veçori që e ndan njeriun nga engjëjt. Njeriu, siç nuk mund të qëndrojë plotësisht larg mëkatit, po ashtu nuk mund të largohet as prej pendimit.

Njeriu e ka të pamundur të mos bie në mëkat. Kështu që, virtyti i vërtetë është pendimi duke ndjerë pishmanllëk nga mëkati i bërë. Në hadithin fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: *“Të gjithë bijtë e Ademit janë mëkatarë. Më i miri prej mëkatarëve është ai që pendohet.”*

Islami është një fe që i përshtatet natyrshmërisë njerëzore. Njeriu është krijuar me prirjen për të mëkatuar, por edhe për të bërë sevap. Duke pasur parasysh këtë fakt atij i janë treguar rrugët për të shpëtuar dhe për ta pakësuar ndikimin e mëkatit në jetën e tij. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në një hadith fisnik që e shpreh në mënyrën më të bukur natyrshmërinë e njeriut, thotë:

“Sikur të mos bënit mëkat, Allahu do t’ju shkatërronte. Pastaj do të krijonte robër të tjerë që bëjnë mëkate dhe pendohen pasi i bëjnë.”

Hazreti Pejgamberi, (a.s.), ka thënë se ai vetë bën teube dhe istigfar 70 ose 100 herë në ditë. Kjo shprehje tregon se edhe Hz. Pejgamber (a.s.), ka bërë teube. Edhe pse ai ishte i mbrojtur prej mëkateve, ashtu siç shprehet edhe vetë,⁽³⁾ nuk mund t’i ndalonte disa gjëra që i vinin në zemër dhe në këtë mënyrë pendohesh për to.

Mospendimi buron nga padituria ndaj Zotit, nga mosnjohja e ligjeve të Tij dhe të mangësive të vetes së njeriut. Për këtë arsye, njeriu më i padrejtë është ai që nuk pendohet ndaj Zotit. Pendimi është shumë i rëndësishëm. Kështu që, ne duhet ta dimë mirë çfarë është ai (pendimi) dhe cilët janë kushtet e tij.

Në të kundërt, njerëzit do të kthehen pa arritur te dera e pendimit, i cili është një prej mirësive më të mëdha që Allahu na ka dhuruar, për shkak se kushtet që nxirren në pah, në të vërtetë nuk janë kushtet e pendimit që kërkon

Allahu (xh.sh.). Përndryshe, njerëzit do të gabojnë duke menduar se janë penduar dhe se mëkatet janë falur në një kohë kur veprimi që kanë bërë, nuk është pendim.

A- PËRKUFIZIMI I PENDIMIT

Dijetarët myslimanë e kanë përkufizuar pendimin në forma shumë të ndryshme. Ndërsa ne, pasi të japim disa variante të përkufizimeve të pendimit, do të ndajmë me ju përkufizimin më gjithëpërfshirës.

“Pendimi është dhimbja e brendshme që të japin gabimet e bëra në të kaluarën.”

“Pendimi është shndërrimi i cilësive të këqija në cilësi të mira.”

“Pendim do të thotë që ta lësh mëkatin për shkak të shëmtisë së tij, të bëhesh pishman për veprën që ke bërë, të vendosësh se nuk do ta përsërisësh më dhe t’i japësh të dhunuarit hakun e tij.”

Me një përkufizim më përmbledhës, pendimin mund ta përkufizojmë:

“Nga ana e Allahut, të pendohesh ti, do të thotë që Ai të ta fal ty një vepër të keqe, një mëkat apo një faj të bërë. Ndërsa nga ana e robit, do të thotë që ai të pranojë se (vepra e bërë) është faj apo mëkat dhe t’i kthehet Allahut duke e lënë atë. Domethënë, të strehohet te Allahu, t’i kërkojë falje dhe t’i përgjërohet Atij duke shprehur se është bërë pishman për ato që ka bërë, duke i zbatuar urdhrat dhe duke u larguar nga gjërat që Ai i ka bërë haram.

ÇFARË ËSHTË PENDIMI I VËRTETË (TEUBE NASUHA)?

Këtu do të ishte me vend të shikonim veçoritë dhe kushtet e pendimit, i cili njihet si teube nasuha.

Teube nasuha do të thotë të qëndrosh larg çdo dyshimi, të jesh i përpiktë ndaj kushteve të pendimit, të pendohesh për mëkatin që ke bërë dhe të mos e bësh atë përsëri.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka përkufizuar teuben nasuha në këtë mënyrë: *“Teube nasuha do të thotë që)robi duhet të ndjejë pishmanllëk për mëkatin që ka bërë, t’i kthehet plotësisht Allahut dhe të mos i kthehet përsëri atij mëkati,*

ashtu siç nuk kthehet qumështi në gjë”.

Hasan Basriu (v. 110/728) thotë: “Teube nasuha do të thotë që robi të pendohet për mëkatet dhe të vendosë të mos i përsërisë më ato.” Ndërsa Said b. Musajjeb e vlerëson pendimin si një këshillues, kur thotë: “Me të duhet të këshilloni veten tuaj”.

Gazaliu (v. 505/1111) thotë kështu, kur e përkufizon teuben nasuha: “Ata që bëjnë teube nasuha, pendohen dhe i qëndrojnë atij pendimi derisa të vdesin. Ata i plotësojnë mangësitë që kanë pasur në të kaluarën dhe nuk u shkon ndërmend të kthehen përsëri në mëkat, përveç gabimeve. Ja, kjo është qëndrueshmëria në pendim. Ata që i ndërrojnë mëkatet me sevape dhe garojnë në vepra të mira, janë ata që bëjnë këtë lloj pendimi”.

CILAT JANË KUSHTET E TEUBES NASUHA?

Hz. Ali (r.a.), këto gjëra i ka pranuar si të nevojshme për një pendim të vërtetë:

- Të ndjesh pishmanllëk për mëkatet e bëra në të kaluarën.
- Të bësh kaza farzet e pakryera.
- Të kthesh prapa hakun e të tjerëve.
- Ushtrimi i vetes në ibadete, pasi të pendohesh ashtu siç zhvillohet dhe rritet vetja në mëkat.
- Ta bësh veten të heqë vështirësitë e adhurimit, pas pendimit ashtu siç ndjen shije ajo kur i bën mëkatet.
- Të qash në kohën e pendimit për çdo gjë që ke qeshur në kohën e mëkatit.

Le t'i zgjerojmë edhe pak kushtet e nevojshme për pendimin e sinqertë. Ne jemi të bindur se duhet ta njohim më mirë pendimin, i cili mbart veçorinë e pastruesit më të mirë të mëkateve tona në këtë botë. Për këtë arsye, ne kemi nevojë për më shumë të dhëna, në lidhje me mëkatin për të cilin është bërë pendimi.

B- GJENDJET E NJERIUT QË PENDOHET

1. Gjendja e tij para se të bëjë mëkatin

Përgjithësisht, para pendimit ndodhet një mëkat.

A thua do ta pranojë pendimin e të gjithëve Allahu i Lartësuar, që i fton në pendim robërit e tij mëkatarë? Këtu mund t'i shtojmë pyetjet në këtë mënyrë: A thua pranohet vetëm pendimi i atyre që bëjnë mëkat pa e ditur apo me harresë? Apo pranohet edhe pendimi i atyre që e bëjnë mëkatin duke e ditur, me qëllim dhe duke ndjerë kënaqësi prej tij? Domethënë, a ka ndonjë ndikim në pranimin e pendimit, kur njeriu para se të bëjë mëkatin ta dijë apo jo se është mëkat dhe ta bëjë me qëllim?

Për zgjidhjen e këtij problemi, rrugën do të na e ndriçojë një ajet dhe komentimi i tij. Allahu i Madhëruar, thotë:

“Allahu ua pranon pendimin vetëm atyre që bëjnë ndo-

një të keqe nga injoranca dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin...” (Nisa, 17)

Në ajet është përdorur shprehja **“që bëjnë ndonjë të keqe nga injoranca”**, në lidhje me gjendjen para se të bëhet mëkati. Ajo që kuptohet këtu me konceptin injorancë, është përgjigje për pyetjet e mësipërme.

Burseviu (v.1137/1725) shprehet se injoranca që përmendet këtu do të thotë: “Neglizhencë, shfaqje e injorancës dhe të mosmenduariat se ku të çon kjo ngjarje.” (14) Po ashtu edhe Aliu (v.1270/1854) këtë fjalë e ka kuptuar si hedhje në rrezik të vetes, në mosbindje.

Injorancës që përmendet në ajet është e padrejtë t'i jepet kuptimi padituri, sepse një njeri që e bën diçka pa dituri, në të vërtetë është i pafajshëm. Kështu, ky njeri nuk ka nevojë të pendohet për atë që ka bërë. Injoranca që përmendet në këtë ajet, nuk është padituri, por është një lloj ngutjeje dhe mosbërje llogari në lidhje me faktin se çfarë do të ndodhë më pas dhe se ku të shpie mëkati.

Kur të shikojmë përsëri ajetin pas gjithë këtyre mendimeve në lidhje me konceptin “injorancë”, mund të themi se Allahu Teala e pranon pendimin e mëkatarit, që bën mëkat duke e ditur apo duke mos e ditur, me qëllim apo pa qëllim.

2. Gjendja pas mëkatit

Njeriu që ka bërë mëkat, është si një njeri i helmuar. Ai dëshiron një çast e më parë të shpëtojë nga ky mëkat. Të gjithë e kanë farz të pendohen pas mëkatit. Një njeri që nuk i drejtohet derës së pendimit menjëherë pasi të bëjë mëkat, veçanërisht duhet të pendohet edhe për vonimin e pendimit.

Myslimani shqetësohet, brengoset dhe menjëherë nxiton të pendohet pasi të bëjë një vepër të keqe. Në hadithin fisnik thuhet se shqetësimi pasi të bëhet mëkati, është shenjë e besimit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë: **“Nëse dikush bën një mëkat dhe kjo e shqetëson atë, ai është besimtar.”**

Ndërsa në një hadith tjetër Hz. Pejgamber (a.s.), thotë: **“Besimtari i shikon mëkatet si një mal pranë të cilit është ulur dhe mendon se do t'i bjerë sipër.”**

Megjithëse myslimani duhet të largohet nga të gjitha mëkatet dhe të pendohet pas çdo mëkati që bën, sipas Ehli Sunetit, njeriu mund të pendohet për disa mëkate, ndërkohë që vazhdon të bëjë disa mëkate të tjera. Dijetarët tanë kanë rënë në konsensus se një pendim i bërë në këtë mënyrë është i saktë.

3. Shqetësimi i brendshëm dhe të ndjerët e pishmanllëkut të mëkatarit para se të pendohet

Robi që bën mëkate duhet të vijë te dera e pendimit duke i pohuar mëkatet, duke u përpëlltur nga shqetësimi dhe brenga që i japin mëkatet dhe me një zemër të zgjuar. Shqetësimi për të cilin bëhet fjalë këtu, është një faktor



që e nxit njeriun për t'u penduar.

Pishmanllëku është kushti i parë i pendimit. Kështu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), duke u nisur nga rëndësia e tij, ka thënë: "Pendimi është pishmanllëk." Në këtë hadith fisnik vihet në pah vendi që pishmanllëku ka te pendimi, por aty nuk thuhet se pendimi përbëhet vetëm nga pishmanllëku ose, me një shprehje tjetër, çdo njeri që ndjen pishmanllëk, nuk do të thotë se ka bërë pendim.

Pishmanllëku është shenja e parë dhe përgatitësi i pendimit. Pishmanllëku është filluesi i procesit të pendimit, që mbaron me qetësi shpirtërore. Nganjëherë ndodh e kundërta. Ndikimi i pishmanllëkut nuk shkon më tutje se një dridhje dhe një frikësim. Domethënë, në parim, në fund të pishmanllëkut nuk shfaqet gjithmonë pendimi. Ndjenja e pishmanllëkut është vazhdimi natyral i luftës së brendshme te njeriu, por nuk është qetësi shpirtërore. Ndërsa pendimi nuk është vazhdim i luftës shpirtërore, por është një harmoni dhe paqtim.

4. Vendimi i prerë para pendimit

Pendimi është një pishmanllëk që kërkon vendimin e prerë dhe vendosmërinë për të mos u kthyer më në mëkat. Domethënë, nëse personi që ndjen pishmanllëk për mëkatet e kaluara dëshiron të pendohet, atëherë ai duhet të vendosë në mënyrë të prerë që të mos e bëjë përsëri atë mëkat.

Kur përpqemi të pastrojmë të kaluarën me shfaqjet e pishmanllëkut dhe të lotëve në ditë dhe net të caktuara, absolutisht nuk është e drejtë të vazhdojmë në mëkate, duke menduar se do të pendohemi për to në ditët e shenjta që vijnë më pas. Pishmanllëku duhet të jetë gjithpërfshirës. Një pishmanllëk, në të cilin nuk ka vendim të prerë për të mos iu kthyer mëkateve në të ardhmen, nuk konsiderohet pendim.

Për shkak se pishmanllëku që ndihet si rezultat i një mëkati të bërë dhe vendimi i prerë për të mos u kthyer në mëkat për të cilin është bërë pendimi janë punë të zemrës, këto, me kuptimin e vërtetë të tyre, i di vetëm Allahu Teala. Për këtë arsye, njerëzit nuk mund ta dinë se kush është penduar në të vërtetë dhe sinqerisht.

Njeriu duhet t'i japë fjalën Allahut se nuk do ta bëjë më atë mëkat, në mënyrë që pendimi të jetë i saktë. Gazaliu këtë gjendje e shpjegon me një shembull të tillë: "Ky premtim është si një njeri i sëmurë, që ka vendosur dhe i ka premtuar vetes se nuk do të hajë disa fruta derisa të shërohet, për shkak se i bëjnë dëm. Kjo vendosmëri për atë çast është e fortë. Në të ardhmen, njeriu ndoshta mund ta prishë këtë vendim duke i dëshiruar ato, por përderisa të vendosë që të largohet e të mos i kthehet më atij mëkati, nuk konsiderohet se ka bërë pendim."

5. Gjendja përgjatë kohës që pendohet

Siç e shpjegam edhe më sipër, pendimi nuk është vetëm një punë zemre, një frikësim, një trembje dhe një

derdhje loti, pra, një pishmanllëk abstrakt. Domethënë, pendimi nuk përbëhet prej disa ndjenjave të brendshme. Sikundër kësaj, pendimi është një proces ku ndërtohen disa veprime mbi ndjenjat e brendshme. Për shembull, ai që pendohet duhet t'i lërë mëkatet që Allahu i ka ndaluar dhe duhet të zbatojë urdhrat e Tij sipas mundësisë që ka.

Ai nuk duhet të vazhdojë më në atë mëkat. Një individ që vazhdon të bëjë mëkat, edhe pse është penduar për to, do të thotë se ai ka rënë në kontradiktë me veten. Një sjellje e tillë nuk përputhet me aktin e pishmanllëkut dhe me premtimin e individit se nuk do t'i kthehet mëkati. Robi duhet t'i lërë menjëherë ato mëkate për të cilat është penduar.

Kjo është një shenjë e pishmanllëkut dhe e vendosmërisë për të mos e përsëritur të njëjtin mëkat. Nëse mëkati, për të cilin robi ka bërë pendim është dhunim i hakut të një njeriu, menjëherë duhet të gjendet zotëruesi i atij haku, t'i jepet haku dhe t'i kërkohet hallallëk.

6. Gjendja pas pendimit

Një njeri, që jeton me ndjenjën e sprovimit, vazhdimisht dëshiron të lartësohet te Allahu Teala. Çdo njeri ka gradën e tij te Allahu, sipas adhurimit që ka bërë.

Njeriu që pendohet, duhet ta rregullojë gjendjen e tij pas pendimit dhe në vend të të këqijave që ka bërë, duhet të përpqet të vendosë të mira. Kjo gjendje shprehet edhe në ajetet që bëjnë fjalë për pendimin.

Siç u tha edhe më sipër, njëri prej kushteve të pendimit është vendimi i prerë për të mos e përsëritur mëkatin për të cilin është bërë pendim. Disa prej dijetarëve të Islamit e kanë pranuar si kusht të pendimit mosrikthimin në mëkatin për të cilin është bërë teuve. Sipas këtij mendimi, nëse njeriu e bën përsëri të njëjtin mëkat për të cilin është penduar, pendimi i mëparshëm nuk është i saktë.

Ndërsa, sipas shumicës së dijetarëve, mospërsëritja e mëkati për të cilin është bërë pendimi, nuk është prej kushteve të saktësisë së pendimit, por dhënia e vendimit të prerë për mosbërjen e të njëjtit mëkat gjatë pendimit, është prej kushteve të tij. Nëse njeriu ka vendosur të mos i kthehet mëkati për të cilin ka bërë pendim, por përsëri e bën atë, pendimi i mëparshëm nuk priset. Vendosmëria e penduesit në pendim nuk ka lidhje me saktësinë e pendimit, por me përsosmërinë dhe dobinë e pendimit.

Tani le të shikojmë mëkatet për të cilat bëhet pendim dhe se si duhet të pendohemi prej tyre.

C- VEÇORITË E MËKATIT PËR TË CILIN BËHET PENDIM

1. Si mund të pendohemi për mëkatet në lidhje me hakun e Allahut?

Ai që pendohet, për shkak se ka bërë ato gjëra që nuk duhej t'i bënte, tani duhet t'i lërë ato. Si shembull për këtë, mund të japim alkoolin dhe bixhozin.

Ai që dëshiron të pendohet për mëkatet në lidhje me hakun e Allahut, duhet të bëhet pishman për mëkatin që ka bërë dhe të njëjtin mëkat nuk duhet ta bëjë në atë çast. Nëse pendohet, për shkak se nuk ka zbatuar ndonjë urdhrë të fesë islame, atëherë ai duhet ta zbatojë atë. Për shembull, ai që pendohet për namazet që nuk ka falur, pas pendimit duhet të fillojë t'i falë namazet.

Ai që pendohet, për shkak se ka bërë ato gjëra që nuk duhej t'i bënte, tani duhet t'i lërë ato. Si shembull për këtë, mund të japim alkoolin dhe bixhozin.

Nëse ai që pendohet ka mundësi t'i bëjë kaza urdhrat që nuk i ka zbatuar, si namazin, agjërimin, zekatin etj., duhet të përpiqet t'i bëjë kaza. Domethënë, robi, në kuptim të përgjithshëm, duhet të largohet nga kundërshtimi i urdhrave hyjnorë në të cilin gjendej para pendimit dhe t'i drejtohet Allahut Teala. Në vend të të këqijave që ka bërë më parë, tashmë duhet të bëjë vepra të mira.

Njeriu që pendohet prej këtyre mëkateve, nuk është e nevojshme t'ua tregojë të tjerëve. Faktikisht, ata që i kanë bërë këto mëkate dhe ata që i kanë parë, më mirë është të mos ua tregojnë njerëzve të tjerë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Ai që bën një vepër të keqe, le ta mbulojë ashtu siç e mbulon Allahu." Në shpjegimin e hadithit thuhet se këtu synohet mëkati në lidhje me hakun e Allahut Teala. Edhe në një hadith tjetër, atij që ia mbulon vëllait në fe mëkatin e bërë në lidhje me hakun e Allahut, i jepet përgëzimi se edhe Allahu do t'ia mbulojë mëkatet atij Ditën e Kiametit.

2. Si mund të pendohemi për mëkatet e bëra në lidhje me hakun e robit?

Dhunimi i njëres prej të drejtave të njerëzve është mëkat që ka të bëjë me hakun e robit. Para se të kalojmë në shpjegimin se si duhet të pendohemi prej këtyre lloj mëkatesh, mendojmë se duhet të shtjellojmë diçka.

Një mysliman, siç duhet t'i respektojë të gjitha të drejtat e vëllezërve të tij dhe siç është haram dhunimi i tyre, po ashtu duhet të respektojë edhe të drejtat e njerëzve që u përkasin feve të tjera, sepse myslimani do të ndëshkohet në ahiret edhe për dhunimin e të drejtave të jomuslimanëve që jetojnë në vendin islam.

Kushti i parë për pendimin prej hakut të robit është kthimi i hakut te zotëruesi i tij, që i është marrë me forcë. Nëse haku i robit është prej llojit të mallrave, atëherë do të përballet me këto:

a. Nëse malli i marrë akoma gjendet te marrësi dhe zotëruesi i tij dihet, atëherë duhet kthyer pas. Këtu nuk është e drejtë të fshihet faji dhe të bëhet pendim.

b. Nëse malli i vjedhur gjendet te hajduti, por nuk dihet zotëruesi i tij, ky mall duhet të jepet sadaka.

c. Nëse dikush ka ndonjë mall që e ka marrë padrejtësisht në vitet e mëparshme, por nuk dihet zotëruesi i

mallit, atëherë këtë mall e jep sadaka.

d. Një njeri që nuk e di se sa mall haram ka në mallin e tij, ndan një pjesë sipas asaj që mendon se është e saktë dhe e shpërndan atë me njetin për të nxjerrë hakun e robit që e ka pas marrë më parë.

e. Nëse malli që ka marrë fajtori është prej llojit që i caktohet vlera dhe marrësi i padrejtë ka mundësi ta paguajë, atëherë vlera e atij duhet t'i jepet zotëruesit të mallit. Nëse nuk ka mundësi për këtë, e bën njet për ta dhënë kur të ketë mundësi. Nëse përpiqet për t'ia dhënë mallin zotëruesit të tij sipas mundësisë që ka, por nuk ia arrin dot, shpresohet që Allahu Teala ta falë atë.

Nëse haku që e shtyn njeriun të pendohet është në lidhje me namusin dhe personalitetin e dikujt, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me ato gjëra që duhet të bëhen. Për shembull, si duhet të bëhet pendimi për përgojimin e një njeriu, për shpifje me zina, për nënvlerësim në shoqëri dhe për dëshmi të rreme kundër dikujt në gjykatë?

A duhet t'ia tregojë mëkatin të zotit të së drejtës, ai njeri që bën mëkate të tilla dhe dëshiron të pendohet? Apo është e mjaftueshme të kërkojë falje nga Allahu pa ua treguar këtë gjë zotëruesve të së drejtës? Ndërsa një dimension tjetër i kësaj çështjeje është: Nëse do të lajmërohen për këtë zotëruesit e hakut, ato që janë bërë duhet të thuhet privatisht apo në mënyrë joprivate? Tani le t'i shikojmë këto:

a. Ahmed b. Hanbeli (v.241/855) ka dy transmetime në lidhje me nevojshmërinë e tregimit të fajit atij që i është bërë shpifje, nga ana e atij që dëshiron të pendohet për fajin e shpifjes së zinasë. Pendimi për mëkatet, që kanë të bëjnë me personalitetin e njeriut si përgojimi, tallja dhe ofendimi, është krahasuar me dispozitën në lidhje me pendimin që bëhet nga kadhifi (shpifësi).

b. Imamët e tre medhhebeve të tjera dhe Taberiu (v. 310/922) kanë thënë se për këto mëkate është kusht t'u tregohen atyre të cilëve u është dhunuar e drejta dhe të kërkohet hallallëk prej tyre. Argumentat e tyre në lidhje me këtë, janë:

1. Këta janë hak i robit, kështu që prej tyre mund të shpëtohet vetëm duke marrë hallallëk prej atyre që u janë bërë.

2. Shpëtimi nga një hak i paditur nuk është i saktë. Zotëruesi duhet ta dijë masën e hakut të tij. Ndoshta mund ta falë, ndoshta nuk e fal, për shkak se i duket shumë.

3. Në hadithin fisnik, thuhet: "Kush ka ndonjë hak në lidhje me pasurinë dhe namusin e dikujt, le të marrë hallallëk nga ai para se të vijë Kiameti." Ky hadith është argument se duhet marrë hallallëk nga zotëruesi i atij haku.

Edhe Gazaliu pranon këtë mendim. Nëse ai të cilit i është hyrë në hak në këtë lloj mënyre ka vdekur, rekomandohet

Kur përpiqemi të pastrojmë të kaluarën me shfaqjet e pishmanllëkut dhe të lotëve në ditë dhe net të caktuara, absolutisht nuk është e drejtë të vazhdojmë në mëkate, duke menduar se do të pendohemi për to në ditët e shenjta që vijnë më pas.

të bëhet ndonjë mirësi për t'i shkuar sevapi atij.

c. Mëkatet në lidhje me namusin dhe nderin nuk është e nevojshme t'i tregohen të zotit. Për pendimin ndaj këtyre, mjafton të ndjesh pishmanllëk duke iu drejtuar Allahut. Në ditët në vijim, ky njeri duhet të thotë fjalë të mira në lidhje me nderin dhe namusin e atij që e ka ofenduar dhe duhet t'u tregojë të tjerëve se ai është njeri me namus e i ndershëm.

D- A ËSHTË I SIGURTË PRANIMI I PENDIMEVE?

Pendimi i bërë duke zbatuar kushtet që shtjelluam më sipër, patjetër që pranohet te Allahu Teala, sepse në ajetin fisnik, Allahu i Lartësuar është shprehur qartë se do t'i pranojë pendimet e robërve të Tij: **"Ai e pranon pendimin e robërve, i fal të këqijat dhe i di ato që veproni ju..."** *Falja e mëkatit dhe pranimi i pendimit janë nga Allahu..."*

Nga ana tjetër, duke vendosur kushtin e pendimit për shpëtimin e robërve, Allahu i Madhëruar ka thënë: **"O ju që keni besuar! Pendohuni të gjithë së bashku ndaj Allahut, në mënyrë që të shpëtoni."**

Allahu i Madhëruar i lavdëron veçanërisht robërit që pendohen dhe i do ata që trokasin në derën e pendimit. Ky është një argument se pendimet pranohen.

Allahu Teala dëshiron për robërit e Tij, jo ndëshkimin në xhehenem, por pastrimin nga mëkatet dhe papastërtitë shpirtërore me pendim. Me pendimin që bëjnë, njerëzit pastrohen nga çdo lloj mëkati dhe fitojnë dashurinë e Allahut.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e tregon me një shembull gëzimim që ndjen Allahu Teala kundrejt pendimit të robërve të Tij:

"Gëzimi që ndjen Allahu ndaj pendimit të robit i ngjan kësaj: 'Një njeri ngarkoi ushqimin dhe enën e ujit mbi deve dhe doli në udhëtim. Së fundi, kur arriti në një vend të thatë, i erdhi gjumi. Zbriti nga deveja dhe u shtri nën hijen e një peme. Kur u zgjua, pa se deveja kishte humbur. Vrapoi nëpër kodra të ndryshme, por nuk e gjeti. Pasi u lodh, shkoi nën hijen e pemës ku kishte pushuar më parë."

Ai e kishte prerë shpresën nga deveja. Ndërkohë që po qëndronte i pashpresë, befas shikon se deveja po qëndronte pranë tij. E kap për litari dhe i hutuar nga gëzimi, thotë: 'O Zot! Ti je rob i im, ndërsa unë jam zoti yt. Kështu, gëzimi i Allahut kur pendohen robërit, është më i madh se gëzimi i këtij njeriu."

Ndërsa, në një hadith tjetër, thotë: **"Allahu e hap dorën natën, për të pranuar pendimin e atij që ka bërë mëkat ditën dhe e hap dorën ditën për të pranuar pendimin e atij që ka bërë mëkat natën. Allahu e vazhdon këtë derisa të lindë dielli nga perëndimi."**

Atëherë, është e pamundur që një pendim, i cili është bërë pa asnjë mangësi në kushtet e tij, të jetë i papranueshëm. Për fat të keq, shikojmë disa kuadro fetarë, që nuk e kanë studiuar mirë këtë temë, të cilët i përzënë disa myslimanë mëkatarë nga dera e pendimit, duke vepruar në emër të Allahut. Ndërkohë që, asnjë mëkatar i nuk i është mbyllur dera e pendimit.

Gazaliu, që ishte prej dijetarëve të mëdhenj të Islamit, ka thënë se nuk duhet të ketë dyshim për pranimin e një pendimi të saktë. Pranimin e pendimit ai e shikon si një rezultat të domosdoshëm të pendimit. Gazaliu thotë: **"Siç nuk ka dyshim se është pastruar rroba e atij që e lan atë me sapun, po ashtu nuk ka dyshim se Allahu e pranon pendimin e penduesit."** Ai që pendohet për mëkatet e bërë, është pastruar nga papastërtia dhe në ahiret nuk do të merret në llogari për mëkatet që është penduar. Ndërsa, për mëkatet e tjera do të merret në llogari.

Pas këtyre shpjegimeve, mund të themi: Edhe pse duhet të dyshojmë në saktësinë e pendimit tonë, ne nuk duhet të dyshojmë në pranimin e pendimit nga Allahu, nëse e kemi bërë atë sipas kushteve që kërkohen, sepse Allahu i Madhëruar ka premtuar se do ta pranojë pendimin e çdo robi mëkatar që pendohet sinqerisht. Allahu kurrë nuk e thyen premtimin e dhënë.

PËRFUNDIM

Pendimi që është një pishmanllëk i lidhur më të kaluarën, me të tashmen dhe me të ardhmen, është njëra prej rrugëve të pastrimit nga mëkatet për njeriun besimtar. Rreziku për të bërë gabim dhe për të bërë mëkat është shumë i lartë te njeriu. Për këtë arsye, njeriu nuk mund t'ia dalë mbanë pa pendim. Njeriu ka nevojë për pendim, aq sa ka nevojë për ajër dhe ujë.

Pendimi ka një ndikim të padiskutueshëm për pastrimin e mëkateve. Kur ta bëjmë atë me kushtet e nevojshme, mund të përfitojmë prej tij. Në pendimin që do të pranohet nga Allahu Teala duhet të gjenden këto elementë: të ndjesh pishmanllëk për të kaluarën, të kompensosh hakun që duhet kompensuar, të bësh kaza ibadetet e lëna dhe t'i kërkosh falje Allahut, duke vendosur në mënyrë kategorike se nuk do t'i kthehesh më të njëjtit mëkat. Kur të kryhen këto kushte, nuk ka pendim që të mos pranohet dhe mëkatar që të refuzohet nga Allahu Teala.

Robi mëkatar nuk ka nevojë për ndonjë lutje të veçantë për t'u penduar, ndonjë kohë të caktuar, ndonjë vend të shenjtë apo për ndonjë ndërmjetës (hoxhë, imam, shejh), që të ndërmjetësojë te Allahu. Njeriu duhet të pendohet para se të japë frymën e fundit në një vend dhe gjuhë që dëshiron.

Njeriu duhet të përpiqet të mos kthehet përsëri në të njëjtin mëkat pasi të jetë penduar, por nuk duhet të harrojmë se kthimi në të njëjtin mëkat nuk e prish pendimin e bërë në të kaluarën. Ai duhet të pendohet përsëri për këtë mëkat dhe pastaj duhet të jetë i vendosur kategorikisht që të mos bëjë mëkat përsëri. Dera ku mund të kërkojmë falje për shkak të mëkateve që kemi bërë pas pendimit, përsëri është dera e Allahut. Në Islam askush nuk mund t'i falë mëkatet, përveç Allahut Teala. Për këtë arsye, asnjë derë nuk trokitet për pendim, përveç derës së Zotit.

Nëse i kërkojmë dikujt tjetër të na falë mëkatet përveç Allahut, atëherë kemi rënë në shirk. Shirku është mëkati më i madh. Nëse pendohemi për mëkatet e bërë në lidhje me hakun e robit, atëherë, patjetër duhet të gjejmë të zotin e hakut, t'ia kthejmë hakun dhe t'i kërkojmë hallallëk.



HASANI (R.A.) DHE NJË SHEMBULL

Adem Saraç

Hasani, (r.a.), ishte një bukuri...

Husejni, (r.a.), ishte një tjetër bukuri...

Njëri ishte një perlë e veçantë e edukatës dhe moralit, tjetri edhe më i veçantë...

Ata ishin nipërit e Pejgamberit (a.s.)...

Ata ishin drita e Pejgamberit të dritës, trëndafilat e nënës trëndafil...

Ata ishin të dashurit e gjithkujt...

Hasani (r.a.), pas gjithë atyre ngjarjeve që u zhvilluan, doli në krye të popullit si khalif, duke treguar nivelin më të lartë të mëshirës dhe dhembshurisë në mënyrë të vazhdueshme...

Sjelljet dhe veprat e tij në këtë ditë, ishin bukuri të trashëguara prej gjyshit të tij pejgamber. Deri tani, ai i kishte zbatuar në jetën e tij të gjitha ato që kishte parë dhe mësuar prej gjyshit të tij pejgamber. Ndërsa tani e tutje, këto do t'i zbatonte dhe në drejtimin e shtetit.¹

Një ditë...

Fëmija i djeshëm, Hasani (r.a.), u bë prijësi i drejtë i të sotmes. Kur ai ishte në krye të popullit si khalife, i erdhi një burrë i mjerë. Një i shtypur, të cilit i ishte bërë padrejtësi dhe kërkonte të merrte të drejtën e tij prej të padrejtës. Për këtë, i kishte sjellë khalifes edhe një letër (kërkesë).

- Për shkak se më vjen zor të dal para jush dhe të them, ankesën time e kam shkruar në këtë letër! Lexojeni dhe më ndihmoni!

Hasani (r.a.), e mori letrën prej burrit i cili qëndronte përballë tij kokulur e i mjerë dhe e qetësoi...

-Ti shko tani! Ankesa jote do të shqyrtohet dhe problemi yt do të zgjidhet, inshAllah!

Burri i mjerë u largua prej tij duke pëshpëritur disa lutje.

Atë moment, një nga drejtuesit që gjendeshin aty, pyet me kureshtje!..

- O nipi i Rasulullahut (a.s.)! O drita e syve tanë! O kurora e kokave tona! Nuk keni vepruar ndonjëherë kështu! Përse nuk e lexuat letrën e atij njeriu?

- Unë e mora për ta lexuar dhe për t'ia zgjidhur problemin.

- Po, por atë të shkretin e dërguat pa e lexuar letrën!

- Zemra ime nuk mund ta duronte që ai njeri i mjerë të turpërohej edhe më tepër para meje!

- Mirë, po a nuk do t'i jepni një zgjidhje problemit të tij?

- A nuk është një nga detyrat e mia t'u bëj derman halleve të hallexhinjve?

- Po atëherë pse e dërguat atë njeri? A nuk do të ishte më mirë ta dëgjoni? Të paktën ta kishit mbajtur pranë derisa të lexoni letrën e tij.

- Allahu Ekber! Ç'është kjo krekosje kështu!

- Estagfirullah! Madhështia i takon Allahut! Zemra ime nuk mund ta duronte që dinjiteti i atij njeriu të ulej para meje!

- Allahu Ekber!

- Unë u frikësova prej kësaj përgjegjësie dhe ende kam frikë...

- Allahu Ekber!

Ja pra, për këto ditë janë përgatitur këta trëndafilat të zgjedhur të xhenetit...

Sepse ata ishin perla të mirësjelljes, moralit dhe edukatës...

Vallë, çfarë kemi ne prej këtyre njerëzve të bekuar, të cilët Pejgamberi ynë (a.s.), i ka përkufizuar si **"të rinjtë e xhenetit"** dhe i ka lavdëruar?

Me dëshirën për t'u bërë shembull i shembujve që edukoi më shembullori i shembullorëve!

1. -Shih. Ibn-i Abd-i Rabbih, **Ikdu'l-Ferid**, v. 2, fq. 220.



Sulbe të zgjedhura

Naim Drljaj

KU GJENDET Lumturia?

Lumturia është rrisht prej Zotit, prandaj le ta lusim Atë të na bëjë të lumtur. Vetëm Zoti e ka në dorë lumturinë tonë. Allahu (xh.sh.), thotë: “Ai të bën të qeshësh dhe të qash” (Nexhm, 43)

Lumturia është abstrakte. Ajo nuk shihet me sy, nuk matet me metër, nuk ruhet në depo dhe nuk mund të blihet me asnjë vlerë monetare. Lumturia është ndjenja që përjeton thellë në shpirt njeriu. Ajo është ndërgjegje e qetë, zemër e pastër, lehtësimi dhe prehja që përjetohet në jetën e përditshme. *Lumturinë e gjejmë brenda njeriut* dhe nuk mund të fitohet me dhunë.

Dhimbjet dhe mërzia, stresi dhe ankthi, preokupimet dhe shqetësimet, problemet dhe vuajtjet shkaktojnë trishtim dhe humbje shprese tek njeriu. Për fat të keq, shumë njerëz mendojnë se e gjithë jeta është e mbushur me probleme të tilla. Sa herë që flitet mbi lumturinë në këtë botë, një numër jo i vogël njerëzish mund të thonë: “E ku ka lumturi në këtë botë? Unë këtë e them nga përvoja ime” dhe vazhdojnë të rrëfejnë hallet dhe problemet e tyre.

E vërteta është se lumturia e plotë dhe e përsosur gjendet vetëm në xhenet. Po përse u dashka që lumturinë relative t’ia mohojmë vetes në këtë botë? Këtë ide e përforcon vetë Zoti në një ajet të Kuranit, ku thotë:

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që ai të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira që ka bërë.” (Nahl, 97)

Në këtë ajet, Zoti ka vënë theksin edhe tek femrat, pasi shumë prej tyre, duke qenë më të dobëta emocionalisht sesa meshkujt, e shohin jetën vetëm zi. Shumë prej tyre vuajnë, shumë prej tyre kanë probleme në jetën bashkëshortore, dhunohen e divorcohen dhe mendojnë se vuajtjet nuk do t’u ndahen. Ajeti i mësipërm nuk flet për xhenetin, por për jetën e kësaj bote. Shohim se nuk thuhet se kjo jetë nuk do të ketë vështirësi. Jo, ajo ka problemet dhe vështirësitë e veta, por në

qoftë se njeriu bën vepra të mira, duke qenë besimtar, atëherë ai do të kalojë një jetë të bukur dhe të qetë në këtë botë.

Ibn Kajjim Xhevzi ka thënë: “Lumturia e myslimanit gjendet në tre vende:

1. Kur njeriu merr një dhuratë dhe është falënderues.
2. Kur Allahu e sprovon me një provë të rëndë dhe ai bën durim.
3. Kur njeriu bën gjynahe dhe pastaj kërkon falje.

Surja Inshirah ka zbritur në Meke dhe ka 8 ajete. Brenda kësaj sureje gjenden 10 bazat e lumturisë.

1. Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharorin (për të pranuar besimin).

Allahu (xh.sh.), në këtë ajet nuk ka përdorur fjalën “*kalb*”, por ka përdorë fjalën “*sadr*” (kraharor). Sepse kraharori është vendi ku shejtani hedh dyshimet e tij. Allahu (xh.sh.), thotë:

“Ai që hedh dyshime në kraharoret e njerëzve”. (Nas, 5)

Allahu ia hap kraharorin (zembrën) për (të pranuar) Islamin njeriut që dëshiron ta udhëzojë... (En>âm, 125)

A. Nga ky ajet kuptohet se lumturia vjen prej Allahut. Allahu (xh.sh.), thotë: “Ai të bën të qeshësh dhe të qash” (Nexhm, 43)

B. Lumturia gjendet dhe zë vend në zemër. Allahu (xh.sh.), thotë:

“Atyre që besojnë u qetësohen zemrat, kur përmendet Allahu. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Rad, 28)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Në trupin e njeriut është një organ, i cili, nëse është në rregull, i gjithë trupi do të jetë në rregull dhe, nëse është i prishur, i gjithë trupi do të jetë i prishur. Ky organ është zemra” (Buhariu, Muslimi)



Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kur robi kryen një gjynah, i bëhet në zemrën e tij një pikë e zeze, nëse ai pendohet dhe kërkon falje, i hiqet ajo pikë prej zemrës së tij e, nëse ai e vepron përsëri kthehet e zeza deri sa ia mbulon zemrën. Allahu i lartësuar thotë: “...Por të këqijat që i punuan, zemrat e tyre ua mbuluan.” (Mutafifin, 14). (Nesai, Tirmidhi)

2. dhe ta hoqëm barrën.

3. e cila të rëndonte mbi kurriz,

Sipas Tabariut, ajeti ka këtë kuptim: “A nuk të kemi pastruar ty nga çdo gjynah?” Allahu t’i ka falur ty gabimet e mëparshme dhe të ardhshme... (Fet’h, 2)

Gjynahet e pengojnë njeriun të shohë dritën e lumturisë. Gjynahet e çojnë njeriun drejt ankthit dhe pesimizmit, ndërsa pendimi e çon njeriun drejt lumturisë.

4. dhe ta ngritëm lart emrin?

Allahu (xh.sh.), e lartësoi emrin e Pejgamberit (a.s.), prandaj çdo herë kur përmendet Allahu (xh.sh.), me Të përmendet edhe i Dërguari i Tij e kjo ndodh kur deklarohet dëshminë e Islamit, kur thërrasim ezanin dhe gjatë faljes së namazit etj.

Dijetarët e Islamit kanë thënë se prej gjëravë që e bëjnë njeriun të lumtur në këtë botë, është t’i dalë nami për mirë dhe të njihet për mirë në popull.

5. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!

6. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!

Prej mrekullive të Kuranit është se përmendja e vështirësisë në të dy ajetet është bërë në trajtën e shquar dhe se pas saj përmendja e lehtësimit në të dyja rastet ka ardhur në trajtën e pashquar. Në gjuhën arabe, sipas rregullave të saj gjuhësore, nëse dy herë radhazi përmendet një gjë në trajtën e shquar nënkuptohet ajo që thuhet. Kjo nuk vlen anasjelltas, pra kur një send përmendet dy apo më shumë herë në trajtën e pashquar.

Në rastin e dytë nënkuptohet diçka tjetër, diçka e re, siç është rasti me përmendjen e “lehtësimit”. Me një fjalë “vështirësia” e përmendur në të dy rastet nënkupton vetëm një vështirësi të kësaj jete, ndërsa “lehtësimi” i përmendur në të dy rastet nënkupton lehtësim në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

7. Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim)

E nëse ti lirohesh nga një punë apo adhurim, përsëri përkushtoj Zotit tënd. Njeriu nuk duhet të lërë hapësirë në kohën e tij, por ta mbushë atë me adhurime dhe me aktivitete të dobishme. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Shumica e njerëzve nuk ua dinë vlerën dy begative, ato janë: shëndeti dhe koha e lirë.” (Buhari, Muslim)

8. vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu! Zoti na tregon se duhet ta mbushim kohën e lirë duke bërë adhurime. Ibn Tejmije ka thënë: “Kush dëshiron lumturinë e përgjeshme, atëherë të mos heqë dorë nga adhurimet.

Allahu e ka mbyllur këtë sure, duke na kujtuar që duhet t’i shtojmë lutjet tona sa më shumë. Zoti (xh.sh.), ka thënë: “Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! (Gafir, 60)

1. Lumturia vjen prej Allahut.
2. Lumturia është në zemër.
3. Pastrimi nga gjynahet.
4. Përmendja për mirë nga njerëzit.
5. Allahu me vështirësinë ka vendosur edhe lehtësimin.
6. Lehtësimi është me vështirësinë, jo pas vështirësisë.
7. Me çdo vështirësi ka dy lehtësime.
8. Mos e lër kohën e lirë që ke të shkojës, por shfrytëzoje atë me punë të mira dhe adhurime.
9. Bëj adhurim sa më shumë.
10. Duaja dhe lutja.

RUAJTJA E SHËNETIT MENDOR



Shkencëtarët e kanë ditur shumë vite më parë se truri dhe qelizat e sistemit nervor, ndryshe nga qelizat e tjera të trupit, nuk rigjenerohen. Numri i tyre nuk rritet me kalimin e kohës e as nuk ulet dhe nëse disa prej tyre vdesin e nuk zëvendësohen. Megjithatë mos u frikësoni nga ky informacion. Neuronet (qelizat nervore) janë të ndryshme plotësisht nga qelizat e tjera të trupit. Ato nuk përkeqësohen nga përdorimi i tepërt, përkundrazi sa më tepër që e ushtron trurin, aq më i mprehtë bëhet. Prej lindjes deri në moshën 2 vjeçare, truri i njeriut zhvillohet dhe gjeneron qeliza të reja, për këtë arsye pediatrikët theksojnë rëndësinë e yndyrnave esenciale në dietën e foshnjës, pasi ato janë themel i qelizave nervore.

Pas moshës 2 vjeç truri zhvillohet plotësisht dhe neuronet që i posedoni tani janë ato që do t'i

përdorni për pjesën e mbetur të jetës. Sa më tepër të angazhohemi në aktivitet intelektual, sa më shumë të mësojmë e të marrim dituri, aq më i fortë do të jetë stimuli i neuroneve për të ndërtuar më tepër lidhje mes tyre. Dhehebiu ka thënë: "Çdo organ forcohet dhe bëhet aktiv kur ushtrohet rregullisht, njësoj është edhe mendja. Nëse dëshiron ta mprehtësosh memorien tënde dhe të rritësh intelektin, shtojë të mësuarit, memorizojë Kuranin, vazhdo të mendosh dhe të meditosh dhe këmbëngul në përkujtimin e Allahut (dhikër)".

Mbaje trurin aktiv tërë kohën. Truri yt ka nevojë të ketë sfida të vazhdueshme, pa pyetur për moshën tënde. Ai ka nevojë për ide të reja dhe përvoja të freskëta. Por si mund ta ruajmë ne shëndetin e trurit?

KA NËNTË MËNYRA PËR TA RUAJTUR SHËNETIN E TRURIT:

1. Kurrë mos u ndal nga të lexuarit. Sipas Dr. Richard Restak në librin e tij "Older and Wiser", arsimimi është faktori më i rëndësishëm në arritjen e potencialit më të madh të trurit. Në Kuran Allahu e udhëzoi të Dërguarin a.s.: "... thuaj: 'Zoti im, shtoma diturinë!'" (Sure Taha, 114). Bëje shprehi të lexosh së paku njëzet minuta çdo ditë. Lexo nga të gjitha fushat, zgjeroje diturinë dhe zbatoje në jetën e përditshme.

2. Kërko sfida mendore. Studimet tregojnë se koha e tepërt e lirë është njëri prej faktorëve që lidhet me dementinë. Truri ka nevojë për sfida të vazhdueshme dhe gjëra të reja që të qëndrojnë i shëndetshëm.

3. Bëhu fizikisht aktiv. Një thënie e vjetër thotë: "Mendje e shëndo-

shë në trup të shëndoshë." Rëndësia e ushtrimeve është e theksuar dhe muslimanët nxiten t'u mësojnë fëmijëve të tyre sporte të ndryshme. "Mësoju fëmijëve tuaj shigjetarinë, notin dhe kalërimin." Sportet e ndryshme dhe aktivitetet e ndryshme fizike si vaprimi, çiklizmi, noti etj. njihen se përmirësojnë imazhin e kolesterolit dhe ulin shtypjen e gjakut. Kjo çon në një zemër të shëndetshme. Kështu zemra juaj do të pompojë më shumë gjak me efikasitet të madh në të gjitha pjesët e trupit duke përfshirë trurin.

4. Ha ushqime të shëndetshme dhe shmangu nga shprehitë e dëmshme. T'i dërgosh ushqim të mirë trurit, duhet ta ushqesh në mënyrë të vazhdueshme të gjithë trupin. Hapi i parë në planin e të ushqyerit optimal të trurit tonë është të ndjekësh një regjim të shëndetshëm të ngrënies, që është konform piramidës së ushqimeve. Zgjidh ushqim bazik nga grupi i karbohidrateve komplekse. Ha shumë fruta dhe perime të freskëta, zvogëlojë mishin e kuq dhe në vend të tij konsumo peshk dhe fasule si burim tjetër të proteinave, pi qumësht, zvogëlo përdorimin e yndyrnave dhe të ëmbëlsirave. Mbye mend rregullin hyjnor: "...hani e pini e mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që shpërdorojnë." (Sure Araf, 31). Këto fjalë të shenjta janë të dobishme për shëndetin e trurit tonë. Nëse hamë një ushqim të balancuar pa kalori shtesë, ne do t'i marrim ushqyesit e nevojshëm dhe do t'i ruajmë funksionet e rinisë dhe vitalitetin e trupave tanë për një kohë më të gjatë.

5. Bëj gjumë të mirë natën. Askush nuk mund ta mohojë se gjumi i pamjaftueshëm e dëmton performacën e trurit tuaj. Gjumi i restauron, i plotëson dhe i rindërtton pjesët e trurit dhe të trupit, të cilat mund të jenë lodhur nga një

ditë e gjatë. Shkencëtarët besojnë se gjumi i jep qelizave të trurit kohë të përshtatshme për ta rigjeneruar dhe rikthyer energjinë e tyre. Një model i rregullt i gjumit është sidomos për fëmijët dhe adoleshentët, sepse hormonet e rritjes sekretohen gjatë periudhës së gjumit të thellë.

6. Mbye një gjendje pozitive të mendjes. Nëse e mendojmë veten tonë si të paaftë për gjëra të caktuara, vetëdija jonë e pranon këtë ide dhe ne përfundojmë në një gjendje ku nuk mund të bëjmë diçka vetëm sepse mendojmë se nuk mund ta bëjmë atë. Vetëvlerësimi i lartë, besimi në vetvete, në potencialin tonë dhe në realizimin e qëllimeve tona është esencial në mbajtjen e një truri të shëndetshëm dhe në një gjendje pozitive të mendjes. I Dërguari (a.s.) na ka këshilluar: "Besimtari i fortë është më i dashur tek Allahu sesa besimtari i dobët, përderisa nga të dy ka dobi".

7. Ushtrroje të menduarit e thellë. Nuk ka vend të veçantë ose kusht të domosdoshëm për të menduar. Ju mund të mendoni gjatë shëtitjes, gatimit, ngrënies, gjatë relaksimit në shtratë etj. Kurani na nxit t'i përdorim të gjitha shqisat për të kuptuar dhe besuar të vërtetën e krijimit tonë dhe krijimit të tokës dhe universit. Në shumë ajete kuranore Allahu i referohet atyre që përdorin mendjet e tyre për të menduar thellë, si njerëz që kuptojnë ose që janë inteligjentë (Sure Sad, 29)

8. Aktiviteti shoqëror. Jeta familjare është e një rëndësie të madhe në Islam dhe synon ndërtimin e një jete familjare të fortë dhe të qëndrueshme. Shkenca na tregon se një mjedis i bukur, përkrahja nga familja dhe miqtë, kënaqja me jetën dhe standartet e forta etike përbëjnë një faktor të rëndësishëm në sigurimin e një

performance të shëndetshme të trurit. Studimet tregojnë se një mjedis i lumtur familjar rrit fëmijë të shëndoshë, inteligjent dhe produktiv. Cilësia e kujdesit interaktiv që u jepet fëmijëve në moshë të hershme dhe koha e kaluar në biseda, leximi i tregimeve dhe loja me ta, ka rol kyç në zhvillimin e trurit të tyre. Besohet se efekti është jetëgjatë, që nënkuptin se tri vitet e para të jetës së fëmijës mund të ndikojnë në forcën e trurit të tij për pjesën tjetër të jetës. Kjo natyrisht vë përgjegjësi te nëna dhe thekson rolin e saj të rëndësishëm në rritjen e të rinjve me mendje të shëndetshme.

9. Zvogëloje stresin. Hulumtimet tregojnë se stresi i vazhdueshëm i rrit nivelet e kortikosteroidëve dhe të adrenalines në gjak, të cilat kanë efekte negative në lidhjet neurale, duke parandaluar transferimin aktiv të informatave. Gjithashtu stresi rrit edhe prodhimin e radikaleve të lira, të cilat i sulmojnë qelizat e trupit, duke përfshirë edhe neuronet. Kultivoje besimin tënd, shndërroi frustimet në sfida dhe zemërimin në pranim të gjendjes. Mënyra jote e shikimit të problemeve të tua mund t'ju ndihmojë të gjeneroni më tepër energji dhe entuziazëm. Praktikoje relaksim për të ribalancuar sistemin tënd nervor dhe zvogëloje stresin. Dijetari Ibn Kajjime el Xheuzije ka thënë në librin e tij "Çelësi i derës së lumturisë": "Aktiviteti i trurit degjenerohet nga nxehtësia përvëluese e zemërimit, epshi ose kujdesi shumë i tepërt, si dhe nga rraskapitja dhe lëvizjet e vullshme të forcave fizike dhe psikologjike".

Andaj kujdesuni për shëndetin tuaj e veçanërisht për shëndetin mendor. Përkujto urdhrin e të Dërguarit të Allahut a.s.: "Nuk lejohet dëmi ndaj dikujt e as ndaj teje" (Ibn Maxhe).

SOFRA TRADICIONALE E IFTARIT 2014



U nis me një tryezë të vogël si një rinisje dhe ripërtëritje e një tradite të hershme për qytetin e kulturës dhe të traditës fetare, Shkodrën. Ishte një tryezë e begatë, pasi i tillë është edhe muaji i madhërueshëm i Ramazanit. Vitet kaluan dhe tryeza u zgjerua, sepse mirësia dhe begatia e ramazanit nuk shteron asnjëherë. Frytet e tij ndihen çdo vit, pasi çdo vit rritet së tepërmi edhe numri i besimtarëve që bëhen pjesë e kësaj mirësie dhe begatie.

Një kontribut i shkëlqyer i shoqatës 'Istanbul' për të ripërtëritur dhe rigjallëruar këtë traditë, të cilën njerëzit e prisnin me padurim. Janë ambientet e shoqatës 'Istanbul' dhe pikërisht oborri i Medresesë 'Haxhi Sheh Shamia', Dega e Vajzave, që tashmë prej vitesh bëhet kultivues i denjë i farave të begatisë dhe mirësisë së kësaj sofrije të begatë. Nuk mjaftonte vetëm një natë e këtij muaji të madhërueshëm për të plotësuar kërkesat e besimtarëve të shumtë. E nisur nga kjo shoqata 'Istanbul' shpalosi si përherë zemërgjerësinë e saj, duke e zgjeruar këtë sofër për çdo natë të këtij muaji.

Të shumtë janë pjesëmarrësit e kësaj sofre, duke nisur që me besimtarët e shumtë që mbushin përherë safat e xhamive, jo vetëm të qytetit, por edhe të fshatrave. Nuk janë harruar jetimët dhe njerëzit në nevojë në këto sofrë, pasi duaja e tyre është shtysë e

ripërtëritjes së kësaj tradite. Nuk do t'i mungonin kësaj sofre edhe ish-medresistët, ata që derdhën djersën për disa vite për t'u edukuar dhe arsimuar me frymën e besimit të sigurt, për të plotësuar botën e tyre shpirtërore, për të qenë ata tashmë orientuesit e zemrave të besimtarëve.

Nuk do të harroheshin në këtë sofër edhe familjet e hoxhallarëve të hershëm të qytetit, si shtylla bazë e përcimit të dijes fetare. E kjo sofër u hapi dyert edhe pjesëve të ndryshme të popullsisë, në mënyrë që edhe ata të shijonin nga afër frytet e kësaj sofre.

Sofra e iftarit është sofër e paqes dhe e harmonisë, e mirëkuptimit dhe e forcimit të vëllazërisë mes njëri-tjetrit. Këtë qëllim ka edhe shoqata 'Istanbul' prej vitesh, të forcojë këtë vëllazëri dhe miqësi të ngushtë mes vëllezërve besimtarë, të afrojë sa më shumë njerëzit me njëri-tjetrin, në mënyrë që të qëndrojnë si një trup i vetëm në përballjen e sfidave të kohës. Agjërimi është forcim i vullnetit dhe i durimit të individit, rritje e shkallës së devotshmërisë dhe përkushtimit ndaj Krijuesit të Tij dhe Profetit të nderuar. Prandaj gjithë së bashku forcojmë bindjen tonë të falënderojmë njëri-tjetrit, në mënyrë që të falënderojmë edhe Allahun Fuqiptotë për këto mirësi dhe begati që na ka dhënë.

BIE AJNSHTAJNI, KALOHET SHPEJTËSIA E DRITËS

Duket se Ajnshtajni është gabuar. Një ekip shkencëtarësh në CERN ka arritur të regjistroi grimca neutrinoje që udhëtojnë më shpejtë se drita. Siapas Reuters: Antonio Ereditato, i cili punon në laboratorin e CERN në kufirin Franko-Zvicerian, tha se matjet gjatë tre viteve treguan se neutrinoet lëvizin 60 nanosekonda më shpejtë se drita në një distancë prej 730 kilometër. "Jemi të bindur mbi rezultatet, por kemi nevojë që edhe koleg të tjerë të kryejnë testet e tyre për të qenë më të sigurt" tha Ereditato. Ai konfirmoi se studimi mund të përmbys një pjesë kyçe të teorisë së relativitetit të Ajnshtajnit, e cila thotë se asgjë në univers nuk mund të udhëtoj më shpejt se drita. "Është e rëndësishme të bëhet e qartë se asnjë nuk po deklaron një zbulim, apo ndonjë kontradiktë tjetër me teorisë së relativitetit" tha James Gillies, zëdhënësi i CERN. Ai tha se nevojiten që të bëhen ekspe-

rimente të tjera dhe kërkoi ndihmë nga laboratorë të tjerë që të zhvillojnë eksperimentet. Eksperimenti u krye për të studiuar fenomenin e oscilacioneve të neutrinos, kur grimcat elementare të njohura si leptone transformohen në mënyrë spontane nga një grimcë subatomike (e quajtur myon-neutrino) në një tjetër (e quajtur tau-neutrino). Laboratori i CERN lëshon një tufë myon-neutrino që udhëton në një distancë prej 730 kilometër dhe arrin në një laborator nëntokësor në Gran Sasso në Itali, ku shkencëtarët vëzhgojnë sa myon-neutrino janë kthyer në tau-neutrino oshilantë. Rezultatet e eksperimentit ishin të pabesueshëm: Neutrinoet arritën në destinacion 60 milisekonda më shpejt se sa do ti duhej dritës të përshkonte të njëjtën distancë. "Thënë ndryshe, në një garë prej 730 kilometrash, grimcat neutrinoes kapërcejnë vijën e finishit 20

metra më herët nga drita, nëse kjo e fundit do të përshkonte të njëjtën distancë, saktëson CNRS. "Muaj të gjatë kërkimesh dhe verifikimesh na mundësuan identifikimin e një efekti instrumental që shpjegon rezultatit e masave tona", siguron zëdhënësi i eksperimentit "Opera", Antonio Ereditato, i cili shprehet i paduruar për të krahasuar këto rezultate me eksperimente të tjera. "Nëse konfirmohet nga eksperimente të tjera, ky rezultat i habitshëm dhe aspak i pritshëm nëse i referohemi teorisë së Albert Ajnshtajnit (Einstein), mund të hapë perspektiva të reja teorike tërësisht novatore", nënvizon CNRS (Qendra Kombëtare e Kërkimeve Shkencore, Francë) në një deklaratë për shtyp. I inauguruar në vitin 2006 bashkëpunimi ndërkombëtar Opera drejtohet nga një grup kërkimi që përfshin rreth 160 shkencëtarë nga 11 vende të ndryshme të botes.

FOSILET E BLETËVE TREGOJNË NDRYSHIMIN E KLIMËS



Fosilet nga gropat e ziftit La Brea në Kaliforni vazhdojnë t'u japin shkencëtarëve material të shkëlqyer për studimin e të shkuarës së rajonit. Kafshët e lashta, nga mamuthët në insektet e vegjël, tregojnë fakte rreth ndryshimeve klimatike gjatë Periudhës së fundit të Akullnajave dhe ndihmojnë shkencëtarët të kuptojnë ndryshimin klimatik të kohëve së sotme.

Për shekuj me rradhë, zifti i natyrshëm i cili depërtonte nga toka në zonën që tani është Kalifornia jugore, zinte kafshë të vogla dhe të mëdha, duke ruajtur fosilet e tyre

dhe duke i dhënë shkencëtarëve një numër mostrash të përshtatshme për studim.

Hulumtuesja në Muzeun e Gropave të Ziftit La Brea, Anna Holden, po analizon bletët e fosilizuara për të mësuar më shumë rreth mjedisit të lashtë.

"Unë jam duke u përpjekur të mësoj rreth klimës së atëhershme dhe mjedisit. Por kjo bletë ofroi një lloj informacioni të ri".

Pasi i ekspozuan fosilet në një skaner të vogël, shkencëtarët zbuluan se mjedisi i bletëve ishte më i ngrohtë nga sa pritej, gjë që bëri të mundur arritjen e përfundimit se në fund të Epokës së Akullnajave, rreth 11.500 vjet më parë, kjo zonë nuk ishte mbulur me dëborë dhe akull siç mendohej më parë.

Zonja Holden thotë se ndryshe nga gjitarët e mëdhenj që erdhën në La Brea nga Amerika e Jugut ose përmes Ngushticës së Beringut, shtrirja e kufizuar e insekteve lejon që informacioni i mbledhur të jetë

vetëm rreth mjedisit të tyre.

"Insektet kanë cikle jetësore shumë specifike, prandaj ata janë më të vërtetë tregues të mirë. Me fjalë të tjera, fosilet e tyre tregojnë vetëm rreth mjedisit të tyre".

Zonja Holden thotë se cilido që mblodhi fosilët në vitet '70 bëri një punë shumë të mirë në mbajtjen e shënimeve. Krahasimi i atyre të dhënave me gjetjet e sotme mund të tregojë diçka rreth të ardhmes sonë.

"Të kuptosh ndryshimin e mëparshëm të klimës është të kuptosh atë të tanishmin. Ndryshimi i klimës është një çështje e rëndësishme tani dhe insektet janë shpesh tregues të mirë të tij".

Zonja Holden thotë se puna e saj mund të ndihmojë fermerët e ditëve të sotme për të luftuar problemin e shkatërrimit të kolonive të bletëve, duke zgjedhur llojet e bletëve që i përshtaten më mirë ndryshimeve klimatike.